100 VJET PAVARESI

# Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 4 (72). PRILL 2012. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.




**Market KEN**
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

REPORTAZH

## Pema tek pragu i Udhës së Arbërit

*Nga:* **PETRO LUARASI** - FAQE 5

KRITIKË

## Dritë dhe ...hije

*Mbi romanin "Kur vdiste Kanuni" të shkrimtarit Xhafer Martini*

*Nga:* **VESEL HOXHA** - FAQE 12

PORTRET KRIJUESI

## Hilmi Sadiku, historiani kopshtar

*Nga:* **SELMAN MEZIU** - FAQE 16

HISTORI

## Said Najdeni, veprimtari i Rilindjes

*Nga:* **XHELAL ROÇI** - FAQE 22

Jep dorëheqjen ish-drejtori i Policisë së Qarkut të Dibrës. Akuzon strukturat e policisë për lidhje me grabitësit e pasurisë së Bulqizës

# Mafia e kromit vret minatorët


© Foto: Adela Halo

*Nga* **SHEMSI PRENÇI**

**Në muajin shkurt të këtij viti, kam re fuzuar emërimin tim si Drejtor të Policisë së Qarkut Dibër para Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Ministrit të Brendshëm për motive dhe arsye nga më të ndryshmet, por një gjë e tillë nuk u mor në konsideratë edhe pse bie ndesh me kërkesat e ligjit "Për Policinë e Shtetit". Gjithsesi, i detyruar, mora detyrën për t'i shërbyer me përkushtim e maksimalisht komunitetit ku isha lindur e rritur. Edhe pse gjeta përkrahjen dhe mbështetjen e pjesës më vitale të strukturave të Policisë së Qarkut Dibër, një gjë të tillë nuk e pata nga strukturat eprore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe të Ministrisë së Brendshme, të cilat morën në mbrojtje pjesën e inkriminuar të strukturave të policisë, me origjinë nga strukturat e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të instaluar për t'i shërbyer mafies së mineralit të kromit në rajonin e Dibrës. Në vazhdimësi kemi denoncuar me të gjitha nivelet e hierarkisë si dhe kemi kapur në flagrancë e referuar në organet e Prokurorisë vjedhje e falsifikime të kësaj pasurie kombëtare, por jemi ndjerë të braktisur nga eprorët, strukturat qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe organet e Prokurorisë në rajon, duke terrorizuar psikologjikisht ata që luftojnë krimin nëpërmjet "gogolit" SHKB, që nuk njeh ligj, por mbron hapur mafien e kromit dhe bashkëpunëtorët e saj në polici.**

**I ndodhur përpara këtyre kushteve dhe i detyruar nga veprimet arbitrare të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë ndaj meje duke më pezulluar përkohësisht nga detyra, për t'i hapur rrugë aktivitetit të mafies së mineralit të kromit: Paraqes përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dorëheqjen nga detyra e Drejtorit të Policisë së Qarkut Dibër dhe nga çdo funksion tjetër në Policinë e Shtetit.**

**Sot dorëzova dorëheqjen përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, i cili ka në dorë vetëm çelësat e kashtës, sepse gjithçka ja diktojnë pengmarrësit, pasi një gjë të tillë ma deklaroi vetë, duke më thënë se jam i detyruar të të jap pezullim paraprak të pamotivuar konform ligjit "Për Policinë e Shtetit", por vetëm për faktin që ju kisha rënë ndesh grupeve kriminale të cilat janë të "armatosur" edhe me Kompani Mediatike, por që disponojnë shpellat e krimit në Bulqizë dhe mbajnë nën terror psikologjik pjesë të organizatës së policisë për t'iu hapur rrugë në veprimtarinë mafioze të vjedhjes dhe shfrytëzimit të paligjshëm të pasurisë kombëtare.**

***(Vijon në faqen 2)***

ETNOKULTURË

## "A po gjegji, po na vjen Shëngjergji"

**Nga: NAIM PLAKU**

Na erdhi 6 Maji, Dita e Shëngjergjit. Një ndër festat më të bukura të natyrës. Festa e vërtetë e verës në anët tona, festa e luleve, e gjelbërimit, e përtëritjes, e lindjeve të reja, e qingjave dhe e kecave të njomë, festa e qumshtit të bardhë, festa më e dashur e fëmijëve. E kemi te pragu i derës. Shëndet, forcë, begati e lumturi…Le të rrjedhë jeta si ujërat e begatë të pranverës që vrapojnë nën mugullimin dhe gjelbërimin e pafund, plot freski, bukuri dhe aromë lulesh! Festohet në gjithë Shqipërinë, por paksa më e veçantë e, ndoshta paksa më e bukur, është në Dibër. Nuk është festë e romëve, siç kemi dëgjuar ta quajë dikush. Nuk është as festë e ndonjë prej feve që janë praktikuar e praktikohen aktualisht. Nuk është as myslimane, as hebreje, as katolike apo ortodokse, as e alenëve apo e liliputëve. Është festë e të gjithëve… Gjithkush që e përqafoi dhe u mundua ta praktikojë e ta respektojë, ta ndjekë e ta ruajë sa më mirë sipas traditës, u bashkua dhe u bë një me natyrën, me gëzimin dhe harenë e saj.

***(Lexoni në faqen 7)***



cyan magenta yellow black 1

Rruga e Arbërit nr. 72
kryesore

***Kështu beteja e një segmenti të shtetit me mafian e kromit duket se u humb, ndaj do ishte e udhës që "dosja e përgjakur e kromit" të mos qëndrojë më e mbyllur, por të shfletohet për të nxjerrë para ligjit të gjithë ata që kanë shkaktuar "kataklizmon" e kësaj pasurie të të gjithë shqiptarëve***

# Mafia e kromit vret minatorët

## Jep dorëheqjen ish-drejtori i Policisë së Qarkut të Dibrës. Akuzon strukturat e policisë për lidhje me grabitësit e pasurisë së Bulqizës

*Posta e* Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 4 (72). 1 - 30 Prill 2012

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim. Njoftojmë zotërinjtë Avni Alcani, Hysen Likdisha, Shefki Aliti, Destan Rama, Bedri Tahiri, se shkrimet e tyre jane planifikuar për numrat e ardhshëm. Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
**JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".**
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Naim PLAKU
Abdurahim ASHIKU
Shemsi PRENÇI
Rexhep TORTE
Ali HOXHA
Avni ALCANI
Gjergj MARKU
Petro LUARASI
Vesel HOXHA
Rremzi NDREU
Selman MEZIU
Velo CFARKU
Mevlud BUCI
Fitim DIKA
Dionis XHAFA
Haki KOLA
Malvina SHEHI
Denis LUSHI
Beqir SINA
Jahe DELIA (SELMANI)
Xhelal ROÇI
Sakip CAMI
Ilmi DERVISHI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

*(Vijon nga faqja 1)*

**Nga kush detyrohesh z. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë? Ju duhet të keni detyrim vetëm nga ligji dhe jo nga ata që të kanë marrë peng bashkë me kompetencat e tua ligjzbatuese e duke të kthyer në një marionetë...**

**Në profesionin e policit në shërbim të shoqërisë, detyrohemi të hetojmë edhe nëpër gjirize, por nuk na lejohet të fëlliqim duart aty, ose më mirë të themi nuk është e pranueshme të sillemi si ndyrësira. Shoqëria na kërkon që krimi të zbulohet, po ashtu edhe krimineli të zbulohet, të kapet dhe të ndëshkohet. Po nuk ja dolëm mbanë kësaj detyre, mund të quhemi të paaftë, në mos edhe të shitur. Por mos harro se, ndërsa krimineli do të ketë në anën e vet morinë e atyre që përpunojnë opinionin publik dhe të politikës, polici përfaqëson arrogancën dhe padrejtësinë e pushtetit, e megjithatë askush nuk na ka detyruar të bëhemi policë. Ky profesion të kufizon të drejtat për t'u ankuar e protestuar, qoftë edhe kur na vritet shoku në krah, sepse rreziku është pjesë e eprorëve në luftë kundër krimit. Në profesionin tonë dita na rezervon vetëm pesë minuta kënaqësi, pikërisht kohën kur shikohemi para pasqyrës duke u rruar. Në ato momente mund të themi "Ja ky është "dystabani", ky është xhandari, personi që po përgatitet të lërë lëkurën e tij për të mbrojtur atë të të tjerëve, qofshin këta edhe mafiozë në pushtet. Ky është i vetmi kompensim që mund të presë nga profesioni im por edhe i juaji z. Drejtor, që askush nuk na detyroi ta zgjedhim. Mua më ka mjaftuar dhe do të më mjaftojë për sa kohë strukturat e Policisë së Shtetit ndjehen të marra peng nga një grup mafiozësh, por që fatkeqësisht dejuro drejtohen nga një person që vetëm çelësat e kashtës ka në dorë, e që emrin Hysni e ka.**



**MEDIAS DHE OPINIONIT PUBLIK**

**Jam përpara jush pasi sot i dhashë vetes lirinë e nevojshme, duke dorëzuar dorëheqjen në zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që është katandisur në mbajtësin e çelësave të kashtës! E mora lirinë sepse nuk munda të bëja më shumë nën uniformë përballë mafies së kromit, që vazhdon të grabisë Shqipërinë duke vrarë "skllevërit" e minierës së Bulqizës dhe gjithë rajonit. Liria më duhet tash e mbrapa, për të folur hapur, ballë për ballë me armiqtë e këtij populli, pasi në përballjen si oficer policie me mafien e kromit dhe pronave, fituan ata dhe jo unë. Por jam i bindur se ndeshja me atë të keqe të tmerrshme nuk ka mbaruar dhe ta harrojnë se duke më kërcënuar me bukën e gojës, si më kanë bërë deri tani, apo me jetën si mund të bëjnë tani e tutje, mund të fitojnë heshtjen time për gjithçka di nga profesioni!**

**Ndeshja vazhdon dhe pasi nuk gjeta aleat brenda shtetit (ndjesë kolegëve të mi të ndershëm), do t'i kërkoj tek opinioni publik. Kam folur gjithçka brenda kornizës së uniformës dhe strukturave të shtetit, sot po dorëzoj uniformën që fjalën e rëna në vesh të shurdhër deri tani, për shkak të censurës së profesionit, t'i dëgjojnë qytetarët dhe familja ime, të cilës nuk mund t'i vej kurrë njollën e tradhtisë ndaj vendit tim, duke vazhduar të hesht për shkak të detyrës!**

**Unë bëra sa munda, por nuk bëra dot sa doja për të ndaluar mafien që po thith gjakun e këtij populli edhe në shpellat e krimit në Bulqizë. Deri vonë kam besuar se Sali Berisha, thënien se "mafia s'ka atdhe por vetëm shpellën e krimit", e ka mësuar nga librat, por fatkeqësisht, i gjetur përballë shpellave të mafies në Bulqizë, përballë heshtjes së strukturave të larta të shtetit deri te Kryeministri i Shqipërisë, ku unë i kam denoncuar nga thellësia 1400 metra këto shpella të mafies, që kur unë isha Drejtor i Forcave Speciale, por këto denoncime ranë në vesh të shurdhër dhe unë kuptova të vërtetën e tmerrshme se njohja e Kryeministrit për mafien vjen nga brenda shpellave të saj dhe jo nga librat. Jam demokrat dhe do të jem i tillë derisa të kem frymën, prandaj po i braktis në mjerimin e tyre ata që popullit i mbajnë leksione gjithë ditën për demokraci e ligj dhe gjithë natën i hapin mafies rrugët e tiranisë së zezë mbi popullin e varfër.**

**Kam shumë gjëra për të treguar, e këto kam për t'i treguar edhe përpara prokurores së Përgjithshme edhe përpara opinionit publik, sepse nuk besoj te ky sistem drejtësie i lidhur me shpellat e mafies në pushtet, por do të besoj gjithë jetën tek e drejta e popullit të cilit i përkas.**

**Këtë e kam detyrim si bir i një familje minatori, si shërbëtor fanatik i shtetit, si një shqiptar i Dibrës historike të dhunuar prej tiranisë së korrupsionit. S'jam asgjë më shumë se një njeri i zakonshëm dhe nuk pretendoj asnjë shpërblim apo lavdi për betejën time qytetare e profesionale, por aspak politike në këtë pushtet mafioz! Por kam diçka që nuk e fal dhe nuk e shes dot kurrë: emrin që jua kam borxh prindërve dhe fëmijëve të mi.**

**Sot mund t'ju them vetëm se kam provat e një lufte dhëmbë për dhëmbë me mafien e shpellave të Bulqizës e të cilat themelet i ka në Tiranë. Nesër e në vijim do të përdor hapësirat e mbetura të lirisë në media për t'ia rreshtuar një për një popullit përpara syve.**

**Si ish-Drejtor Policie dhe si një sindikalist i vërtetë i Organizatës së Policisë që kurrë nuk më ka munguar kurajo për të thënë të vërtetën edhe kur mafia abuzonte me tenderin e automjeteve, të uniformës apo të ndërtimit në Policinë e Shtetit, solidarizohem me mijëra policët e shkretuar në shpirt nga imoraliteti i pushtetit që ka marrë peng uniformat blu. Sjell në vëmendje të organizatave ndërkombëtare që asistojnë Policinë e Shtetit, si dhe të misioneve diplomatike se taksapaguesit Evropianë, Amerikanë, po ashtu edhe taksapaguesit shqiptarë po paguajnë për të bërë eksperimente të përvitshme në strukturat e Policisë së Shtetit e ku konsolidimi i tyre do të jetë një "telenovelë" me shumë seri.**

** Drejtues i Parë. Ish-Drejtori i Policisë së Qarkut Dibër*

**E mora lirinë sepse nuk munda të bëja më shumë nën uniformë përballë mafies së kromit, që vazhdon të grabisë Shqipërinë duke vrarë "skllevërit" e minierës së Bulqizës dhe gjithë rajonit.**

**Ndeshja vazhdon dhe pasi nuk gjeta aleat brenda shtetit (ndjesë kolegëve të mi të ndershëm), do t'i kërkoj tek opinioni publik. Kam folur gjithçka brenda kornizës së uniformës dhe strukturave të shtetit, sot po dorëzoj uniformën që fjalën e rëna në vesh të shurdhër deri tani, për shkak të censurës së profesionit, t'i dëgjojnë qytetarët dhe familja ime, të cilës nuk mund t'i vej kurrë njollën e tradhtisë ndaj vendit tim!**

**Unë bëra sa munda, por nuk bëra dot sa doja për të ndaluar mafien që po thith gjakun e këtij populli edhe në shpellat e krimit në Bulqizë.**

**Jam demokrat dhe do të jem i tillë derisa të kem frymën, prandaj po i braktis në mjerimin e tyre ata që popullit i mbajnë leksione gjithë ditën për demokraci e ligj dhe gjithë natën i hapin mafies rrugët e tiranisë së zezë mbi popullin e varfër.**

**Kam shumë gjëra për të treguar, e këto kam për t'i treguar edhe përpara prokurores së Përgjithshme edhe përpara opinionit publik, sepse nuk besoj te ky sistem drejtësie i lidhur me shpellat e mafies në pushtet, por do të besoj gjithë jetën tek e drejta e popullit të cilit i përkas.**

# aktualitet



**Këtë e kam detyrim si bir i një familje minatori, si shërbëtor fanatik i shtetit, si një shqiptar i Dibrës historike të dhunuar prej tiranisë së korrupsionit. S'jam asgjë më shumë se një njeri i zakonshëm dhe nuk pretendoj asnjë shpërblim apo lavdi për betejën time qytetare e profesionale, por aspak politike në këtë pushtet mafioz! Por kam diçka që nuk e fal dhe nuk e shes dot kurrë: emrin që jua kam borxh prindërve dhe fëmijëve të mi.**

**Opinion**

## Dosja e përgjakur e kromit

Nga: **GJERGJ MARKU**

Në pak radhë është e pamundur të shtjellosh çfarë ka ngjarë me pasurinë minerare që e rendit Shqipërinë në vendin e katërt sa i përket rezervave të kromit, pasi për fat të keq gjurmët e shfrytëzimit të tij në mënyrë të pamëshirshme, janë shoqëruar me pellgje gjaku. Pasuria kombëtare pas makinacioneve dhe ryshfeteve në dhënien e koncensioneve u vu nën thundrën e mafias së mineraleve, e cila u instalua me të shpejtë në vendin tonë duke kapur pikat më rentabël sidomos në krom.

Pikërisht për shkak të pangopësisë së këtyre firmave të lidhura fort me segmente qeveritare, filloi një shfrytëzim barbar i kromit në zonën e Matit dhe të Bulqizës si pellgu më i fuqishëm krommbajtjes në vendin tonë. Firma fantazmë u shfaqën gjithandej minierave, uzinës së ferrokromit e deri në eksportin e tij portual. Qindra punëtorë u flakën në rrugë dhe qindra të tjerë u shfrytëzuan në kushte mizerabël në kushte mesjetare të punës dhe sigurisë.

Për pasojë janë mbi 20 minatorë që gjetën vdekjen në zgafellat e minierave të Bulqizës apo Martaneshit e gjetkë maleve me krom, si dhe të tjerë në stoqet e hapura të kromit ku luftonin për të mbijetuar në shërbim të grupeve kriminale. Grevave të shumta të urisë si në Mat apo Bulqizë, shteti iu përgjigj me shkopinjtë e gomës të policisë por jo me zgjidhje ekonomike dhe so-

**Sot e 15 vite ka ngelur pa autor vrasja e shefit të antikrimit ekonomik të Matit, Sabri Neli dhe shoferi i këtij komisariati Baftjar Stafhasani (20 maj 1998), por burime të frikësuara nga brenda policisë së asaj kohe patën rrëfyer se ishte gjetur e hapur kasaforta ku mbaheshin dosjet e kromit, që shfrytëzoheshin nga grupe kriminale dhe ato u asgjësuan. Edhe dosjet e tjera që u hapën në Bulqizë, kanë pasur të njëjtin fat, asnjërës nuk i është shkuar deri në fund, ndërsa shfrytëzimi barbar e pa kriter i minierave vazhdon.**

ciale. Nga ana tjetër nëse ndokush guxoi të shkelë në dosjen e përgjakur të kromit, njerëz të paguar iu përgjigjen me grykën e kallashnikovit.

Kësisoj sot e 15 vite ka ngelur pa autor vrasja e shefit të antikrimit ekonomik të Matit, Sabri Neli dhe shoferi i këtij komisariati Baftjar Stafhasani (20 maj 1998), por burime të frikësuara nga brenda policisë së asaj kohe patën rrëfyer se ishte gjetur e hapur kasaforta ku mbaheshin dosjet e kromit, që shfrytëzoheshin nga grupe kriminale dhe ato u asgjësuan. Edhe dosjet e tjera që u hapën në Bulqizë, kanë pasur të njëjtin fat, asnjërës nuk i është shkuar deri në fund, ndërsa shfrytëzimi barbar e pa kriter i minierave vazhdon.

Nëse sipas specialistëve kjo minierë do e kishte jetëgjatësinë për 100 vite, me shfrytëzimin që po i bëhet nga të gjitha "brinjët" e kësaj miniere, miliona tonë krom do të mbeten poshtë zgafellave pa u shfrytëzuar. Rezervat së paku shënohen në 10 milion ton (2 miliardë dollar me tregun e sotëm), por nga shfrytëzimi kriminal dhe i pabazuar në harta gjeologjike kjo rezervë kolosale po shkon drejt shterimit. Pikërisht në momentin kur policia epet për të vënë rregull dhe kërkon zbatimin e ligjit, ndesh me sulm të paprinciptë të grupeve të interesuara për kaos, kësaj radhe edhe me mbështetje mediatike, duke detyruar iniciatorin e aksioneve bllokuese, drejtorin e policisë Dibër të japë dorëheqjen.

Kështu beteja e një segmenti të shtetit me mafian e kromit duket se u humb, ndaj do ishte e udhës që "dosja e përgjakur e kromit" të mos qëndrojë më e mbyllur, por të shfletohet për të nxjerrë para ligjit të gjithë ata që kanë shkaktuar "kataklizmon" e kësaj pasurie të të gjithë shqiptarëve. *(shekulli.com.al)*

## Lajme rreth kromit

### Policia, bllokohen 14 kamionë që transportonin krom me fatura të fallsifikuara

Më 16.04.2012 rreth orës 00.20 minuta, specialistë të Sektorit Kundër Krimit Financiar në Drejtorinë e Policisë Dibër, në bashkëpunim me forcat e policisë të komisarieteve të rretheve Bulqizë dhe Mat, kanë finalizuar me sukses operacionin për bllokimin e disa mjeteve të rënda që transportonin mineral kromi me fatura të fallsifikuara Sipas një njoftimi për shtyp nga ana e Drejtorisë së Policisë Dibër, mësohet se pak pas mesnatës së ditës së sotme, strukturat e policisë kanë finalizuar me sukses operacionin për bllokimin e 14-të kamionëve "Trajler", të cilët po transportonin mineral kromi me fatura të fallsifikuara. Transporti i mineralit, bëhej për llogari të subjekteve të ndryshme private, që operojnë për shfrytëzimin dhe tregtimin e kromit në të ashtuquajturën "Zona D" e Minierës së Bulqizës. Në njoftimin e policisë thuhet se nga 14-të komionët e bllokuar, 8-të prej tyre i përkasin subjektit "KEVGER" shpk me administratore Enkelejd Hysenbelliu, 4-tër kamionë subjektit "DERVISHI" shpk me administrator Ndriçim Dervishi dhe 2 kamionë subjektit "GERI-TREVI" shpk me administrator Agim Çuku. Nga verifikimet e para të policisë, në lidhje me tonazhin e ngarkesës së kamionëve, ka rezultuar se automjetet e transportit, kishin të deklaruara në faturat e shoqërimit vetëm gjsmën e sasisë së ngarkesës, përkatësisht nga 24 deri në 30 ton. Pas peshimit që u është bërë kamionëve në peshoren e kompanisë ACR, ngarkesat në çdo njërin prej tyre, kanë variuar nga 40 deri në 62 ton. Në total në të 14-të kamionët e bllokuar nuk deklarohen në fatura rreth 350 ton krom. Ndërkohë burime nga policia bëjnë me dije se po bashkëpunohet edhe me Drejtorinë e Policisë të Qarkut Durrës, për të bërë verifikime në Portin e Durrësit, pasi dyshohet se disa nga kamionët e transportit, kanë transportuar dhe vazhdojnë të transportojnë krom me fatura të fallsifikuara. Në lidhje me këtë fenomen, të veprimtarisë së paligjëshme të transportit të mineralit të kromit, thuhet në njoftimin për shtyp të policisë, janë njoftuar edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe Njësia Rajonale e Policisë Rrugore, si dhe Prokurorité e Rretheve Gjyqësore Dibër dhe Mat. Nga ushtrimi i kësaj veprimtarie të paligjshme të transportit të kromit, veç evazionit fiskal, transporti me dyfishin e kapacitetit, ka sjellë si pasojë që në segmente të caktuara të aksit rrugor nacional Bulqizë-Milot të ketë edhe dëmtime të plota dhe të pjesshme, duke u bërë kështu burim aksidentesh, thuhet në komunikatën e policisë. / ***H.L.***

### UZINA E FERROKROMIT BURREL, GJYKATA SEKUESTRON 100 TON FERROKROM

Zyra Përmbarimore Mat, ka sekuestruar rreth 100 ton ferrokrom dhe një sasi të konsiderueshme elektrodash, gjendje në Uzinën e Ferrokromit Burrel. Sekuestro e këtyre materialeve ka ardhur në zbatim të një vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për shlyerjen e shoferëve të transportit, të cilët nuk janë paguar për transportin e mineralit nga ish kompania Italkrom që menaxhonte më parë këtë uzinë. Kompania austriake ACR, që aktualisht menaxhon këtë uzinë, petendonte se vendimi i Gjykatës së Matit, për sekuestrimin e mineralit dhe elektrodave është i paligjshëm, pasi janë në pronësi të saj. Por, përkundër këtij pretendimi, ACR-ja nuk arriti të paraqesë asnjë document që të vërtetojë, se këto materiale janë pjesë e inventarit të marrjes në dorëzimim të uzinës prej saj nga ish kompania Italkrom. Drejtuesit e mjeteve të transportit, depozituan para gjykatës, të gjithë dokumentacionin e duhur që provonte se sasia e këtij ferrokromi ishte në pronësi të ish kompanisë Italkrom dhe jo në inventarin e kompanisë ACR, që aktualisht menaxhon këtë uzinë. Fillimisht për të shmangur sekuestron, ACR-ja, pretendoi se do të apelonte vendimin e gjykatës, porn ë mungesë të provave u tërhoq nga një vendim i tillë. Kështu përfaqësuesi i ACR-së, Telat Haxhiu, u detyrua të zhbllokojë hyrjen e uzinës, duke i dhënë kështu mundësi ekzekutimit të vendimit të gjykatës. Ndërkohë metalurgët e kësaj uzine, nuk e kanë lejuar administratorin e ACR-së, që të marrë transformatorin e njërës furrë shkrirjeje e cila nuk është në gjendje pune, për ta çuar në Elbasan, me pretendimin për ta riparuar, pasi kanë dyshuar se ai do përdorej për të zëvëndësuar një transformator të djegur në Uzinën e Elbasanit. / **H.L.**

### PROTESTAT E MINATOREVE TË BULQIZËS, GJYKATA GJOBIT KRERËT SINDIKALISTË

Protestat tre mujore të minatorëve të Bulqizës, që nisën në fillimkor rikun e vitit të kaluar, për kushte më të mira pune dhe rritje të pagave për ta, të cilat kulmuan edhe me dy greva urie njëra prej të cilave u zhvillua në thellësi të nëntokës, në nivelin e 14-të të pusit nr.2, veç pasojave të rënda ekonomike për 700 minatorët e kësaj miniere, kanë çuar edhe në ndëshkimin me gjoba për 5 anëtarë të këshillit sindikal. Pas një kalvari të gjatë seancash gjyqësore, të cilat kanë nisur që nga viti i kaluar, kur këshilli sindikal i minatorëve u akuzua nga policia për protesta të paligjëshme dhe bllokim të rrugëve nacionale, më në fund Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka ndëshkuar krerët sindikalistë të minatorëve me gjoba. Kështu sindikalistët, Dilaver Përkoxha, Baki Bajraktari, Sali Alliu, Xhemal Meta dhe Luan Nika, janë dënuar nga Gjykata me gjobë ne vlerën 200 mijë lekë për shkelje të ligjit në organizimin dhe zhvillimin e protestave të minatorëve. Një masë e tillë dhënë nga Gjykata e Dibrës, ka indinjuar minatorët, pasi siç dhe shprehen ata në asnjë rast nuk kanë zhvilluar protesta të paligjshme. "Protestat tona, thotë ish kryesindikalisti Dilaver Përkoxha, kanë qenë tejet të ligjëshme në përputhje me ligjin, pasi janë zhvilluar për kushte më të mira të sigurisë në punë dhe rritje pagash. Jemi tejet të indinjuar, jo vetëm nga vendimi i padrejtë që dha gjykata, por edhe nga mënyra se si e trajtoi ajo problemin tonë, me një zvarritje skandaloze, plot 15 seanca gjyqësore, thotë Baki Bajraktari. Ndërkohë menjëherë pas vendimit ka reaguar Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, e cila e konsideron vendimin si formë presioni ndaj krerëve të kësaj sindikate. Taf Koleci, presidenti i Konfederatës së Sindikatave të Industrisë, tha se që dje janë marrë të gjitha masat për ta apeluar vendimin si të pabazuar në ligj e prova e fakte. ***H.Likdisha***

Rruga e Arbërit nr. 72

sociale

# Faleminderit profesor Koleci!

## *"Një mësim që duhet lexuar me mend e me kalem"*





**Shqetësim për profesorin, inxhinierin Abdyl Koleci, është tjetërsimi i lumit të Radikës, lum që në kujtesën e popullit të Dibrës nuk ka hyrë vetëm për bukurinë përrallore, për rrjedhën e ujërave që vijnë nga malet në "kurrizin fizik" të trojeve shqiptare, por edhe për historinë e saj, histori që lidhet me kthimin e Skënderbeut dhe betejat e tij fitimtare në territorin e Dibrës, me qëndresën shekullore kundër hordhive otomane, kundër Hajredin Pashës dhe serbo-sllavëve**

*Nga:* **ABDURAHIM ASHIKU**

Një mesazh për ata që kanë në kokë projektin për Skavicën, mbytjen e Dibrës, luginës së bukur të Drinit të Zi, mesazh që na vjen nga përtej kufirit shqiptaro-shqiptar - urtësi dibrane e ditëve tona...

Dy vjet më parë, kur Shkodra përjetonte përmbytje të pashoqe, pasojë e hapjes së portave të digave të hidrocentraleve mbi kaskadën e Drinit, kryetari i shtetit, (pas "hënës" çudimadhe që kishte bërë që deti të mos i pranojë ujërat e Drinit dhe të Bunës), ndërseu kalemxhinjtë që munxët t'ia lëshojnë Dibrës.

"Ta mbysim Dibrën që të shpëtojë Shkodra!"...

Fjalë e ditës u bë "ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës" ! ?...

Fjalë e fjalës u bë liqeni mbi luginën e Drinit të Zi që do të shpëtonte ...Shkodrën ! ?

Asokohe, unë dhe dibranë të tjerë, u ngritëm kundër ndërtimit të Skavicës, kundër mbytjes së luginës së bukur të Drinit të Zi...

Botova me shpenzimet modeste të pensionit tim librin "PO DIBRËS! JO SKAVICËS"...

Në faqen e parë të tij vendosa fjalët e kryetarit të komunës së qytetit të Dibrës së Madhe nën Maqedoni Argëtim Fida dhe të Xhemal Matos, mbrojtësi më i vendosur i natyrës së bukur shqiptare...

Viti 2012 në Shqipëri solli dëborë të madhe e suferinë, bllokim rrugësh e bllokim fshatrash në Veri dhe në Jug.

Për fat të mirë nuk solli përmbytje nga hapja e portave të digave... sepse ato nuk u hapën.

Në shtypin e shkruar dhe atë elektronik tash dy vjet nuk po flitet më për Skavicën as me një, as me dy dhe as me tri diga. Nuk flitet se nuk u hapën portat e liqeneve...

Fjala për të zgjohet vetëm kur hapen portat...

* * *

Një shkrim në gazetën "Rruga e Arbërit", shkruar nga Prof. Dr. Inxh. Abdyl KOLECI më zgjoi kujtesën, më solli gjerë e gjatë atë që dy vjet të shkuara, në një korrespondencë me postë elektronike, më kishte shkruar Argëtim Fida, Kryetar i Komunës Dibër e Madhe.

**Mesazhi që përcjell Prof. Dr. Inxh. Abdyl KOLECI për "andej kufirit shqiptaro-shqiptar" është një PARALAJMËRIM për atë që do të ndodhë në qoftë se dibranët e Dibrës së Poshtme do të lejojnë të mbytet Dibra, të mbytet begatia që rrjedh nga Lugina Pjellore e Drinit të Zi, të mbytet kujtesa historike e lidhur me të parët e asaj treve, me varret ende të freskëta në kujtesën e tyre.**

"... Me shqetësim përcjell reagimin tuaj. Unë edhe nuk kam të drejtë të reagoj se banoj në Dibër të Madhe dhe ky liqen drejtpërdrejte nuk do të ndikojë tek ne, por sigurisht do të ketë impakte në mikroklimën edhe tek ne.

Historinë dhe të afërmit tonë i kemi edhe atje dhe kjo na brengos. Një fakt është i saktë dhe dëshiroj të argumentoj shqetësimin tuaj: Dibranët nga ndërtimi i liqenit artificial të Dibrës dhe hidrocentralit të Shpiles nuk panë asgjë të mirë për këto 40 vjet pos humbjes të rreth 5000 ha tokës më pjellore dhe që vaditej nga dy lumenj, burimi kryesor i ekzistencës të numrit më të madh të familjeve dibrane.

Sot të mirat nga prodhimi i rrymës përfitohen vetëm nga qeveria maqedone që nuk do të ja dijë në se këto familje u detyruan të largohen në Turqi ose ShBA për të siguruar ekzistencën. Jam më shumë për ndonjë burim energjie ose zgjidhje që nuk do të përmbyste gjithë këtë territor.

Duke të mbështetur, Argëtim Fida kryetar i Komunës Dibër e Madhe,

14 shkurt 2010

(Po Dibrës! Jo Skavicës faqe 6 dhe 162)

Faleminderit Argëtim Fida!

* * *

Shqetësim për profesorin, inxhinierin Abdyl Koleci, është tjetërsimi i lumit të Radikës, lum që në




kujtesën e popullit të Dibrës nuk ka hyrë vetëm për bukurinë përrallore, për rrjedhën e ujërave që vijnë nga malet në "kurrizin fizik" të trojeve shqiptare, por edhe për historinë e saj, histori që lidhet me kthimin e Skënderbeut dhe betejat e tij fitimtare në territorin e Dibrës, me qëndresën shekullore kundër hordhive otomane, kundër Hajredin Pashës dhe serbo-sllavëve.

Abdyl Koleci, duke kërkuar që ujërat e Radikës të rrjedhin rrugës mijëvjeçare, na sjell në vëmendje atë që ndodhi me "Spilen" për të na paralajmëruar se e njëjta gjë do të ndodhë edhe me "Skavicën", ajo që ndodhi me mbytjen e Udovës do të ndodhë edhe me mbytjen e luginës së Drinit të Zi...

Mesazhi është i qartë, i shkruar mes rreshtash dhe në rreshta me germa kapitale. Kush din ta lexojë dhe ta bluaj imët në mullirin e qelizave trunore e kupton dhe e mbështet.

Profesori shkruan: ..."për shfrytëzimin pa kriter dhe të papërgjegjshëm të përrenjve dhe të ujit të lumit Radikë për ndërtimin e liqenit të Mavrovës që tashmë është ndërtuar, uji i të cilit derdhet në lumin Vardar, në anën e kundërt të rrjedhjes natyrore, si edhe të planit për ndërtimin e minihidrocentraleve të tjerë, të cilët ujin e lumit Radikë do ta përshkojnë nëpër tunele dhe do ta derdhin sërish në lumin Vardar, duke e devijuar rrjedhjen normale të lumit Radikë dhe duke e prishur ekosistemin e kësaj zone të virgjër natyrore, pa e konsultuar fare popullatën e këtushme. Sjelljet e shtetit me Dibrën e Madhe i ngjajnë sjelljes sikur me pronën pa pronar. "

Profesori flet për "Radikën" sot por, sa e shoh unë, merakun e ka gjetkë, tek HC Spila e veçanërisht tek Fusha e mbytur e Udovës, "tokë pjellore e klasit të parë, përndryshe hambari i Dibrës së Madhe, ku qyteti me rrethinë siguronte bukën e gojës dhe mirëqenien e vet."

Për profesorin Fusha e Udovës ishte "një fushë tepër pjellore ku prodhoheshin rendimente të larta të drithërave, si misri, gruri, elbi, thekëri, por edhe patatet, specat, domatet, lakra dhe ku rriteshin edhe shumë pemë frutore cilësore si arra, molla, dardha, kumbulla, hardhia etj.

Në Fushën e Udovës prodhohej gjer në 30 tonelata patate në një hektar, ndërsa nga varietetet e prodhuara sasi të konsiderueshme edhe eksportoheshin.

Me mbulimin e Fushës së Udovës nga liqeni artificial i HC Spila, tashmë Dibra e Madhe është e detyruar që t'i importojë nga jashtë prodhimet e sipërpërmendura, sepse pjesa tjetër e tokës së punueshme tashmë shumë vite ka mbetur pa ujë dhe nuk prodhon asgjë."

Të njëjtat fjalë begatie e burimi të madh jetese e turizmi bashkëkohor malor do të thosha unë (dhe cilido dibran) vetëm duke zëvendësuar fjalët "Fusha e Udovës" me "Fusha e Luginës së Drinit të Zi", një fushë disa herë më e madhe dhe po aq e begatë, fushë vazhdim i "Fushës së Udovës" kreu i fushave të Drinit të Zi.

Profesori na sjell pamjen e viteve '60-të të shekullit të kaluar në pamjen e viteve '20-të të shekullit të parë të viteve 2000...

"Shpronësimi i Fushës së Udovës të mbuluar me ujë ndaj bujqve dibranë ishte shumë i lirë, thënë simbolikisht një metër katror tokë pjellore u pagua me çmimin e një akulloreje, çmim që sot e kësaj dite shumë bujq dibranë edhe nuk e kanë marrë.

Kjo tokë pjellore u mbulua me ujë dhe kjo pasuri e dibranëve u humb për jetë të jetëve. Kaloi gati gjysmë shekulli që Dibra e Madhe dhe dibranët as nga toka dhe as nga hidrocentrali Spila nuk kanë asnjë përfitim.

Ky është edhe shkaku kryesor që i detyroi dibranët nga viti 1969 të emigrojnë masivisht për në SHBA, në kërkim për të siguruar bukën e gojës."

Nga ata që janë deklaruar me gojë dhe me shkrim një metër katror tokë e mbytur në Luginën e Drinit të Zi, pasojë e ndërtimit të Skavicës, do të shpërblehet me 700 lekë të vjetra, me 50 cent, as edhe me një akullore me kaush nga lloji i atyre që shiteshin dikur në pazarin e Peshkopisë ngrirë me borë malesh.

Nga ato që janë thënë dhe shkruar të dyzet mijë banorët e Luginës së Drinit do të imigrojnë dhe emigrojnë në kërkim të "tokës së dhënë" si në migrimet biblike, pa një "Moisi" që tu prijë.

Profesori i nderuar në mbyllje deklaron: "Ne, dibranët, do t'i luftojmë këto çështje dhe këto padrejtësi me të gjitha mjetet e mundshme paqësore e demokratike, do t'i drejtohemi së fundit edhe Gjykatës së Strasburgut për t'i mbrojtur dhe për t'ia kthyer lumin Radikë dhe këto bukuri Dibrës së Madhe."

Mesazhi që përcjell Prof. Dr. Inxh. Abdyl KOLECI për "andej kufirit shqiptaro-shqiptar" është një PARALAJMËRIM për atë që do të ndodhë në qoftë se dibranët e Dibrës së Poshtme do të lejojnë të mbytet Dibra, të mbytet begatia që rrjedh nga Lugina Pjellore e Drinit të Zi, të mbytet kujtesa historike e lidhur me të parët e asaj treve, me varret ende të freskëta në kujtesën e tyre.

Faleminderit Profesor Koleci! Na dhe një mësim që duhet lexuar me mend e me kalem.

* * *

Shënimi: - Ndërsa kisha vënë pikën e fundit në falënderimin tim vetjak për Profesor Abdyl Kolecin, ERT - televizioni shtetëror grek, përcolli një reportazh të bukur me temë "Dasma Dibrane", me pamje të natyrës, kostumeve, këngëve e valleve të trevës së Dibrës, me vlerësime superiore. Një miku im që e dinte dobësinë time për Luginën e Drinit dhe Malet e Dibrës më tha: "Është krim që ajo luginë e bukur të mbytet..."

*Athinë, 23 prill 2012*

reportazh

Kjo pemë -cung tek pragu i Udhës së Arbërit dëshmon ndodhi tragjikomike, qëndresë e bujari.

# Pema tek pragu i Udhës së Arbërit



*Nga:* **PETRO LUARASI**

**Si shumëkush kam ëndërruar atë që thuhet se do të bëhet realitet: Rruga e Arbrit e përfshirë në planet rinovuese të qeverisë shqiptare do të përmirësojë e shkurtojë deri në vitin 2013 rrugëtimin nga Tirana për në lindje të trevave arbërore, madje, siç thuhet, mund të shdërrohet në koridorin më të rëndësishëm që lidh Tiranën, Dibrën, Shkupin , Sofjen, etj. Le të përfytyrojmë udhëtimin e mrekullueshëm nga sheshi "Skënderbej" nëpër urën e Brarit për tek shkalla e Tujanit, mes kanioneve mahnitëse të malit të Dajtit, luginat e Shpalit, Murrizës, tunelin e Urën e Vashës mbi lumin e Matit, luginën e Planit të Bardhë dhe tunelin e Qafës së Buallit, fushën e Gjoricës deri tutje në Dibër të Madhe.**

**Kjo pemë- cung, kreaturë e degjenerimit njerëzor dhe deformimit genetik (shkurtabiqe e kërrusur gunga-gunga, e rrjepur nga koha e vandalizmi, me zgavra të kalbëzuara e boshllëk pa palcë ) është monument i madhërishëm në brendinë e saj: dëshmitare fillikate ndodhish tragjikomike dhe simbol qëndrese e bujarie. Ndonëse i lëkundet trungu i stërlodhur, ka uri e etje, por deri në grahmën e fundit të mbijetesës i ushqen degëzat me gjethe ( tok me lëmyshqet parazitarë).**

### UDHA E ARBËRIT

Në pesë dekada jetë kam udhëtuar vetëm një herë përgjatë gjithë udhës së vështirë të Arbërit (me termin zyrtar "Rruga e Dibrës") e cila ndër mendjet e begata rrezaton vlera madhore historike, kulturore e strategjike, që nga periudha e lashtë romake.

Por pragu i rrugës, të cilin e njoh mirë, më çel dhjetra kujtime: rendje mes tufës vocërrake për tek fusha e Medresesë, marshime kacavjerrëse rinore për tek maja e malit të Dajtit, "betejën e gurëve" me "puçistët" tek Shkolla e Bashkuar, ca fantazma surretërish sypërgjakur majë tankesh në atë vitin e nxirrë të 97-tës apo ndarje të përjetëshme nga shokë, miq e farefis tek gropat e qoftëlargut.

Si shumëkush kam ëndërruar atë që thuhet se do të bëhet realitet: Rruga e Arbrit e përfshirë në planet rinovuese të qeverisë shqiptare do të përmirësojë e shkurtojë deri në vitin 2013 rrugëtimin nga Tirana për në lindje të trevave arbërore, madje, siç thuhet, mund të shdërrohet në koridorin më të rëndësishëm që lidh Tiranën, Dibrën, Shkupin , Sofjen, etj. Le të përfytyrojmë udhëtimin e mrekullueshëm nga sheshi "Skënderbej" nëpër urën e Brarit për tek shkalla e Tujanit, mes kanioneve mahnitëse të malit të Dajtit, luginat e Shpalit, Murrizës, tunelin e Urën e Vashës mbi lumin e Matit, luginën e Planit të Bardhë dhe tunelin e Qafës së Buallit, fushën e Gjoricës deri tutje në Dibër të Madhe.

O treva të bekuara arbërore që aq madhërishëm ju ka qëndisur Natyra, më në fund shqiptari do të mund t'ju sodisë me komoditet e vitit të 13-të të shekullit XXI! Vërtet do ta arrijmë këtë mrekulli?

### PEMA FILLIKATE

Që në moshën njomëzake pemët ma kanë rrëmbyer zemrën dhe ngatërruar mendjen: me simbolikat që më përfaqnin apo me proceset e ndërlikuara të ndërthurjes së elementeve më jetësorë (oksigjenit, ujit, dritës). Ndër rrugëtime kam fiksuar shembëlltyra të shumëllojshme rrënjësh, trungjesh, degëzash, me të bukurat lule.

Edhe tek pragu i Udhës së Arbërit kujtesa më ka pozuar një varg pemësh panje, të cilat syri m'i ka parë të mbilleshin si fidane dekorative teksa fantazia i përfytyronte të lartonin dita-ditës trungun e hijshëm degëgjerë duke gjelbëruar përgjatë rrugës shpirtrat njerëzore.

Gjymtyrët e atyre pemëve në përfytyrimin tim zbërthenin elementë të Arbërit, i doja, i himnizoja, i adhuroja me rrënjë, trung, degë e gjethe (ndonëse natyra nuk u çelte lule)

Rrënjët ua përfytyroja si trashëgimitë historike, kulturore e arsimore; trungun si trim legjendar, rilindas martir a dëshmor antifashist, degëzat si bashkëkohës të përkushtuar atdhetarë, intelektualë, politikanë dhe ah, sa keq që u mungonin lulet: kontributet e tyre për kombin!

Përkundër imagjinatës fluturake, me dhimbje shihja vargun e viteve të vegjetimit të atyre të ashtuquajturave pemë dekorative, tek deformoheshin gjithnjë e më keq, pa kujdesin njerëzor. Në monotoninë e mjerimit më shprehnin, secila në mënyrën e vet, gjendje e ndjesi melankolike, por edhe kurajo e vendosmëri për mbijetesë.

Një ditë të vrenjtur pranvere, e diel votimi, relativisht e qetë përkundër zhurmimit marramendës elektoral, shikova një tablo krejt ndryshe. Ballas pragut të Udhës së Arbrit, banderolat e flamujt partiakë, harxhe milionëshe të popullit, garonin të mbulonin malin e Dajtit e të errësonin dritën e diellit. Në të majtë, tek një shtëpi suvarrjepur varej buzagaz posteri i stërmadh i politikanit republikan që qari me qederin e lidhi pas Gërdecit. Djathtas rrugës, trungjet, çuditshëm, si iriqi gjembat, kishin nxjerrë degët si ushta, ku për gazep kacavirreshin gjithfarë hedhurinash: lecka, copra gazetash, shirita, flamuj e postera partish, tullumbacë të shpuar e lule artificiale, madje edhe të brendëshme. Në nxitim e sipër nuk pata mundësi ta fiksoj në foto maskaradën tragjikomike. Kur e pata ngenë, qe vonë, banderolat e flamujt qenë hequr, degët e pemëve qenë "krasitur", edhe trungjet me gjithë rrënjë.

U akuzuan "gojëliqtë që përflasin politikën" se "ndëshkoi pemët për të zhdukur gjurmët". Sido të jetë shkaku, pasojat kanë mbetur deri më sot. Kanë rrjedhur vite, janë derdhur lumenj premtimesh për "oazet e gjelbëra" nga politikanë, donatorë e ambjentalistë, por tek kreu i Udhës së Arbërit vegjeton vetëm një cung peme, sfidante e pamposhtur e shkretimit.



Kjo pemë- cung, kreaturë e degjenerimit njerëzor dhe deformimit genetik (shkurtabiqe e kërrusur gunga-gunga, e rrjepur nga koha e vandalizmi, me zgavra të kalbëzuara e boshllëk pa palcë) është monument i madhërishëm në brendinë e saj: dëshmitare fillikate ndodhish tragjikomike dhe simbol qëndrese e bujarie. Ndonëse i lëkundet trungu i stërlodhur, ka uri e etje, por deri në grahmën e fundit të mbijetesës i ushqen degëzat me gjethe (tok me lëmyshqet parazitarë).

Teksa po kallja kujtime ëndërrash shpresëkota dhe pemësh simbolike, më kapi veshi një psherëtimë përkarshi: "Ndë u rrëzoftë ky cungu i kalbur ku dreqin ta vë antenën e televizorit?!"

Ky zë i kobshëm i skëterrës zgjoi mendjen dhe ndezi genin arbëror të paraardhësit martir: " Edhe 99 herë të rrëzohemi, përsëri duhet të ngrihemi!".

Tashmë, karshi cungut gjendet një fidan i njomë që nuk do të keqpërdoret më si "antenë" politikqenërish por si simboli i Udhës ngadhnjimtare të Arbërit.

**Reagim i Prefektit të Dibrës**

# Rruga… mbetur në mes të rrugës

*Nga:* **SHAQIR SKARRA**

Para disa vitesh kur atëherë sapo ishte hedhur në treg gazeta "Rruga e Arbërit", një miku im dibranë, intelektual, më pati thënë:"Rruga e Arbërit është një utopi, është një premtim elektoral, nuk do të realizohet asnjëherë". Thënjen e këtij mikut nuk e mbajta për vete por e kalova gojë më gojë tek të gjithë dibranët ku janë e nuk janë. Pikërisht duke marrë shkas nga kjo thnënje e këtij dibrani, ish prefekti i Dibrës dhe miku i gjithë dibranëve më pati thënë:"Rruga e arbërit do të bëhet por unë kam dëshirë të ndërtohet nga qeveria ime" Kaluan ditë, muaj, vite. U hapën vetëm pak kilometra trase, u shtruan vetëm pak shtresa asfalti, u ndërtuan disa ura, u ristrukturua një rrugë ekzistuese dhe e gjitha kjo u trumbetua se është nisma e qeverisë shqiptare për të ndërtuar projektin më të madh jo vetëm për dibranët por për gjithë shqiptarët këndej dhe matanë kufirit, rrugën e Arbërit. E gjitha kjo të paktën deri tani ishte dhe mbeti një demogagji, ishte dhe mbeti një projekt tashmë i përfunduar dhe i dorzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve por vetëm në letra e strehuar diku në ndonjë sirtar burokrati. Aq shumë është politizuar ky projekt sa them me bindje se asnjë projekt tjetër nuk është politizuar ndryshe. U



premtuan dibranëve se do ta ndërtojmë rrugën e Arbërit dhe në fakt për çudi nisën punimet, nisën me ceremoni festive në Bulqizë drejt urës së Çerenecit, nisën dhe mbaruan në kohë rekord ku u bë dhe inagurimi i këtij segmenti.E gjitha kjo rrugë shkurtoi nga rruga ekzistuese vetëm pesë kilometra. Pra e gjithë traseja zgjatej në rrugën ekzistuese, u hapën ca kthesa, u ndërtuan ca mure u bënë ca shtresa me asfalt dhe u trombetua se mbaroi segmenti i parë i rrugës së Arbërit, por e keqja më e madhe ndodhi shumë shpejt se pikërisht kjo rrugë pa bërë ende vitin filloi të prishet, të shembet e asfalti filloi të krijoj ato gungat në mes të rrugës që jemi mësuar rëndom të shikojmë tej për tej nëpër trasetë e rrugëve tona .Besuan shumë dibranët se kjo rrugë e sapo filluar dhe do mbarojë së shpejti, por në fakt jo vetëm dibranët por të gjithë u zhgënjyen.Pas mbarimit të këtij segmenti ku u quajt rruga e arbërit dhe që në fakt traseja zgjatej në rrugën ekzistuese filuan punimet në Bulqizë drejt luginës së Planit të Bardhë e ndarë kjo pa tunelin Qafës së Buallit në dy lote.

*(Vijon në faqen 9)*

Rruga e Arbërit nr. 72

edukim



# Gurthemeli për ndërtesën e re të Gjimnazit në Dibër të Madhe

## *Për arsimin shqip dibranët rrezatuan në të gjitha hapësirat shqiptare*

*Nga* **REXHEP TORTE**

Në praninë e. Ali Ahmetit, lider i BDI-së, Safet Neziri, zv/ministër i arsimit të Maqedonisë, Gjeneralit Gëzim Ostreni, Argëtim Fida, kryetar i Komunës dhe Petrit Imami, kryetar i KK të Dibrës së Madhe, të këshilltarëve të KK, të mr. Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës. të kryetarëve të komunave shqiptare, pedagogëve veteranë dhe të tanishëm, si edhe të një numri të madh të përfaqësuesve të institucioneve, bizneseve që veprojnë në Dibër, dhe qytetarëve dashamirë të arsimit, të enjten më datë 28 mars 2012, pas afër gjysëm shekulli, u vu gurthemeli i ndërtesës së re të gjimnazit të shkollës së vetme të mesme në Dibër, në të cilën aktualisht mësopjnë 800 nxënës nga Dibra dhe qytete e tjera.

Qamil Marku, drejtor i Gjimnazit, u theksoi se, "Ndjehem shumë i gëzuar, shumë i nderuar që sot paraqitem para jush në një ditë të rëndësishme, në një moment fatlum për shkollën tonë siç është vënia e gurthemelit të shkollës së re.

Ky është një gëzim edhe për të gjithë kolegët, sepse tash krijohen hapësira të përshtatshme për të zhvilluar procesin mësimor, por gjithashtu ky gëzim pështkon qytetarët, të gjithë arsimdashësit, të cilët e duan arsimin dhe e kuptojnë rëndësinë e tij në edukimin dhe arsimimn e nxënësve.

Çdo vepër e madhe nuk krijohet lehtë, pa mundime dhe pa sakrifica. Edhe gjimnazi ynë kur u hap në vitin 1960 nuk u hap lehtë, por me shumë sakrifica e sfida. Në hapjen e tij ndikoi dëshira dhe vullneti i intelektualëve dibranë dhe i të gjithë qytetarëve arsimdashës të cilët trasuan rrugën për hapjen e këtij institucioni të rëndësishëm edukativ dhe arsimor. U deshtën përpjekje dhe u deshtën të krijohen kuadro arsimore. Të gjitha këto u krijuan, u gjetën dhe u sistemuan. Arsimtarët e parë, nga të cilët kemi dëshmitar edhe sot, iu përveshën punës me zell, punuan në fillim dhe vullnetarisht, me dashuri, humanizëm e me seriozitet dhe arritën ta ngrejnë këtë institucion në nivele të larta arsimore.

Koha dëshmoi fuqishëm rolin e rëndësishëm të pedagogëve me nxjerrjen e shumë brezave që sot gëzojnë respekt në detyrat dhe profesionet që ata kanë kryer apo kryejnë aktualisht.

Menjëherë pas tërmetit të vitit 1977 në Dibër të madhe, si ndihmë e Universitetit dhe studentëve të Breshias – Itali, u ndërtua shkolla barakë në të cilën u shkolluan me qindra e qindra breza, shkollë kjo që nga dita në ditë, nga viti në vit po bëhej gjithnjë më e ngushtë dhe spontanisht, si një shkollë e përkohshme filloi të mplaket, vjetërrohet dhe vetvetiu nga vet koha edhe shkatërrohet. Nevoja që qyteti ynë të ketë një ndërtesë të re si shkollë e mesme, gjithnjë e më tepër vetvetiu imponohej e duke filluar nga vitet e 80-ta të shekullit që lamë pas, kërkesa nëpër organet e larta shtetërore dhe të Ministrisë të Arsimit sa vinin e shtoheshin, por si zakonisht, për fat të keq mbeteshin pa ndonjë përgjigje konkrete, megjithatë kjo nuk na deshirës si dhe i nevojës së pashmangshme për një shkollë të re me klasë të mjaftueshme, por edhe si rezulltat i kursimeve të mjeteve financiare dhe bashkëpunimit tejet të ngushtë me organet e pushtetit lokal, po hedhim themelet e një shkolle adekuate me 34 kabinete dhe hapsira tjera punuese. Me shkollën e re do të kemi hapsira të reja për mësim dhe për aktivitete të lira kulturore, për të cilat ka nevojë shkolla dhe kanë nevojë qytetarët. Besoj se shkolla e re, kushtet e reja të punës në të, do të ndikojnë në cilësinë e procesit mësimor, në ngritjen e kulturës dhe edukatës qytetare , në bashkëpunim reciprok, në tolerancën dhe bashkëjetesën, në formimin e brezave që shijojnë jetën e re demokratike dhe që respektojnë vlerat njerzore.

Dhe ja sot të gjithë ne jemi dëshmitarë të kësaj ëndre të kahmotshme që po bëhet realitet, me çka shkruhet historia e re për këtë shkollë të mesme dhe për këtë qytet arsmidashës. Falenderojnë pa masë përkrahjen dhe nxitjen morale dhe materiale që pushteti lokal i komusës sonë, pa as më të voglin hezitim po jep për realizimin këtij evenimenti të nevojshëm dhe dinjitoz. Krahas pushtetit lokal dhe me ndihmën parezervë të deputetëve tanë në Parlamentin e Maqedonisë, në organet e larta shtetërore dhe Ministrinë e Arsimit dhe të Financave, në mënyrë permanente do të kërkohen të jepen dhe gjenden mjetetet e nevojshme për përfundimin e këtij objekti më se të nevojshëm për qyteti tonë. Shpresojmë se këto kërkesa do të gjejnë mbështetjen e duhur dhe mirëkuptim dhe ëndrra e kahmotshme njëherë e përgjithmon të bëhet realitet. E gëzofshim pra shkollën e re dhe na shkoftë puna mbarë dhe sa më shpejt të arrijmë përfundimin e ktëij evenimenti shumë të rëndësishëm arsimor", tha në fund drejtori Qamil Marku.

Argëtim Fida, kryetar i Komunës, shtoi se, "Unë si nxënës i kësaj shkolle, si bir i njërit prej pedagogëve, nisa realizimin e një amaneti të dhënë. Amanetin e të gjithë atyre brezave që vullnetarisht punuan më se një vit për të hapur këtë institucion. Ishte amaneti i të gjithë atyre plejadave të nxënësve nga Dibra e Madhe, por edhe nga Zhitosha, Pellagonia, Manastiri, Kërçova dhe Struga. Që këtu gjetën folenë e ngrohtë, gjetën arsimtarët, të cilët jo vetëm që ishin pishtarët e arsimit në Dibër të Madhe e më gjërë. Ata mësues të Normales së Elbasanit që përhapën arsimin në këto troje shqiptare. Sot Dibra ka festë pasi që ne u dëshmuam se jemi mësues të mirë, dëshmuam se dijmë ta punojmë gjipsin mirë, se dijmë të menaxhojmë me Banjat termominerale të Dibrës së Madhe dhe me pasuritë natyrore, por gjithmonë më shpirtin e dibranëve ka qenë dashuria për arsimin. Sot e kësaj dite qyteti ynë për kokë të banorit në nivel shtetëror pa dallim etnie u bë qytet edhe me arsim sipëror me dëgët e Fizioterapisë dhe mësimin e gjuhëve të huaja. Ne si pushtet vendor sot për ta bërë këtë ditë feste filluam me idenë që nga viti 2005,me ardhjen e BDI-së në pushtet. Hartuam planin detal urbanistik me çka u caktua lokacioni, pastaj u hartua projekti i ri për ndërtimin e një palestre të re sportive, e cila u ndërtua si parakusht për ndërtimin e ndërtesës së re të Gjimnazit. Për planin urbanistik, projektin dhe shpimet gjeodezike të tokës komuna investtoi 70 mijë euro. Ndërkaq komuna në bashkëpunim me drejtorinë e Gjimnazit për pesë vite rrjesht kursyen nga 50 mijë euro, kështu që për fillimin e punimeve të ndërtesës së re të Gjimnazit u siguruan 250 mijë euro. Ndërtesa e re e Gjimnazit do të ketë 34 kabinete. Dibra e Madhe është dëshmuar si shembullore për bashkëjetesën me bashkësitë e tjera etnike, duke treguar se në këtë shtet dijmë të krijojmë vend dhe hapësirë për të gjithë. Nxënësit e kësaj shkolle janë fitues edhe të shumë garave në nivel rajonal e republikan", tha kryetari Argëtim Fida.

Safet Neziri, zv/ministër i arsimit të Maqedonisë, u shpreh se, "Sot këtu në Dibër të Madhe nis realizimi i kërkesës së kahmotshme, nevojës së domosdoshme të këtij qyteti dhe fshatrave për rreth, për të siguruar kushte hapësinore për zhvillim normal të procesit edukativo-arsimor për nxënësit e shkollës së mesme.

Në fakt, kjo u bë çështje imediate që kur hapësirat shkollore ku mbahet mësimi u bënë të paqëndrueshme dhe që kur arsimi i mesëm u bë i obligueshëm, që nënkuptonte edhe rritjen e numrit të nxënësve.Pra, të nderuar të pranishëm, sot duke vënë gurrëthemelin e Qendrës shkollore, të gjimnazit dhe profileve të tjera profesionale, pa mëdyshje tejkalohet një problem me të cilin komuna dhe nxënësit ishin ballafaquar vite me rradhë.

Nisim ndërtimin e një objekti të ri shkollor për nevojat e arsimit të mesëm në komunën e Dibrës së Madhe , gjegjësisht i shmangemi detyrimit që nxënësit më tutje most ë mësojnë nëpër baraka dhe pa kushte normale për mësimmbajtje.

Mjedisi që ka dhënë aq shumë profesionistë dhe profile të segmenteve të rëndësishme shoqërore dhe që kanë ndihmuar në proceset shoqërore, me siguri se meriton një objekt të ri shkollor, si për të kaluarën e suksesshme, ashtu edhe për të ardhmen premtuese.

Në konteks të inaugurimit të qendrës së re shkollore këtu në Dibër, edhe njeriu më i rëndomtë nuk mund t'i shmanget faktit se procesi i decentralizimit ka ecur me dinamikën e paraparë. Fakti që vet komuna ka siguruar 15 milion denarë për objektin e ri shkollor, flet qartë se sa me sukses komuna është menaxhuar në të gjitha aspektet dhe segmentete saj.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Maqedonisë, të nderuar të pranishëm, në kuadër të kompetencave dhe politikave të saj arsimore, gjegjësisht të ndërtimit të objekteve të reja shkollore, padyshim se do të përkujdeset që objekti që sot po inagurohet, sa më shpejt që është e mundur të lëshohet në përdorim dhe nxënësit të mund të mësojnë dhe arsimtarët të punojnë në kushte dhe standarde, ashtu siç i kanë pjesa dërmuese e shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë. Përfitoj nga rasti të uroj që Dibra e Madhe sa më shpejt të bëhet me qendër të re shkollore. Besoj se deri te ndërtimi final do të arrihet shpejt, sepse në këtë çështje do të angazhohemi maksimalisht, si ne në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës ashtu edhe kompetentët e komunes së Dibrës së Madhe" u shpreh zv/ miniatri Safet Neziri.

Ali Ahmeti, lider i BDI-së, duke përshëndetur të pranishmit deklaroi se, " Kam ardhur në Dibër të Madhe për ta ndarë këtë gëzim me ju për vënien e gurthemelit e Gjimnazit. Bashkë me Ju sot përkujtojmë të gjitha plejadat e mësuesve arsimdashësve, të cilët si rrezja e dritës që depërton në rruzullin tokësor, ashtu edhe për shkollimin shqip dibranët rrezatuan në të gjitha hapësirat shqiptare. Prandaj ndjej obligim t'i kujtoj pë jetë të jetëve, ata që kanë vendosur gurthemelet, njashtu siç sot po vendosin këtë gurthemel, që ne shqiptarët sot të përparojmë në fushën e arsimit. Mësuesit e parë nga Dibra e Madhe janë të shumtë. Ata misioinin e tyre e kryen duke filluar që nga Ohri e gjer në Mitrovicë, Istog e Gjakovë e Manastir. Kur diskrimonohej arsimi shqip mu në ditë të vështira gjithandej, nxënësit shqipttarë nga Kërçova, Manastiri dhe nga Gostivari këtu gjetën strehën e ngrohtë. Ja erdhi momenti që ne të investojmë në arsim, është momenti të reflektojmë, të shikojmë se ku e kemi gjendjen në arsimin tonë, duke filluar nga ai fillor e gjer te ai sipëror. Nga arsimi varet begatia, përparimi dhe varet e ardhmja. Prandaj duhet përkushtim sa më të madh për arsimin, punë e pa lodhur. Të ndëruar arsimtarë e profesorë, të punojmë për arsimin, për shkollimin, sepse vetëm me shkollim shkollë ne mund të ecim përpara. Disa thonin se në Dibër nuk mund të ketë arsimim të lartë, ja që ndodhi.Dikush mund të mendonte se kaqë salla sportive moderne nuk mund të ndërtohen, ja që u ndërtuan.Disa mund të mendojnë se edhe gjimnazi nuk mund të bëhet, ja që u fillua dhe do të përfundojë. Të nderuar të pranishëm gjërat fillojnë nga zemra, gjërat fillojnë nga shpirti e Gjimnazi do të behet nga përkraja që e jep kryetari i komunës. Urime e gjithmonë ardhshim për inagurime". tha në fund lideri Ali Ahmeti.

Me këtë rast nxënësit e Gjimnazit shfaqën një program artistic me këngë e recitime.

Pas kësaj u bë ceremonia e therrjes së kurbanit, u këndua duhaja dhe lopatën e parë me beton në gurthemel e hudhi Ali Ahmeti, lideri i BDI-së.

etnokulturë

# "A po gjegji, po na vjen Shëngjergji"

*Nga:* **NAIM PLAKU**

Na erdhi 6 Maji, Dita e Shëngjergjit. Një ndër festat më të bukura të natyrës. Festa e vërtetë e verës në anët tona, festa e luleve, e gjelbërimit, e përtëritjes, e lindjeve të reja, e qingjave dhe e kecave të njomë, festa e qumshtit të bardhë, festa më e dashur e fëmijëve. E kemi te pragu i derës. Shëndet, forcë, begati e lumturi…Le të rrjedhë jeta si ujërat e begatë të pranverës që vrapojnë nën mugullimin dhe gjelbërimin e pafund, plot freski, bukuri dhe aromë lulesh! Festohet në gjithë Shqipërinë, por paksa më e veçantë e, ndoshta paksa më e bukur, është në Dibër. Nuk është festë e romëve, siç kemi dëgjuar ta quajë dikush. Nuk është as festë e ndonjë prej feve që janë praktikuar e praktikohen aktualisht. Nuk është as myslimane, as hebreje, as katolike apo ortodokse, as e alenëve apo e liliputëve. Është festë e të gjithëve… Gjithkush që e përqafoi dhe u mundua ta praktikojë e ta respektojë, ta ndjekë e ta ruajë sa më mirë sipas traditës, u bashkua dhe u bë një me natyrën, me gëzimin dhe harenë e saj. Megjithatë, gjatë rrugës së gjatë mijëravjeçare, ndoshta, që kur u krijua njerëzimi, herë hoqi e herë vuri diçka në fytyrën e saj të re, herë pakësoj e herë shtoi në truket e saj joshëse, herë hoqi e vuri xhingrra e bojëra, por përsëri mbeti ashtu siç është: vërtet e re, vërtet e gjelbërt, vërtet e bukur! Po çfarë u hoqën dhe çfarë u shtuan në trungun e saj? U hoqën ca degë të thara për të mugulluar më mirë të tjerat. U shtuan gjethet e lulet, tufat e gjësë së gjallë, pemët dhe kopshtet, djemtë dhe nuset. U shtuan këngët dhe vallet, blegërmat dhe sazet…

Hej, kohë e perenduar në sytë e pleqve dhe plakave! Sa dëshirë do të kishim t'i hapnim sëndukët e artë të kujtimeve tona dhe t'i shpalosnim si dikur këto ditë të shoqëruara me gjithë ato fllade melodish të ëmbla dhe të serta; burra, gra e fëmijë me rroba e veshje të hijshme që fluturonion e shpaloseshin mbi kreshta malesh, ato dollamë të bardha si shpatet e maleve me borë të lidhur me brezin e kuq si diell i përflakur vere, ato këmisha birinxhike nusesh me fjongo jeshile si pishat e larta, ato këmishë të bardha me lule bjeshkësh në gjoks e në mëngë, ato jelekë mavi si qielli e me sumbulla arie si hëna që na rri mbi krye, me ata tirqë plot gajtanë të drejtë e të shtërnguar si lisat mbi shkrepa shkëmbinjsh, me ata dy këmbë vigane, të larta e të drejta ngulur fort mbi dy brigjet e Drinit të moçëm.

Shëngjergji është një ndër festat më të bukura, sepse të bukur e bën jo vetëm natyra që hap gjirin e saj të virgjër plot bukuri, por dhe punët e pritshme të blegtorit e bujkut që do të sjellin mbarësi e begati. Të bukura janë jo vetëm lulet, por dhe djersa e ballit, dhe syri i përflakur, dhe grushti i shtërnguar, dhe llërët e përveshura.. Një fillimi i bukur, por dhe i lodhshëm, një stinë me shumë hijeshi, gëzim e punë. Shëngjergji, në radhë të parë, është festë e blegtorisë, sepse delet e dhitë, lopët dhe kafshët e samarit dalin lirshëm në kullotat verore ku kanë banuar, pasi janë kthyer nga shtegtimi dimëror, nga një emigrim stinor në vendet e jallisë, që kishte shumë vështirësi e probleme sociale. Tashmë do të nisnin ato punët e përvitshme që janë themelore për një ekonomi fshatare. Ndaheshin qingjat e kecat, bëhej qethja e të imëtave, përgatiteshin stanet për verim, përgatiteshin materialet e nevojshme për baxhat e përpunimit të qumështit, merreshin masat për një mbarështim sa më të mirë të tufave, caktoheshin çobanët, ndaheshin detyrat, etj. Po kaq punë kishte dhe bujqësia. Mbilleshin të lashtat verore si thekër, elb, tërshërë, grurë, etj., pastroheshin jonxhat, parcelat; mbillej misri dhe të lashtat verore, farishtet në kopshtie, punoheshin pemët, krasitej rrushi, etj., etj… Gjithçka bëhej për të filluar punët e mëdha që ia diktonte jeta fshatarit tonë, prandaj dëshirohej e kërkohej mbarësi, e cila shprehej nëpërmjet riteve të shumtë e lirikave të bukura që i shoqëronin këto për të patur shëndet e lumturi, forcë e vullnet në përballimin e gjithë këtyre punëve.

Shëngjergji është një festë pagane siç janë dhe Llazoret, Dita e Verës, Novruzi, Shëmitri, Shëmëria, Shënkolli, Shënvalentini, etj., të cilat u përshtatën ose u përdorën si ditë e data referimi më vonë duke u identifikua me emra shenjtorësh. Kjo është të lehtësisht e kuptueshme, se në përgjithësi ato u përkasin ndryshimeve të motmotit, ekuinokseve, muajve hënor, kalendareve të ndryshme të vitit, siç janë Kërshëndellat ( nëndial. -Këshnellat) që përkojnë me Vitin e Ri, Novruzi më 22 mars (ekuinoksi i pranverës), Shëmria më 22 gusht. Po kështu ishin dhe Shëngjergji e Shënmitri (Shëndhimitri, Shmitri), që diku-diku festohen respektivisht me 22 prill e 22 tetor me kalendarin Gregorian. Shumë kohë më parë këto dy festa tek ne janë ngulitur mirë e festohen me 6 maj-Shëngjergji dhe me 6 tetor-Shëmitri, plot gjashtë muaj ose gjysmë viti larg njeri-tjetrit. Këto përkojnë me dy faza të rëndësishme për blegtorinë që lidhen kryesisht me shtegtimin: ngjitja e bagëtisë në bjeshkë për verim (Shëngjergji) dhe kthimin e tyre nga kullotat verore (Shëmitri).

Shëngjergji, por edhe Shëmitri, si festa të natyrës janë praktikuar gjërësisht nga ilirët. Kjo është e dokumentuar nga historianët dhe etnologët. Emrat e shenjtorëve i morën më vonë, në perudhën e sundimit romak, kohë kur jetuan shenjtorët Gjergj e Dhimitër aty nga fundi i shek. II dhe fillimi i shek. III të e.s. (pas krishtit), gjatë e sundimit të perandorit Dioklecian. Të dy këta shenjtorë janë përafërsisht të njëkohshëm dhe kanë historitë e tyre tragjike të sakrificës në emër të lumturisë së njerëzimit. Patronimet e mëvonshme që u përdorën aq dendur tek të krishterët edhe në Shqipëri u bënë sipas zakonit të njohur për të vënë emrat që përkojnë me ditët e shënuara, si Gjergj, Dhimitër, Novruz, Ramazan, Bajram, Kristinë, Mari, etj. Kështu dhe me toponimet. Janë qindra toponime në mbarë Dibrën që mbajnë emrin Shëngjergj, bjeshkë, male, burime, kroje, përrenj e lumenj, ura e kala, etj.

Në Dibër Shëngjergji është festuar kudo e vazhdon të ruhet kjo traditë e mirë, megjithëse koha ka hequr nga përdorimi shumë nga ritet dhe krijimet artistike, si lodra popullore, këngë e valle shumë të bukura që lidheshin me mjedisin e këndshëm dhe me natyrën. Përsëri diçka ka mbetur, diçka është mbledhur e diçka praktikohet. Që Shëngjergji ka qenë festa më e rëndësishme e natyrës për trevën tonë, këtë e dëshmojnë plotësisht ritualet e shumta që praktikoheshin, këngët, vallet dhe lojërat rinore që shoqëronin këto rite, të cilat vazhdonin një javë të tërë e finalizoheshin me ditën e Shëngjergjit. Ndër më të rëndësishmet që ishin dhe që mbahen mend e diku-diku praktikohet dhe sot ishte **patkimi**. Shih: ***/Kur të shkoni me patku,/thajrmëni ne mu!/Fushë më fushë e prru më prru,/ Merrmëni ne mu!//*** Praktikohej nga djemtë e vajzat të rinjtë e rrallë merrnin pjesë nuset. Ata grumbulloheshin çdo pasdite një javë para në një vend të caktuar dhe secila mbante nën sqetull një tas apo një sahan të mbushur me përshesh bukë e kripë e ndonjëherë dhe sheqer apo ndonjë ëmbëlsirë. Ky grup shetiste tërë mbrëmjes në vendet e caktuara duke kënduar e duke hedhur valle lëndinë më lëndinë . Ishte vërtet një shpërthim ndjenjash njerëzore plot bukuri. Duke kaluar nëpër këta vende të njohura pëshpëritnin e këndonin diku nën zë e diku me zë formulat në vargje, yshtje e këngë mbi barin e livadheve, mbi lulet, në ferra e pemë, mbi burimet e ujërave, mbi shkëmbenj të thepisur, në grumbuj milingonash, në rrasat e gjollës, në trinat dhe shtrungat e vathës, në kullota e bëshme, në lugjet dhe lisat, mbi kaçe e kulumbri, mbi thana e bajame që ishin dhe të parat lajmëtare të verës. Gjithçka ishte simbolike dhe lidhej me dëshirën për të pasur mbarësi në familje, fatbardhësi, shëndet e pjellori gjësë së gjallë, bimëve e pemëve, etj…

Të gjitha këto rite shoqëroheshin me këngë e valle, me veprime konkrete që praktikoheshin në mjediset e një natyre që ishte mbuluar nga gjelbërimi i pafund. Prandaj dhe



© Foto: Bujar Karoshi

ekzekutimi i tyre krijonte nje harmoni që lindte natyrshëm e pa komplekse dhe i tillë përfundonte. Mendoni për një çast mbrëmje të tilla kur tufat e deleve e të dhive zbrisnin për në katund të prirë nga qenë karabashë së bashku me kumbimin e zileve e të kumborëve mbi qafën e deshëve e të cjepëve ogiçë që tundeshin e përkundeshin nga majmëria dhe këngët e vajzave dhe djemve majë kodrave që pritnin tufat:

***Ore zog bilbili***
***Çeli tranafili…***
***Shënxhexhi na erdh,***
***Dukati me rreth.***
***Shënxhexhi te dera***
***Me dhen e me shqerra.***
***Shënxhexhi te votra,***
***Me vllazën, me motra…***

Shumica e banorëve në Dibër i shtegtonin bagëtinë gjatë muajve të dimrit në ultësirat bregdetare, në Tiranë, Durrës, Fier, por dhe në Manastir, Selanik, etj. dhe ktheheshin para Shëngjergjit. Kthimi i tyre ishte një festë e veçantë plot rite e këngë. Po japim dy fragmente interesantë të dy këngëve që këndoheshin për Shëngjergj, njera në katundet e Tiranës e tjetra në viset e Dibrës:

***O Shëngjergj, me shëndet,***
***Shkojnë malokët n'vend të vet…***

(Iknin ata që kishin ardhur për të dimëruar bagëtinë në Tiranë)

***Çeli lisi qak,***
***Po vijnë tufat varg e varg.***
***Ishin larg, po na vijnë ngat…***

(Këndojnë ato që prisnin tufat që kthehen nga shtegtimi prej Tirane)

Ritet e Shëngjergjit janë të shumëta, por ne po sjellim vetëm ndonjerën që ndoshta është më e veçanta. Vajzat që patkonin shkonin pranë një trëndafili të egër dhe në gjembat e tij ngulnin aq kore buke sa djem kishin në shtëpi. Këtë e bënin duke yshtur:

***Bardhekuq nusja e Dritanit,***
***Ardhsh sinjet me bereqet!***

si edhe yshtjet për të pasur shëndet të gjithë pjesëtarët e familjes e duke fërkuar shpinën pas një guri të madh e të rrumbullakët :

***Shpina jote çull,***
***Shpina e Dritanit gjur, etj…***

Dita e Shëngjergjit shoqërohej dhe me shumë rite të tjera nga të rriturit. Heret në mëngjes, pa zbardhur dita në tërë Dibrën shihje dhe shijoje një pamje tepër të këndshme: kudo majë malesh e mbi kodrina ishin ndezur zjarre të mëdhenj. Ndizeshin mullarët që ishin përgatitur posaçërisht për këtë ditë nga burrat dhe të rinjtë. Në ndezjen e tyre merrte pjesë, thuajse, gjithë fshati, me burra e gra e, sidomos, fëmijë. Këndohej e vallëzohej nën dritën e mullarëve me degë pishash e dëllinjash që duke u djegur edhe kërcisnin si për t'i dhënë më shumë hov e gjallëri festës. Në këtë kohë hapeshin dhe dyert e vathave dhe ahureve dhe gratë, pasi kishin bërë mjeljen e parë me një shurgi të vendosur mbi një copë plisi me bar të njomë nën dritën e një pishe të ndezur, i nxirrnin për në kullotë duke i përcjellë deri afër një uji të rrjedhshëm ku ngulnin edhe pishën e ndezur, që flaka e mbarësisë të ecë rrjedhshëm si burimi që kishin pranë.

Shpesh këngët e Shëngjergjit përmbajnë dhe elemente liriko-erotikë. Kryesisht këndoheshinn nga vajzat e reja që, ose ishin të vluara, ose gjallërimi i natyrës u zgjonte ëndrrat e dashurisë. Është e vërtetë se kjo festë niste dhe me një varg fejesash të reja që bëheshin pikërisht në këtë stinë, sepse shumë djem ktheheshin nga kurbeti e shumë prindër nxitonin për t'i mbaruar lidhjet miqësore e bashkëshortore të fëmijëve në këtë kohë të mbarë.

***(Vijon në faqen 8)***

***Pse u dashka që unë si taksapagues, i moralshëm e me dorë në zemër përpara kombit tim, të cilit i atribuoj nderimin e një rruge kombëtare, të më shtohet barra e taksës ? Ndërkaq, që unë paguaj për ndërtimin e një rruge, e cila kërkon dekada, dikush tjetër vepron kundrapedal: Paguhet për shkatërrimin e një lumi, i cili kërkon dekada të natyralizohet në gjendjen e mëparshme !***

# Bulqizë…aty ku e gjelbërta është fe, atdhe e flamur!

*Nga:* **DIONIS XHAFA**

Bulqiza, mbretëresha e bukurisë nëntokësore sh qiptare, është targeti i shkatërrimeve, gërmimeve dhe rrënimeve, për shkak të interesave vetjake të pronarëve së firmave të ndërtimit.

"Rrjepja e nëndheshme" duket se nuk mjafton. Degradimi material e shoqëror i këtij qyteti, i 6-ti në Evropë për nxjerrjen e kromit nis nga mospërgjegjshmëria shoqërore, ku interesi vetjak vihet mbi gjithçka, ku e mira e përgjithshme përulet përpara xhepave të mbushur me para.

Një Bulqizë e vogël por e pasur, një Bulqizë e bekuar nga Zoti dhe e "përdhunuar" nga levat e rënda të ekskavatorëve, që po "hanë" shtretërit e lumenjve nga dita në ditë.

Kështu përngjet çdo ditë në Bulqizë. Nga qielli i saj, Zoti në tokë sheh çudira.

Ndodh m'u aty, në zemër të bukurisë, pështyhet bukuria dhe krenaria që të fal Drini, lumi shtratgjatë dhe fisnik, që përdridhet në hapësirë guralecësh e "bashkon" hapësirën mes dy Dibrave.

Drini i madh, Drini i Zi, Drini që nuk u mposht as nga pushtuesit e huaj, rënkon nga mbishfrytëzimi i inerteve të saj, nga "pushtuesi i lumenjve", nga njerëzit e rritur me ujin e saj.

Për çdo ditë, makina të mëdha me rimorko, ekskavator me çengelët e tyre, firma me mungesë dokumentacioni, pa leje shfrytëzimi, kanë ristartuar aktivitetin e gërryerjes së lumit.

Më saktësisht, firma që ndërton rrugën Urë e Çerenecit - Librazhd, shfrytëzon inertet pranë Rrugës së Arbërit dhe si pasojë edhe rruga e ndërtuar ka filluar të ndjej dëmtimet e para serioze.

Asgjë nuk ka ndryshuar në Bulqizë. "Elita e zaptuesve", një pjesë e vocërr e shoqërisë, ka uzurpuar e paralizuar qytezën e spostuar mes maleve vigane.

"Makineri monstra", që diku në një qoshkë të shtratit të lumit, mes një qetësie absolute, flasin pa folur, vrasin tokë, dhunojnë natyrë, dëmtojnë rrugë e luajnë biz me taksapaguesin e thjeshtë dibran.

Ngjan se vitet kanë ngecur, monarkitë nuk kanë rënë. Mbretërit ekzistojnë. Demokracia ngjan farsë.

Në Shqipëri nuk ka mbretër me kurorë, as me grada, as me vlera.

Por ekziston "mbretëria e të fortëve", e pushtetit dhe e dredhjes së zinxhirit.

Mos duhet të zgjojmë Migjenin, poetin zemërak apo Nolin revolucionar, për të parë sesi ca barkmëdhenj ulur mbi timona gërryejnë lumin, thellojnë ujin për të zhytur akoma më tepër popullin?

Unë dua të besoj se nuk shoh iluzione demokracie, dua të besoj se jemi në demokraci.

Dhe si një vend i tillë, funksionojmë me ligje. Unë i drejtohem qeverisë sime, qeverisë së vendit tim.

Më bëni t'a dua vendin tim, ku qytetari i ndershëm kundrejt shtetit të tij kurrë mos të gjunjëzohet përpara atyre që i ashtëquajta "elitë uzurpuesish", që kanë zënë kallëp e rrinë dhe sipër kushtetutës.

Pse u dashka që unë si taksapagues, i moralshëm e me dorë në zemër përpara kombit tim, të cilit i atribuoj nderimin e një rruge kombëtare, të më shtohet barra e taksës ?

Ndërkaq, që unë paguaj për ndërtimin e një rruge, e cila kërkon dekada, dikush tjetër vepron kundrapedal: Paguhet për shkatërrimin e një lumi, i cili kërkon dekada të natyralizohet në gjendjen e mëparshme !

Lufta etnike për troje e dikurshme ngjan e largët, por në fakt era e saj ndillet tashmë brenda dibranëve vetë, në një trajtë ndryshe. Një gazetar, i quajtur Fitim Dika, e poshtëron nacionalizmin përballë të mirës materiale, kur në shkrimin e tij me titull: "Dibra e Shqipërisë dhe Maqedonisë" thotë se "Në rast të bashkimit kombëtar, ne të Dibrës së Madhe duhet mirë të mendonim se ç'më shumë dhe ç'më pak do kishim me Shqipërinë. Por në rast se do bëheshim si Bulqiza dhe Peshkopia, mirë jemi edhe këtu!"

Ekstremizmi i tillë lind nga pakënaqësia dhe irritimi me mënyrën e organizimit shoqëror dhe administrimin e tij.

Një atdhe pa drejtim, shkapërdalë…E, megjithatë….

…Dashuria e mbirë për atdhe pranohet pa kondita. E tillë, ashtu siç është, të rrënjoset m'u në zemër të zemrës.

Po, e dua ashtu siç është, siç e mrekulloi me duart e tij Zoti. "Raporti dashuror" mes meje dhe atdheut tim i ngjason një tuneli krejt të errët, me një fijëzë dritë në fund të tij.

Një tunel i mbushur me inerte, i boshatisur, i mjerë, i shkretë…

Një tunelz brenda një tuneli të një labirinti të madh me emrin botë…

Unë të dua, por do të të dua dhe më shumë…

Atëherë dhe vetëm atëherë kur dritë e syve të mi të ndriçojë nga vezullimi i një fijëze drite, kur brenda atij labirinti me emrin botë, ku diku tej ka humbur nëpër të "tuneli Shqipëri", do të të gjej edhe ty tunelza ime, Bulqiza ime!

Dhe do të të dua me gjithë forcën e zemrës sime…

Do të të mbroj, do të tregoj me krenari që e shkuara e lavdishme mbi tokën tënde , nuk është thjesht e shkuar.

Nëse dikur luftohej me armë për mbrojtje vatani, sot duhet luftuar një pushtues i ri, pushtuesi i parasë, për të cilin e gjelbërta është fe, atdhe e flamur !!!

## "A po gjegji, po na vjen Shëngjergji"

***(Vijon nga faqja 7)***

Por kishte dhe plot gra të reja që prisnin burrat t'ju vijnë shëndoshë e mirë nga mërgimi dhe e shprehninn gëzimin e tyre me këngë ose disa të tjera mërzinë e ditëve të dimrit të gjatë e mbushnin me nota pikëllimi për rininë e tyre që po rrëshqiste shpejt e pa gëzimin e pritshëm.

***Ngrejhi, cuca, sot***
***T' mushim ujt e kroit!***
***T'i çojm fjalë akranit,*** (T'i çojë fjalë djalit moshatar me të, akranit)
***T'pret dada akshamit…*** (Të prêt e dashura jote mbrëmjeve)

Ose: ***Kta gjashtë muejt e dimnit***
***T'i shkruej n'poll t'qilimit…***

Dita e 6 Majit shënonte edhe kthimin e bagëtisë nga kullota në drake pranë shtëpisë ose stanit, sepse qëndrimi i tyre për një kohë më të gjatë u sillte jo vetëm pakësimin e qumështit, por dhe sëmundje të ndryshme. Ky ritual i drekimit të bagëtisë në mrrizë afër stanit apo në shtëpi dhe mjelja e tyre vazhdonte deri në Shmitër. Në drekën e Shëngjergjit përgatiteshin ushqime kryesisht të burimit blegtoral. Pritej nje qingj apo një kec i njomë, pregatitej leshnik (qumështor), zihej djathë i butë, tundeshin mutinjtë e nxirrej tëlyni, mbusheshin tollumbat me ajkë e gjizë, etj…Shtëpia fshihej e pastrohej mirë, ahuri dhe vatha dëlireshin prej plehërash, mbi dyer e dritare vendoseshin lule, lule të bardha dhe kulpëra e urth vendoseshin magje, në sheka e tek shtrunga e vathës, por edhe në mulli, në pemët afër shtëpisë, etj.

Në tërësinë e riteve të tij Shëngjergji ka qenë dhe mbetet një festë e bukur, një festë e mirëfilltë natyre, një festë pagane dhe gjithëpërfshirëse, një festë që sillte krejt gjelbërimin e verës, që sillte fat e mbarësi. Më kot janë munduar që t'i ndryshojnë fytyrë fetë, regjimet, politika. Sepse u bënë përpjekje për ta identifikuar atë dhe me 1 Majin, ose me 9 Majin. Dështuan. Ajo vetëm emrin e ka të tillë, por emrin Shëngjergj e kanë qindra përrenj e kroje, fshatra e qendra banimi, male e pyje, gurë e shkrepa në mbarë Shqipërinë. Ka dhe lule me këtë emër, ka dhe do të ketë dhe njerëz. Shëngjergji është dhe toponim, dhe patronim, është dhe festë.

*Tiranë, prill 2012*



**Dogana e Bllatës, kufiri mes shqiptarëve në shekullin XXI**
**Foto. R.Torte**

# Dibra e Shqipërisë dhe Maqedonisë

*NGA* **FITIM DIKA**

Rajoni i Dibrës është i ndarë në dysh, ku njëra gjysmë i takon Shqipërisë dhe gjysma tjetër Maqedonisë. Kultura, mentaliteti dhe dialekti janë thuajse të njejta mes dy Dibrave, por edhe martesat mes dy rajoneve janë të shpeshta. Sa i takon politikës, dibranët e Maqedonisë ankohen me të drejtë nga faktori politik për diskriminim në shfrytëzimin e resurseve natyrore në Dibër. Qeveria e Maqedonisë përfiton shuma të majme nga Hidrocentrali i Spiles, i dyti më i madh në Maqedoni dhe i ndërtuar në tokat e dibranëve; qeveria fiton taksa mjaft të mëdha edhe nga fabrika e gipsit, e cila është njëra ndër firmat më të njohura në vend: Kanuf-i; po ashtu mos përmendim edhe përfitimet nga Banjat e Dibrës, Bujqësia dhe eksportimin e druve nga Dibra në rajone të tjera. Për një qytet kaq të vogël si Dibra dhe me gjithë këto pasuri natyrore që ka, me decentralizimin do fitonte më së shumti nga të gjitha komunat e tjera, por decentralizimi për Dibrën mbase s'mund të ndodhë ndonjëherë.

Sa i takon rrethit të Dibrës në Shqipëri, njihen dy qyteza mjaft të njohura atje: Bulqiza dhe Peshkopia. Në Peshkopi poashtu ka mundësi zhvillimi turizmi malor, ku ndodhet maja më e lartë e Korabit, ka banja si në Maqedoni dhe gips të pashfrytëzuar. Edhe banjat edhe gipsi i këtij rajoni është ndër më të mirët në Ballkan, por për të mos mbaruar këtu, në Dibrën e Shqipërisë ndodhet edhe miniera e kromit, e cila për ta kuptuar se sa e rëndësishme dhe ç'përfitime sjell ajo, mjafton të përmendim se 25% e eksporteve të Shqipërisë janë falë minierës së kromit.

Por si është situata në të dy dibrat? Në Dibrën e Madhe ka një papunësi mjaft të madhe dhe shpresa e të rinjve është kurbeti. Pa ndihmën e sivëllezërve tanë në SHBA, sot Dibra do ishte e rrënuar totalisht. Por rajoni i Bulqizës dhe Peshkopisë është edhe më i nëpërkëmbur, ku pavarësisht përfitimeve siç i përmendëm, sot Bulqiza është rajoni më i pazhvilluar në Shqipëri, me asnjë rrugë të ndërtuar dhe pa ndihmat e emigracionit edhe ata do e kishin vështirë mbijetesën.

Përfundimi: Nëse ne të Dibrës së Maqedonisë qahemi nga uzurpimi dhe okupimi që na ka bërë sllavi në trojet tona, vallë nga ç'duhet të qahen banorët e Bulqizës dhe Peshkopisë, të cilët jetojnë edhe me keq se nga Dibra e Madhe? Kjo tregon se vjedhësi dhe politikani i korruptuar nuk ka komb dhe fe, se pavarësisht se ai mbi kë sundon, qëllimi kryesor i shumicës prej tyre është vjedhja dhe korrupsioni. Mbase ne shpesh kërkojmë me të drejtë edhe bashkimin e trojeve shqiptare, por në momentin që pasuritë dhe taksat tona vidhen njësoj si nga pala jonë, si nga pala maqedonase, situata është e njejtë. Në fund të fundit, njeriu është njësoj i dëmtuar pavarësisht se nga kush vidhet: nga qeveria e Sali Berishës apo ajo e Nikolla Gruevskit. Në rast të bashkimit kombëtar, ne do duhet mirë ta mendonim se ç'më shumë dhe ç'më pak do kishim nën Shqipërinë. Por në rast se do bëheshim si Bulqiza dhe Peshkopia, mirë jemi edhe këtu! ***(respublica.al)***

**Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com".**

OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

mjedisi

# Të pastrojmë qytetin… në një ditë




*Nga:* **MALVINA SHEHI*, DENIS LUSHI****

Data 20 prill 2012 ishte përcaktuar nga qeveria shqiptare si dita për një "Shqipëri të Pastër". Në kuadër të kësaj nisme gjatë bisedimeve me aktorët e ndryshëm që operojnë në rrethin Dibër, u vendos që kjo nismë të organizohej nga Federata e Pyjeve dhe Kullotave Komunal (FPKK) të qarkut Dibër. Kjo Federatë sëbashku me organizatën Qendra Rinore Peshkopi (PYC), të ndihmuar nga Bashkia Peshkopi, organizata World Vision Albania, Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër dhe Këshilli Studentor Peshkopi, ndërmorri aksionin "Të pastrojmë qytetin në një ditë". Për këtë aktivitet FPKK kishte përgatitur bluza me mbishkrime ndërgjegjësuese për një ambjent më të pastër dhe me logot e aktorëve pjesëmarrës. Pjesë e këtij aksioni ishin gjithashtu qytetarë, përfaqësues të institucioneve të ndryshme lokale, mësues, student, prindër, nxënës, fëmijë dhe vullnetarë. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin të pajisur me mjetet e nevojshme për këtë aktivitet, si qese plastike dhe doreza, në mënyrë që të ishin të gatshëm për të ndërmarrë aksionin e pastrimit dhe të ndërgjegjësimit qytetar.

Fillimi i aktivitetit për një qytet më të pastër, për një shëndet më të mirë nisi pranë ambjenteve të jashtme të Qendrës së Edukimit dhe Komunikimit – QEK. Hapjen e aktivitetit e bëri Znj. Malvina Shehi koordinatore e FPKK qarku Dibër, e cila falenderoi qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, mësuesit, studentët, nxënësit, organizatat të ndryshme të shoqërisë civile, prindërit dhe vullnetarë të cilët kishin shprehur dëshirën dhe ishin të angazhuar për të qenë pjesë e aktivitetit. Znj. M Shehi gjatë fjalës së hapjes tha se ky është një aktvitet që organizohet në kuadër të ditës të përcaktuar nga qeveria shqipetare si dita për një Shqipëri të pastër. Ajo shpjegoi dhe arsyen se përse këto aksione organizohen në mënyre vullnetare, arsye të cilat ishin:

1. Aksionet vullnetare janë një formë ndërgjegjësimi, por dhe punë konkrete, të cilat kanë pak fjalë dhe më shumë vepra.

2. Aksionet vullnetare janë ato që ndihmojnë në formimin qytetar të gjithësecilit dhe kjo i shërben në mënyre konkrete komuniteteve tona, qytetit në të cilin ne jetojmë.

Në lidhje me procesin e ndërgjegjësimit znj. M. Shehi gjatë fjalimit të saj u shpreh: "…Duke parë realitetin, të gjithëve besoj na ka rënë rasti të shohim mbeturina që hidhen nga ballkoni. Dhe ndoshta shpeshherë mund t'i kemi thënë komshiut të mos hedh më mbeturinat, por momenti që ju viheni t'i pastroni, bën që ai të reflektojë dhe të ndërgjegjësohet madje duke kuptuar më shumë se çdo të kuptonte në një seancë leksioni mbi ndotjen mjedisore. Nëse doni më shumë të veproni sesa të komentoni, atëherë aksionet vullnetare janë rruga më efikase për ju. Janë ato që kërkojnë më shumë guxim, më shumë punë dhe sigurojnë ndryshime konkrete. Peshkopia meriton një mjedis më të pastër, ne meritojmë një shëndet më të mirë dhe për të realizuar këtë duhet të dalim të gjithë së bashku dhe të pastrojmë qytetin, rrugët, shkollat dhe institucionet e tjera, pra të prekim me dorë mjedisin, ta sistemojmë dhe mbrojmë atë. Fokusi i aksionit "Të pastrojmë qytetin në një ditë " ka të bëjë pikërisht me rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë për ambientin, identifikimi i vend-grumbullimeve ilegale të mbetjeve dhe nje aksion i madh i pastrimit vullnetar. Një projekt apo fushatë ndërgjegjësimi që të jetë vërtet efektiv, duhet që të sigurojë pjesëmarrjen e komunitetit dhe kjo arrihet vetëm nëpërmjet punës në terren…". Znj. M. Shehi e mbaroi fjalimin e saj duke falenderuar të pranishmit në emër të FPKK dhe PYC, duke kërkuar bashkëpunimin e tyre në këtë aksion dhe duke i ftuar të jenë pjesë e tij.

Më pas një fjalë përshëndetëse për të pranishmit e mbajti dhe përfaqësuesja e World Vision Albania zyra Peshkopi, Znj. Gentjana Belilaj. Ajo falenderoi të pranishmit për dëshirën për t'ju bashkangjitur aksioneve në mënyrë vullnetare dhe përgëzoi mënyrën se si për një aktivitet të tillë ndërgjegjësues për përmirësimin e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit me iniciativen e FPKK u arrit të bëhej një bashkëpunim mes shumë aktorëve, ndër ta edhe shoqëria civile.

Pas përfundimit të fjalës përshëndetëse nga Znj. G. Belilaj, aktiviteti filloi me një paradë ndërgjegjësimi në bulevardin kryesor të qytetit të Peshkopisë "Elez Isufi", ku të rinjtë dhe fëmijët mbanin në duar pankarta me shprehje mbi mbrojtjen mjedisore. Pas përfundimit të paradës në bulevard filloi aksioni për pastrimin e qytetit ku të rinjtë të pajisur me doreza mblidhnin mbeturinat dhe i hidhnin në qese, për t'i grumbulluar më pas në koshat e plehrave të cilat pastroheshin njëkohësisht nga punonjësit e pastrim – gjelbërimit të Bashkisë Peshkopi.

Aksioni filloi nga bulevardi kryesor dhe u pasua me pastrimin e lulishteve të qytetit si tek lagjia "Gjok Doçi" dhe "Nazmi Rushiti". Gjatë kohës që të rinjtë po bënin pastrimin e qytetit, aksionit i bashkangjitet edhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës z. Myqerem Tafaj dhe disa deputetë të rrethit Dibër, të shoqëruar nga kryetari i Bashkisë Peshkopi, prefekti i Qarkut Dibër, si dhe drejtues të tjerë të institucioneve të ndryshme lokale. Ministri Tafaj falenderoi organizatorët FPKK dhe PYC për aktivitetin dhe sigurisht vullnetarët të cilët i janë bashkangjitur këtij aksioni për të bërë një Peshkopi sa më të pastër, pasi kjo është dita për një Peshkopi të pastër, e cila e tillë duhet të jetë gjithmonë. Pas përfundimit të fjalës së tij, znj M. Shehi falenderoi ministrin e MASH që zgjodhi qytetin e Peshkopisë për të parë nismat e ndërmarra, aksionet vullnetare të realizuara dhe atë çfarë është më e rëndësishme bashkëpunimin mes shumë aktorësh për të realizuar një qëllim, pra një Peshkopi më të pastër, e cila nuk meriton të pastrohet vetëm në një ditë.

**Koordinatore, Federata e Pyjeve dhe Kullotave Komunal-Dibër*
***Menaxher i Marrëdhënieve me Publikun, Qendra Rinore Peshkopi – PYC*

# Rruga… mbetur në mes të rrugës

*(Vijon nga faqja 5)*

Pjesa e parë nga vendi ku kishte filluar segmëenti i parë apo tek pishat e Bulqizës deri në hyrje të tunelit Qafë Bualli ka mbaruar me asfaltime dhe sinjalistikë. Matanë Qafës së Buallit poshtë luginës së Planit të Bardhë kanë mbaruar gërmimet, kanë mbaruar pak vepra arti dhe vetëm kaq. Traseja ka mbetur pa vajtur tek Ura e Vashës. Dikush thotë se ka problem me shpronësimet e dikush tjetër se ende firma ndërtuese nuk ka marrë paratë nga buxheti i shtetit akorduar sipas tenderimit pikërisht për këtë lot.Faktet janë kokë forta e traseja ka mbetur ashtu siç është hapur, pa vepra arti, pa shtresa asfalti. Askush nuk përgjigjet saktë se kur do të përfundojë ky segment i nisur. Në drejtorinë e rrugëve ndodhet projekti i përfunduar i urës së Vashës, urë një ndër më të lartat në Ballkan, ndodhet projekti i segmentit nga dalja e urës e deri në hyrje të tunelit në Xibër Murrize. Është përfunduar dhe projekti i tunelit të Murrize. Ka përfunduar asi projekt dhe segmenti prej 17 kilometra nga Shkalla e Tujanit deri në hyrje të tunelit. E gjithë kjo distancë rruge e projektuar ende nuk është tenderuar as një lot dhe as që bëhet fjalë pasi buxheti i shtetit është bosh. Ka ndodhur shpesh që projekti i kësaj rruge ka ndryshuar.Askush nuk komenton për të. Dibranët janë të kënaqur, mjafton të përfundojë kjo rrugë e pastaj pak rëndësi ka për të nga shkon, ku devijon projekti,çfarë parametrash ka rruga etj. Ne që jemi marrë gjatë me këtë projekt vërtet madhor jo vetëm për Dibrën dhe dibranët por në veçanti si një arterie kryesore e boshtin e lindjes na dhemb shumë kur ndodhin këto fenomene, dhe në fakt kanë ndodhur shpesh. Në Qafën e Buallit kanë filluar disa gërvishtje në të dyja krahet e tunelit por askush nuk është në gjendje të jap një të dhënë të saktë se do hapet tunel apo usek. Projekti i Urës së Vashës ka mbaruar, një projekt i bukur, i veçantë i pa zbatuar ma parë tek ne.Ende nuk dimë si do ndërtohet, në bazë të projektit apo diçka dhe këtu do të ndryshojë.Për tunelin e Murrize është folur shumë, është diskutuar shumë e tashmë kemi informacion se dhe projekti i tij ka përfunduar dhe është dorzuar vetëm pritet tenderimi i tij por pritja do të vazhdojë gjatë .Është diskutuar për tunelin e Murrize për një distancë prej 3 km e 600 metra linear .U diskua ma vonë për një distancë 3.2 km e tani së fundi dhe 2.7 km.Asgjë nuk dihet cili projekt do marrë udhë të zbatohet pasi shpesh në këtë rrugë projektet janë ndërtuar ditën me diell e i kanë ndryshuar natën pa hënë.Ruajna zot nga ndonjë shpikje që të eliminojnë krejt tunelin e ti ngjiten me trase të përpjetës së Qafës Murrize.Dhe kjo mund të ndodh se fundja shpesh është lakuar që rruga e Arbërit është dhe rrugë turistike.Paradokse pa fund mund të ndodhin.

Segmenti që ka filluar nga Ura e Brarit e deri në Shkallën e Tujanit nga kompania "Gener-2" distancë kjo prej 5.8 kilometra është në përfundim e sipër. Tuneli prej 72 metra gjatësi si dhe 3 ura të mëdha kanë përfunduar. Ka mbetur tashmë vetëm shtresa e asfaltit dhe ky segment rruge po thuaj se është i përfunduar. Makinat që shkojnë apo zbresin nga Zallbastari apo Zall Dajti nëpër trasenë e re të kësaj rruge kalojnë lirshëm tashmë.Problem mbeten ato segmente që folëm më lart ku megjithse janë përfunduar projektet asnjë nga këto nuk është tenderuar dhe as ka gjasa të tenderohen së shpejti. Megjithë krizën e madhe që ka mbërthyer ekonominë tonë si kudo edhe në infrastrukturë punohet.Punohet me ritme të shpejta në tunelin e Krabës, në unazën e Tiranës, në boshtin e jugut etj. Krejt ndryshe ndodh me rrugën e Arbërit.Këtu njëherë për njëherë është qetësi e madhe.Mjaft kompani shqiptare që blenë makineri të rëndë që punuan në segmentin e parë të kësaj rruge kanë filluar tashmë të shesin makineritë e të paguajnë kreditë bankare pasi asnjë dritë jeshile nuk po shikojnë.Ka nga to që ende nuk kanë marrë paratë për punën e kryer.Asnjë informacion apo e dhënë se kur do të nisin punimet në seri për këtë projekt nuk ka. Në drejorinë e përgjithshme të rrugëve dyert qëndrojnë të kyçura e informacionet nuk para rrjedhin për mediat. Në fakt nuk kanë se çfarë të thonë.Projektet janë gadi të gjitha, tenderime nuk ka për rrugën e Arbërit dhe as që pretendohet se do ketë.Sipas një burimi nga gazeta Zgjedhjet po afrohen dita ditës, ndoshta dhe zgjedhje të parakohshme do kemi në vjeshtë. Nuk di si do shprehet politika në Dibër, Mat e Bulqizë kur të vijë tek qytetarët . Çfarë do tju premtojë? Përsëri me rrugën e Arbërit do të merren?.Sot për sot rruga e Arbërit ka mbetur në mes të rrugës.

Aksi rrugor që shkurton distancën mes Tiranës dhe Dibrës ose siç quhet ndryshe Rruga e Arbrit parashikohet të përfundojë i gjithi në 2013. Ky afat është vendosur në Strategjinë e Transportit nga Ministria e Punëve Publike, dokument ky i miratuar në fillim të shtatorit 2008 nga Këshilli i Ministrave. Sipas kësaj strategjie, e gjithë rruga do të ndërtohet në kohë të ndryshme, duke nisur që nga ky vit, për të vijuar më tej në 2009 me përfundimin e aksit Bulqizë-Bllatë-Ura e Çerenecit, me kosto të parashikuara nga buxheti i shteti në rreth 1.2 miliardë lekë. Punimet në këtë rrugë do të prekin dhe segmentin Ura e Çerenecit-Peshkopi, me vlerë rreth 2.7 miliardë lekë, ndërsa afati i punimeve është parashikuar nga ministria viti 2011. Për ta mbyllur ciklin e punimeve, është parashikuar dhe ndërtimi i segmentit Bulqizë-Tiranë, me vlerë nga buxheti i shteti në rreth 13 miliardë lekë. Si përfundim, Rruga e Arbrit do të jetë gati në vitin 2013, kurse në total kostoja e saj shkon në rreth 17 miliardë lekë.

***Sh.Skarra***

Rruga e Arbërit nr. 72
studim




# Biemi dhe miti i Skënderbeut

**Përshkrimet mitologjike që e mbivlerësuan Skënderbeun, e patën dëmtuar jo vetëm figurën e heroit, por ato errësuan qëllimisht dhe në dëm të bashkëluftëtarëve dhe bashkëkohësit e tij, si Gjergj Aranitin, Moisi Golemin, Tanush Topinë, Muzakën e Angjelinës, Lekë Dukagjinin, Kont Uranin etj., të cilët ishin gjeneralë të shquar dhe po aq të zotë sa edhe vetë Skënderbeu.**

**Nga Avni ALCANI**

Miti për figurën e Gjergj Kastriot-Skënderbeut ishte krijuar qysh në gjallje të Heroit Kombëtar. Ky mit është krijuar ndër vite nga të gjithë shqiptarët për vetë shqiptarët. Por miti për Skënderbeun është ushqyer edhe nga një lloj literature aventureske, siç është, p.sh., libri *"Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-begh"*,[1] i një autori italian të shekullit të 18-të, priftit nga Breshia Xhamaria Biemi, libri i të cilit është cilësuar si *"vepër mashtruese e hileqare"* dhe autori si një fallsifikator profesionist.

Një pjesë e historianë shqiptarë, që janë marrë me studimin e figurës së Skënderbeut, në lidhje me Xh. Biemin dhe veprën e tij të sipërpërmendur, kanë pasur dhe kanë mendime e opinione të ndryshme nga njëri-tjetri. Dy prej historianëve më të njohur shqiptarë, që kanë shkruar libra për historinë e Skënderbeut, siç janë Fan S. Noli dhe Kristo Frashëri, e pranojnë si Biemin dhe veprën e tij, kurse disa historianë të tjerë, si Aleks Buda, Dhimitër S. Shuteriqi, Kasem Biçoku etj., nuk e pranojnë librin e Biemit.

Noli, në librin *"Gj. K. Skënderbeu. 1405-1968"* (Tiranë 1967), shkruan se burimet që janë nxjerrë nga libri i Biemit janë shumë të besueshme. Kjo, sipas tij, pasi Biemi paska shfrytëzuar librin e një biografi të vjetër shqiptar, që është quajtur Anonimi i Tivarit, i cili paska shkruar biografinë e heroit para Barletit. Biemi, shkruan Noli, ka qenë *"i pari dhe i vetmi historian që e përdori librin e Tivarasit, i cili duket se ka humbur përfundimisht"*.[2] Të njëjtin qëndrim me Nolin mban edhe historiani i mirënjohur Kristo Frashëri, në librin *"Skënderbeu. Jeta dhe vepra"* (Tiranë 2002).[3]

Kundërshtarët e Biemit hedhin dyshime në të dhënat autentike që jep ky autor në veprën e tij për Skënderbeun. Dh. S. Shuteriqi, i cili, në shkrimet kushtuar aranitëve, shpesh herë e ka përmendur Biemin si biograf të Skënderbeut, shkruan për abatin breshian se *"një historian italian, Biemi, ka shkruar një histori për Skënderbeun, por ka fantazuar shumë* (nënvizimi im, A. A.).[4] Kurse historiani i shquar shqiptar, Aleks Buda, në parathënien e librit të F.S. Nolit, *"Gj. K. Skënderbeu 1405-1968"*, shkruan se *"Një e metë që mbështetet akoma në punimin e ri të Nolit është fakti se ai vazhdon të përdorë si burim të dorës së parë disa burime tregimtare shumë të dyshimta. E kemi fjalën për historinë e të ashtuquajturit "Tivaras", për të cilin historianë me autoritet kanë shprehur mendimin e argumentuar se kemi të bëjmë me një fallsifikim të një fallsifikatori profesionist të shek. XVIII, Xhamaria Biemi"*.[5] Buda e vijon më tej kritikën ndaj Nolit, kur thotë se *"për shkak të këtij burimi kaq të dyshimtë, Noli lë qëllimisht pas dore një burim si biografinë e hartuar nga shqiptari Marin Barleti, të cilin kërkimet e reja po e vërtetojnë gjithnjë e më tepër si një burim në kuptim të plotë autentik e të dorës së parë.*[6]

Përse një historian me përmasa si Fan Noli "gabon" në përdorimin e burimeve historike për Skënderbeun nga një autor i dyshimtë, si është Xh. Biemi?! Kjo ka ndodhur, së pari, pasi Biemi e ka glorifikuar dhe mitizuar figurën e Skënderbeut dhe Fan Noli, që ishte i mbrujtur me idealet e rilindasve shqiptarë, të cilët e kërkonin një hero mitik që do t'i "udhëhiqte" shqiptarët drejt idealit madhor, çlirimin e Shqipërisë nga pushtimi i gjatë turk; Së dyti, Biemi ka trilluar ngjarje, si ajo e dylftimit kalorsiak të dy Lekëve (Lekë Zaharia dhe Lekë Dukagjini) në dasmën e Mamicës, të cilën kishin rënë në dashuri me shikim të parë me Irenë Dushmanin e Zadrimës. Ngjarje të tilla ka shumë në librin e Biemit, ç'ka ka joshur fantazinë e shkrimtarëve.

* * *

Mashtrimin e Xh. Biemit dhe të veprës së tij *"Istoria di Giorgio Castrioto detto Scanderbegh"* e ka denoncuar që në vitet '30 të shekullit të kaluar historiani gjerman, Franz Babinger (1891-1967), profesor i njohur i historisë në Universitetin e Mynihut (Gjermani). Mashtrimin e tij Babingeri e botoi në librin *"Das Ende der Arianiten"* (Mynih 1960), botim i Akademisë së Shkencave të Bavarisë dhe i Shtëpisë Botuese të Akademisë së Shkencave të Bavarisë. Në vitin 2004 libri i Babingerit, me titullin *"Fundi i arianitëve"*, u përkthye edhe në gjuhën shqipe nga Shtëpia Botuese "Plejad", në kolanën: *"Plejada e Mendimit Botëror, Histori"*.

Që në faqet e para të librit, në parathënien e tij, lexuesi ndeshet me një qëndrim kritik të Babingerit ndaj historianëve shqiptarë dhe i bën fajtorë për vlerësimin jo të denjë që ata i kanë bërë bashkëluftëtarëve të Skënderbeut, për errësimin e nënvlerësimin e qëllimshëm të figurave të tyre në dobi të këtij të fundit (Gj. K. Skënderbeut). Si shembull ai jep figurën e Gjergj Aranitit, pasi, sipas tij, roli i *"Gjergj Arianitit është errësuar në mënyrë të dyshimtë në të mirë të dhëndërit të tij, të mbiquajtur së fundi "capitano generale dei Signori d'Albania" (Gj. Muzaka) Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbej"*.[7] Babinger shpreh një konsideratë të veçantë për Gj. Aranitin, duke e cilësuar atë një figurë historike të përmasave europiane, si një gjeneral i shquar dhe mbrojtës i vendit të tij. Gjergj Araniti, shkruan Babingeri: *"del në dritë jo vetëm të historisë së Shqipërisë, por dhe të historisë së Perëndimit, si dhe lavdinë e të cilit, si gjeneral dhe mbrojtës të vendit të arnautëve nga turqit që i binin në qafë e që vetëm mbas vdekjes së tij qe lënë në hije dhe, së fund qe errësuar krejtësisht nga ajo e dhëndërit të tij, Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbe"*.[8] Duke krahasuar sukseset e Aranitit me ato të dhëndërit të tij, Babinger është shprehur se: *"sukseset ushtarake të Gjergj Arianitit, para së gjithash ushtria e tij në luftën e vogël, vështirë se mund të mbeten pas atyre të burrit të vajzës së tij"* [9] Por, *"pas vitit 1455"*, shkruan Babinger, çuditërisht *"zhduket emri i tij nga vjetarët e Historisë së Shqipërisë, që këtej e tutje lavdëronin vetëm emrin e burrit të vajzës së tij, Gjergj* Kastriotit*"* .[10]

Le t'i rikthehemi çështjes sonë, atë të kritikës që i ka bërë F. Babinger priftit italian Xhamaria Biemi dhe librit të tij të sipërpërmendur. Babinger është tepër i ashpër në qëndrimin e tij ndaj Biemit dhe e etiketon priftin breshian si *"mashtruesi i pacipë"* dhe librin e tij si *"vepra mashtruese e hileqare e abatit breshian"*.[11] Ai i këshillon historianët shqiptarë që *"studimet historike shqiptare* (duhet) *të çlirohen nga vepra mashtruese e hileqare letrare e* Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-begh e *Gianmaria Biemit"*.[12] Mendimi i Babinger-it është se nuk ka ekzistuar dhe nuk ka qenë botuar asnjë libër i shkruar nga një Anonim i Tivarit. Ky libër është tërësisht një sajesë e Xh. Biemit. Qysh në vitin 1933 Babinger e kishte nxitur mikun e tij, Kurt Ohly, një specialist i inkunabulave,[*] që të kërkonte librin e të ashtuquajturit "Anonimi Tivaras", i cili pretendohej se ishte botuar që në vitin 1480 dhe mbi të cilin abati breshian kishte sajuar historinë e tij për Skënderbeun. Babinger shkruan në librin e tij për aranitët se *"Kurt Ohly, me nxitjen time, e demaskoi mashtrimin e paciptë të abatit breshian te Vjetari i Gutenbergut 1933, te faqe 53-61, nuk do të përdorej në mënyrë të vazhdueshme si një burim i besueshëm dhe kështu do t'i bëhëj shkencës një shërbim me të vërtetë i mirë"*.[13] Këtë e pohon edhe vetë Noli në librin e tij të historisë së Skënderbeut, ku shkruan se Kurt Ohly *"nuk ka mundur të gjejë asnjë provë që një libër si i Tivarasit të ketë qenë botuar ndonjëherë në Venedik, prej Radolit të Augusburgut"*.[14] Por Fan S. Noli, si një përkrahës i veprës së Biemit, pati debatuar me Babingerin, duke e akuzuar studiuesin gjerman se ai kishte nxjerrë *"përfundime të nxituara"* për Biemin dhe se Babingeri *"ka shumë të ngjarë ta ketë lexuar tek-tuk librin e Biemit"*.[15] Këtyre akuzave të Nolit profesori i historisë u është përgjigjur, se *"po qe se peshkopi shqiptar Fan Stilian Noli (Boston) në librin e tij* George Castrioti Skanderbeg -1405-1468 (Neë-York, 1947), *në faqen 41 ankohet për këtë... e gjitha kjo e nderon pak dashurinë për të afërmin, të këtij titullari të kishës dhe aq më pak i shërben ai, në këtë mënyrë, studimit të ndërgjegjshëm historik"*.[16]

Një tjetër historian gjermanishtfolës, Oliver Jens Schmitt, profesor i historisë në Universitetin e Vjenës, ka shprehur konsiderata të njejta me Babingerin, në lidhje me qendrimin ndaj librit të Biemit. Oliver Shmit, në librin e tij *"Skënderbeu"* (Përkthim shqip, Tiranë 2008), shkruan: *"Shumë e kundërshtueshme... është vlera dokumentare e të ashtuquajturit Anonim i Tivarit. Në vitin 1742 prifti italian Gian Maria Biemmi, që jetonte në Brescia, paraqiti një biografi të Skënderbeut të cilën gjoja e kishte marrë nga një inkunabël i Erhard Radoltit prej vitit 1480, një vepër nga e cila Biemmit i paskej humbur fillimi dhe fundi. Shtypja qenkësh bërë sipas tij nga një bashkëkohës prej Tivari dhe ishte biografia më e hershme. Do të duheshin 200 vjet dhe Kurt Ohly dhe Franz Babinger ta demaskonin këtë libër si një fallsifikim tejet mjeshtëror, si krijesën e një njeriu që pati shpikur në shek. 18 edhe vepra të tjera"*.[17]

Një pjesë e historianët shqiptarë të pas Luftës së Dytë Botërore pranuan Biemin. Libri i Biemit u pati shërbyer atyre si një burim i dorës së parë edhe pse ishin të vetëdijshëm se kishin të bënin me një fallsifikim. Përse kishte ndodhur kjo gjë?! Përgjigjen na e jep historian zhviceran O. J. Schmitt, i cili shkruan: *"Në shekujt 19 dhe në fillim të shekullit 20 Biemi u pat shërbyer një numri historianësh si burim i besueshëm, e një pjesë jo e vogël e botimeve shtetërore shqiptare për Skënderbeun bazohen mbi këtë fallsifikim. Breza të tërë historianësh shqiptarë nga A. Gegaj, te F. Noli e deri te përfaqësues të kohëve të vona e kanë marrë në mbrojtje dhe e kanë përdorur Biemin vazhdimisht. Qëndrimi i Kristo Frashërit, i cili edhe pse është i vetëdijshëm për këtë fallsifikim, prapëseprapë e përdor atë meqë disa elemente thelbësore të tij janë bërë një traditë e dashur, pasqyron karakterin e një pjese të mirë të shkencës shqiptare"*.[18]

* * *

Kanë qenë të gjithë krijuesit shqiptarë, si historianët, shkrimtarët, artistët etj., të cilët e mitizuan figurën e Skënderbeut. Mitizimi i figurës së tij mori përmasa të jashtëzakonshme në shek. e 19-të, gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare. Rilindasit shqiptarë kërkonin të zgjonin te shqiptarët ndjenjat kombëtarëve, për t'i mobilizuar të ngriheshin në luftë për çlirimin e vendit të tyre nga pushtimi i gjatë 5-shekullor otoman. Ata kërkonin një figurë heroi që t'ua paraqisnin shqiptarëve, që ta kishin si shembull për kryengritjen e tyre kundërosmane. Figura më e përshtatshme ishte Skënderbeut, një figurë historike shqiptare e shek. të 15-të, që u kishte bërë qëndresë të jashtëzakonshme osmanëve dhe për 25 vjet rjesht kishte përballuar ushtrinë më të madhe dhe më të fortë në botë. Krijuesit e parë që u morën me figurën e Skënderbeut dhe për "Motin e Madh" ishin shkrimtarët romantikë arbëreshë të Italisë, si De Rada, Gavril Dara, Zef Serempe, B. Bilota etj. Poeti kombëtar i shqiptarëve, Naim Frashëri, shkroi "Istori e Skënderbeut", që e pati marrë frymëzimin nga vepra e M. Barletit. Poema pati një jehonë të madhe në Shqipëri. Jehona e veprës historike e Skënderbeut vijoi edhe pas Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare. Ajo gjeti pasqyrim gati te të gjithë krijuesit shqiptarë të shek të 20-të dhe për figurën e tij u shkruan romane, opera, simfoni, piktura, skulptura etj. Mbivlerësimi i figurës së tij u bë gati nga të gjithë historianët shqiptarë të shek. të 20-të. Skënderbeu u përshkrua si *"një udhëheqës i shquar i kryengritjes çlirimtare të shek XV kundër zgjedhës osmane, si një strateg gjenial që korri vazhdimisht fitore ushtarake kundër sulltanëve turq, si një farkëtar dorëfortë që krijoi shtetin e përqendruar kombëtar shqiptar, si një burrë shteti, i cili me luftën e tij një çerek shekullore konsolidoi identitetin kombëtar të shqiptarëve, si një personalitet i historisë mesjetare i cili në të njëjtën kohë mbrojti edhe qytetërimin e Europës humaniste"*.[19] Ky mitizim, shkruan O. J. Schmitt-i, i shërbeu edhe politikës së regjimit komunist të E. Hoxhës, duke e amplifikuar heroin kombëtar *"si zëvendësues për zbrastësinë shpirtërore të popullsisë. Skënderbeu u kthye në simbol për izolimin gjithnjë e më të madh të regjimit: u krijua imazhi i një populli heroik e të vetmuar, të rrethuar prej armiqsh, nën udhëheqjen e një prijësi të mençur e energjik... Sa më shumë që ideologjizohej Skënderbeu e riformësohej imazhi i tij në mënyrë manipuluese, aq më i dobët bëhej trajtimi shkencor i figurës reale..."*.[20]

debat



* * *

Para disa viteve shpërtheu një polemikë e ashpër kundër botimit të biografisë më të re të Skënderbeut e shkruar nga historiani zviceran O. J. Schmitt, pasi autori pati "guxuar" të "zbresë" Skënderbeun nga froni i mitologjisë (ku e kishin vendosur historianët shqiptarë heroin e tyre). Schmitt-i, në bazë të fakteve dhe të burimeve historike, në librin e tij për Skënderbeun, dëshmonte se ai ishte një kryengritës i zakonshëm, i cili ishte ngritur krye kundër sulltanit për shkak të hakmarrjes personale, pasi ky i fundit i kishte vrarë të atin: *"Ivan Kastrioti pra, më 2 maj 1437 nuk pati vdekur nga një vdekje e natyrshme, por ishte vrarë me urdhër të Muratit II... (Skënderbeu) së shpejti do të mendonte për hakmarrje. Po të kemi parasyshë se e drejta zakonore e arbërve gjëllonte qysh në mesjetë, ai skishte tjetër rrugë përveç se të ruante nderin e tij. I duhej të merrte gjak nga ajo familje që kishte derdhur gjak: kjo ishte dera e Osmanëve... Kështu zgjidhet edhe rebusi... kryengritja e Skënderbeut"*.[21] Por, a mund të konceptojë gjykime të tilla lexuesi shqiptar, që është i mbrujtur qysh në bankat e shkollës me heroizmat legjendare të heroit të tyre kombëtar?!

Përshkrimet mitologjike që e mbivlerësuan Skënderbeun, e patën dëmtuar jo vetëm figurën e heroit, por ato errësuan qëllimisht dhe në dëm të bashkëluftëtarëve dhe bashkëkohësit e tij, si Gjergj Aranitin, Moisi Golemin, Tanush Topinë, Muzakën e Angjelinës, Lekë Dukagjinin, Kont Uranin etj., të cilët ishin gjeneralë të shquar dhe po aq të zotë sa edhe vetë Skënderbeu.

Kohët e fundit është folur për rishkrimin e historisë. Për fat të keq kjo thirrje ka ardhur nga politika. Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve do të rishkruhet drejt kur ajo të mos jetë më e ndikuar nga konjukturat politike dhe të pastrohet nga burimet e atyre veprave të autorëve që janë cilësuar si *"fallsifikatorë dhe mashtrues hileqarë"*.

1) G. Biemmi: *Istoria di Giorgio Castriotto detto Scanderbe-begh di Giammaria Biemmi prete Breshano*. Breshia 1742;
2) F. S. Noli: *Gj. K. Skënderbeu. 1405-1968*, Tiranë 1967, faqe 158;
3) K. Frashëri: *"Skënderbeu. Jeta dhe vepra"*, Tiranë 2002;
4) Dh. S. Shuteriqi: *Aranitët-Emri dhe gjenealogjia*, St. Historike, Tiranë 1965, faqe 12; *Aranitët në Librazhd*, gazeta "Çermenika", Nr. 14, 2004;
5) A. Buda: *Fan S. Noli, historian i Skënderbeut*, Parathënie e librit: *"Gj.K..Skënderbeu. 1405-1968"*, Tiranë 1967, faqe 8;
6) A.Buda: Po aty, faqe 8;
7) F. Babinger: *Fundi i arianitëve*, Tiranë 2004, faqe 9;
8) F. Babinger: Vepër e cituar, faqe 21-22;
9) Po aty, faqe 22,
10) Po aty, faqe 25;
11) Po aty, faqe 9;
12) Po aty, faqe 9;
13) Po aty, faqe 10;
14) F. Noli, *"Gj.K..Skënderbeu. 1405-1968"*, Tiranë 1967, faqe 160;
15) F. Noli: Vepër e cituar, faqe 160;
16) F. Babinger: Vepër e cituar, faqe 10;
17) O. J. Schmitt: *Skënderbeu*, Tiranë 2008, faqe 481;
18) Po aty, faqe 481;
19) K. Frashëri: "Skënderbeu i shpërfytyruar", Dudaj, 2009;
20) O. J. Shmitt: Vepër e cituar, faqe 443-444;
21. Po aty, faqe 57;
*) Specialisti i inkunabulave është specialisti që merret me studimin e librave të shtypur para vitit 1500. (Shënim i autorit);

# Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torviollit



© Foto: Bujar Karoshi

*Nga:* **ALI HOXHA**

Çështja e lokalizimit të vendit ku u zhvillua beteja e parë e Skënderbeut me forcat osmane, më 29 qershor 1944, që në historiografi njihet me emrin beteja Torviollit, ende nuk ka gjetur një përgjigje të kënaqshme. Historiani i Skënderbeut, Marin Barleti, jep vetëm një informatë të përgjithshme se ajo betejë është zhvilluar në Dibrën e Poshtme 1). Në një histori të Skënderbeut, të cilën e ka botuar prifti nga Breshia e Italisë Xhamario Biemi, në vitin 1742, dhe që pretendon se e ka shkruar sipas dorëshkrimit të një historia të Skënderbeut që e ka shkruar një anonim nga Tivari, më 1480, por që ky dorëshkrim ka humbur 2) thuhet: "Skënderbeu u drejtua për në Dibër të Poshtme dhe këtu e vendosi ushtrinë në fushën e Torviollit, që është e gjerë gati 3 milje dhe e gjatë 7 milje, e rrethuar prej malesh, brigjesh dhe pyjesh nga të gjitha anët (por sot nuk ekziston një toponim i tillë) dhe përmes saj kalonte lumi Skampino (Shkumbini)"3).

Siç shihet, nga të dhënat e mësipërme që mund të konsiderohen si të vetmet burime historike lidhur me këtë betejë, nuk mund të ketë një lokalizim që të mos shkaktojë diskutime dhe, për më tepër, kur të dhënat e Biemit janë vënë në dyshim nga shumë studiues të periudhës së Skënderbeut. Megjithatë nuk kanë munguar përpjekjet për të bërë lokalizimin e fushës së betejës në bazë të të dhënave të dy burimeve të mësipërme. Përpjekjen e parë, për ta identifikuar në territorin e Dibrës së Poshtme fushën e Torviollit e ka bërë K. Frashëri.

Ai pohon se beteja e Torviollit u zhvillua në Dibrën e Poshtme, diku në fushën e Peshkopisë 5).

Pohimi i Kristo Frashërit duket më afër së vërtetës. Ndonëse ai nuk e saktëson se në cilën fushë të Dibrës së Poshtme, ose të fushës së Peshkopisë, siç shprehet ai, është zhvilluar kjo betejë, megjithatë na lejon të kuptojmë se kjo betejë u zhvillua në një fushë, diku, në veri të qytetit të Peshkopisë. Në trevën e Dibrës së Poshtme, duke filluar nga rrjedha e sipërme e Drinit të Zi, gjenden këto vende, të cilat njihen me emrin fushë: ku mund të zhvillohet një betejë mesjetare me përmasa të tilla si ajo e 29 qershorit 1444.

1) "Fusha e Brezhdanit:", ose s'çnjihet nga populli edhe me emrin tjetër "Çapi i Brezhdanit".

2) "Fusha e Kastriotit", ose siç njihet nga populli edhe me emrin tjetër "Fusha e Thatë".

3) "Fusha e Çidhnës", një pjesë e së cilës, më saktë, një fshat i zonës së Çidhnës, deri në vitin e 1974 ka qenë njohur me emrin (Fushë-Alie), bile nga banorët vendas (çidhnakët) quhej vetëm me emrin thjesht "Fushë". Sqarojmë se edhe "Fusha e Kastriotit" në kuptimin më të gjerë të fjalës, njihet si pjesë përbërëse e Fushës së Çidhnës, gjë të cilën na e vërteton edhe njohja e këtij vendi edhe me emrin tjetër "Fusha e Thatë" pa përcaktorin e "Kastriotit".

4) "Fusha e Shumbatit", ose siç quhet nga banorët fqinjë me të edhe me emrin "Rafshet e Shumbatit", "Rrafshja e Shumbatit".

Dëshmitë e Barletit dhe të Biemit (nënkupto Tivarasin) janë të mjaftueshme për të krijuar bindje të plotë se Torviolli, është në Dibër të Poshtme (të sotme). Duke u mbështetur në "Defterin emëror të vilajetit të Dibrës të vitit 1467" dhe në disa të dhëna topografike, gjeografike dhe të dhëna historike të tërthorta mendojmë se fusha në të cilën u zhvillua beteja në tërësi, është fusha në bregun lindor të Drinit të Zi, tek Ura e Lushës, territor i cili sot quhet Fushë-Çidhën, ose Fusha e Çidhnës.

Në të mirë të këtij mendimi flasin këto argumente:

Defteri i vilajetit të Dibrës i vitit 1467 na jep këtë ndarje të fshatrave në Dibrën e Poshtme dhe në Dibrën e Sipërme, si edhe mundësinë e përcaktimit të kufijve të këtij vilajeti dhe të të dy Dibrave midis tyre 6):

1) (Rohonik (sot qyteti i Dibrës së Madhe – A.H) me 54 shtëpi; 2) Banishtë (Banishti i sotëm – A. H.) me 10 shtëpi; 3) Lizhani (Leiçani – A. H.) me 5 shtëpi; 4) Shipanci (Shupenza e sotem – A.H.) me 18 shtëpi; 6) Selishtë me 2 shtëpi; 7) Çineci (Çereneci – A.H.) me 5 shtëpi; 8) Potestasti (Pocesti – A.H.) me 9 shtëpi; 9) Tërnuvsil (Tërnova e sotme – A.H.) me 3 shtëpi; 10) Klloboçishtë (Kllobçisht – A.H) me 11 shtëpi; 11) Mohtijara (Majtara – A.H.) me 4 shtëpi; 12) Pakli me 10 shtëpi; 13) Trapça (Trepça – A.H.) me 3 shtëpi; 14) Maqellarë me 7 shtëpi; 15) Vlasik (Vllasika ose Vlashej) me 1 shtëpi; 16) Prepatenku i Sipërm (i braktisur); 17) Hodovë, pa asnjë shtëpi (i braktisur); 18) Pllashçi (Peladhi – A.H.) me 10 shtëpi; 19) Kovaçiçe (Kovahicë – A.H.) me 5 shtëpi; 20) Dolna Kërçishte (Kërçisht i Poshtëm – A.H.) me 13 shtëpi; 21) Hobok me 3 shtëpi; 22) Konari me 6 shtëpi; 23) Tërbaçi me 1 shtëpi; 24)Harbil (Herbel – A.H.) me 5 shtëpi; 25) Rinbari (Erebara – A.H.) me 11 shtëpi; 26) Suhoriçani (Sofraçan – A. H.) me 16 shtëpi; 27) Kevaçiça (Kovashica – A.H.) me 24 shtëpi; 28) Topoljani (Topojani – A.H) me 11 shtëpi; 29) Okshetena (Okthatina – A.H.) me 15 shtëpi, ky ka edh manastirin e Thotokut; 30) Rashani me 3 shtëpi; 31) Belato (Bllata) me 2 shtëpi; 32) Çinani (Çerneni – A.H.) me 6 shtëpi; 33) Sushani me 15 shtëpi; 34) Bullaç (Bulaç – A.H.) me 9 shtëpi; 35) Kars me 13 shtëpi; 36) Buçivo (Bačeva – A.H.) me 4 shtëpi; 37) Homizhi (Homeshi – A.H.) me 6 shtëpi; Krajkavishta (Krajka – A.H.) me 6 shtëpi (varet nga Golloborda); 38) Grazhdani me 14 shtëpi; 39) Gradec dhe Çijok (Qenok – A.H.) së bashku me 6 shtëpi; 41) Sollokiq (Sollokiçi i sotëm – A.H) me 2 shtëpi; 42) Guranxhi me 2 shtëpi (varet nga kalaja e Koxhaxhikut); 43) Novak i braktisur; 44) Dulgash (Dulgash i sotëm në Jugosllavi – A.H.) 2 shtëpi (varet nga kalaja); 45) Vllahlar (Vllalmja) 1 shtëpi; 46) Koçisht (i braktisur); 47) Sllavijani, (i braktisur); 48) Selicë (Selishtë) (i braktisur); 49) Ostolnica (i braktisur); 50) Zhitinjani (i braktisur); 51) Paris (i braktisur); 52) Strazhvishta (i braktisur); 53) Brashatni (i braktisur); 54) Provalanik (i braktisur); 55) Balani (i braktisur); 56) Ajo Gjoni (Shën Gjoni) (i braktisur); 57) Dina Çavishta 6 vetë; 58) Pisjakë (Pesjakë – A.H.) me 4 vetë; 59) Truallishta Ajo Loçi (Shën Loçi) (e braktisur); 60) Kështjella e Koxhaxhikut me 51 vetë; 61) Dovoljan (Dovolan – A.H.) me 5 shtëpi; 62) Ihishova me 5 shtëpi; 63) Prepatniku i Poshtëm (i braktisur); 64) Çernobok (i braktisur). (leximet me inicialet A.H. janë të autorit)

Gjithsej në atë periudhë në vilajetin e Dibrës së Epërme bënin pjesë 62 fshatra, një kështjellë dhe një manastir. Nga 62 fshatrat, 26 prej tyre qenë të braktisura. Pra të populluara ishin vetëm 46 fshatra me 397 shtëpi gjithsej, si dhe 51 veta (nënkupto familje – A. H.) që shërbenin në kështjellën e Sfetigrafit. Në atë periudhë fshati Bulqizë dhe Krajkovishtë, (Krajka e sotme – A. H) megjithëse përmenden nëpër timaret e lartpërmendura të vilajetit të Dibrës së Epërme, nuk vareshin nga Dibra, por nga vilajeti i Gollobordës, prandaj nuk janë llogaritur në shifrat e mësipërme, ndërsa fshati Dovoljan, Iljashova. Prepatniku i Poshtëm dhe Cernobok janë llogaritur në këto shifra, pasi dy të fundit varen nga Kalaja e Koxhaxhikut në Dibër, ndonëse përmenden në vilajetin e Gollobordës.

Në Dibër të Poshtme përveç17 timareve, duke llogaritur edhe ato fshatra që bënin pjesë në timaret dhe haset e subashit, një pjesë të të cilave i kishte edhe në Dibër të Epërme, bënin pjesë këto fshatra 7):

1) Fshat Peskopja (sot qyteti i Peshkopisë – A.H.) me 52 shtëpi: Manastiri në fshatin e sipërm; 2) Tirana (jo Trena V.B.) (Trena – A.H.) me 12 shtëpi: 3) Starovis (Staraveci – A.H.) me 21 shtëpi; 4) Biloja (Bellova – A.H.) me 6 shtëpi; 5) Cirjani (Cerjani –A.H.) me 20 shtëpi; 6) Brezdan (Brezhdan – A.H.) me 11 shtëpi; 7) Kobilani (Kobeni – A.H.) me 5 shtëpi; 8) Kalcishtë me 2 shtëpi; 9) Kurne Brasti (Brest i Epërm – A. H.) me 2 shtëpi; 10)Vinecë (Vajcë – sot lagje e fshatit Sohodoll – A.H.) me 1 shtëpi; 11) Shëmbat me 26 shtëpi; 12) Terpishë me 3 shtëpi; 14) Belicë (Bëlliçe – A.H.) me 15 shtëpi; 15) Zograd (Zagrad – A.H.) me 4 shtëpi; 16) Bulkije (sot Bulç njëherësh edhe Blliçe e Poshtme – A.H.) me 6 shtëpi; 17) Bostovë apo Bustovë (Buskova)

*(vijon në faqen 21)*




Xhafer Martini
**Kur Vdiste Kanuni**
Roman
Botimet Geer
Tiranë, 2012.
416 faqe

800 lekë

ISBN:
978-9927-07-040-1

# Dritë dhe ...hije

## Mbi romanin "Kur vdiste Kanuni" të shkrimtarit Xhafer Martini

Nga **VESEL HOXHA***

**DRITË...**

Veprat e mira letrare ekzistojnë. Midis tyre edhe romane. Por ne nuk i shohim. Lexuesit janë të çorientuar. Pjesa më e madhe e rinisë është larguar nga leximi. Media elektronike dhe e shkruar nuk ndihmojnë kulturën tonë, ato janë vënë në shërbim të pak njerëzve, siç u vu re edhe në panairin e librit, ku u bë zhurmë e jashtëzakonshme vetëm për tre-katër libra politikanësh që nuk kishin të bënin me letërsinë. Librat e tyre u shitën, megjithatë ato janë si flakë kashte, janë për konsum të shpejtë. Nuk janë vepra afatgjata. Kur them se librat e mirë ekzistojnë, këtu kam parasysh edhe romanin "Kur vdiste kanuni" të shkrimtarit Xhafer Martini. Ky roman hyn tek ato vepra që do të jetojnë gjatë. Është një roman epope po të gjykojmë nga disa tregues: ai rrok një hapësirë kohore për më se një shekull, përfshihet në të fati i më shumë se njëqind personazheve në pesë breza njerëzorë. Në qendër të këtij romani është fati historik i malësorëve dhe krerëve të një krahine që quhet Ndërmale, me zemrën e saj, Çernaja, por shtrirja gjeografike është shumë më e madhe, sepse marrëdhëniet midis parisë dhe halisë, që janë në qendër të këtij romani, pothuajse kanë pasë tipare dhe karakteristika të përbashkëta në të gjitha trojet shqiptare. Kjo, për më tepër, duhet thënë edhe për faktin se shkrimtari di të bëjë përgjithësime të rëndësishme, di të kalojë me lehtësi dhe mençuri nga krahinorja në atë që është kombëtare, madje edhe universale. Interferimi dhe rezonanca janë të përhershme në këtë roman. Kjo falë përvojës së gjatë letrare të autorit. Nga ana tjetër, personazhet e këtij romani veprojnë edhe ne Europë, edhe në Azi. Ata, në sajë të natyrshmërisë me të cilën i sjell shkrimtari dhe i vendos në Çernajë, rrezatojnë edhe kulturën e mendësitë e vendeve nga kanë ardhur. Ky shkrimtar që me fillimet e tij para pesëdhjetë vjetësh ka dëshmuar talent. Hapësirat e lirisë njëzetvjeçare i ka shfytëzuar për rritjen e energjisë krijuese çka dëshmon se liria u duhet shumë të talentuarve, të cilët e vlerësojnë atë dhe nuk e shpërdorojnë.

Në këtë roman jepet jeta parashtetërore kur sundonte kanuni. Në bazë të tij rregullohej jeta në atë kohë. Kishte një pushtet të huaj, por ai është i sunduesit dhe tingëllon shumë i largët, i papërfillshëm për këta njerëz që ishin veçuar mes maleve. Romani është historik, por jo si ato tradicionalë, që letrarizonin historinë. Në këtë roman nuk ka të ashtuquajtura ngjarje kulmore. Historia nga ky autor është jeta e përditshme, ai historinë, siç e thotë edhe në parathënie, e shikon si një pakt midis të gjallëve, të vdekurve dhe atyre që nuk kanë lindur akoma. Në roman shikohet dhe preket ndeshja midis kanunit dhe fesë. Normat fetare nuk kanë mundur të ndërhyjnë në kanun të Ndërmale. Kjo shikohet si pozitive nga autori. Kanuni, sipas autorit, është i rreptë, por i drejtë, kërkon zbatimin nga të gjithë dhe nuk përjashton asnjë. Normat e tij janë efikase se është krijuar nga populli për t'i shërbyer atij. Nuk është pushtet i askujt, vetëm i popullit. Krerët e parisë kanë ndikimin e vetë në jetën e malësorëve, siç kanë edhe ata ndikimin e vet në jetën e krerëve. Krerët e parisë kanë mosmarrëveshje dhe kundërshtime me njeri-tjetrin. Populli nuk u vishet të gjithëve njëlloj. Ai i shikon si punojnë, si sillen me të, prandaj edhe i diferencon. Në një kuptim kemi një "rotacion të pushtetit", jo në kuptimin direkt të kësaj fjale, por me karakter ndikues. Kjo ndodh për vetë faktin, se populli e kushtëzon përkrahjen që u jep me sjelljen që ata kanë ndaj tij. Shkrimtari sikur do ta paraqesë atë jetë me një farë demokracie, si demokracia Athinjote, ose duke e përqasur me idetë e Rusoit dhe mendimtarëve të tjerë që ishin për vetëqeverisjen.

Në këtë roman kemi shumë personazhe të realizuar dhe të portretizuar me mjeshtri të madhe, si: Kucbashi i Madh, djali i tij, Sadiku, djali më i vogël, Binaku, nipërit e tij, Martin Kodashi dhe Angjelin Kolja, gruaje e Kucbashit, Ujana. Këto personazhë janë të gjithë nga paria. Por, edhe kur janë nga populli i thjeshtë, janë ose në lidhje e miqësi me parinë, ose janë ngritur në lartësinë e saj nga shkolla. Romani ka ngjarje tronditëse, dramatike, të paharruara, se ai, ndonëse nuk letrarizon historinë, mbështet fort në realitetin e kohës. Autori Xhafer Martini e ka shkruar këtë roman pas një njohjeje shumë të mirë të historisë, të kanunit, të gjakmarrjes, zakoneve dhe traditave të popullit, kulturës dhe entokulturës së tij. Tjetër gjë është këndvështrimi tij për këto ngjarje, personazhë etj. "Kur vdsite Kanuni" është një roman me pretendime të mëdha, është pasqyrë e një epoke, me një hapësirë të gjërë, me një frymë universale, me njerëz të fortë dhe të vërtetë.

Romani është shkruar bukur. Ka një frazë të punuar, realiste, që zë vend dhe nuk lëviz. Fraza e tij herë e shkurtë dhe herë e gjatë, sipas nevojës artistike dhe objektit që kishte për të përshkruar, është vënë si gurët e gdhendur në muret e kalasë dhe nuk lëviz aspak. Romani është voluminoz, por nuk është i stërzgjatur, përkundrazi, ka një ritëm dhe dinamizëm të brendshëm. Në roman një vend të gjerë zë alegoria. Kjo mënyrë të foluri është pronë e të gjithëve, sepse është pjesë e kulturës së tyre të shprehjes. Autori e njeh lexuesin me shumë alegori të bukura, sepse ai di të japë në mënyrë të natyrshme situatat nga të cilat burojnë ato, megjithatë tregohet i kujdesëshm që ajo të mos bëhet qëllim në vetvete, por të jetë në funksion të ngjarjes, situatës, karakterizimit të personazheve etj.

Autori tregon kujdes dhe dashuri të madhe ndaj gjuhës, si mjeti kryesor i shprehjes së mendimeve. Në këtë roman nuk ka letrarizma. Ka një stil të gjallë, energjik, dinamik. Kaq shumë të sigurtë e ndjen autori veten nga ana stilistike, sa fraza e fjalitë e tij shpesh kalojnë në poezi, ato rimojnë. Shumë shprehje dhe dialogë të kujtojnë një dramë në vargje. Po japim vetëm pak prej tyre, që autori nuk i ka dhënë në mënyrë të sforcuar, por fare natyrshëm, kryesisht përmes gojës së personazheve: "gruan për Nezirin, vashën për të birin...", "Kros Krekasani, kishte mendje hajvani", "Mos shko tek Zef Rrokaqelli, se të vë në sofër mish derri", "Qeshte me hihihi Caliku, si pula që di ku asht furriku", "I shkreti Fil Trapi, gjithçka e bënte lesh arapi", "Jo me të dy përnjëherë, se të bëjnë m.... në derë", "Sivjet është vit zie, njerëzit kanë vdekur urie", "Kucbashi erdhi dhe u nxi, si reja kur lëshon shi", "Ne kruajmë ata që u kruhet, i ndershmi nga ne mos të ruhet", "Më mirë të kishe vënë sipër qenin e Bar Dules, sesa t` i uleshe Sek Fasules" , "Ata që e kishin vrarë, nuk duhej të vinë për ta qarë", "Vrasja është helm i madh, por të ngushëllojnë", "Marrja e armëve turp i madh, ç` të të thonë?!" etj., etj..

Autori sjell edhe shumë fjalë të papërdorura më parë, duke treguar një kujdes dhe përkushtim ndaj gurrës së pashterrshme të popullit: llapërçon, kacle, bilik, shteguar, kërleshë, zhamret, ujdis, shtrabzoi, zgrepur, mugajet, shereleg, tuzak, lmekur, rruspie, kalaviças, katrrosh, dudat, rrethtoheshin, piroll, kacarrupën, zdramca, vgjani etj., etj.

Në roman ka krahasime të zgjatura që arrijnë në similitudë që i japin hapësirë mendimit, si: "Kucbashi i Madh ishte si karrocieri që i rrëshqasin nga duart frerët e kuajve të trembur dhe nuk dihet ku do të gremiset", "Paria ishte si ajo lera e gurëve, që, një gur po t` i heqësh, bie e tëra në humnerë", "Gratë u mblodhën në fundin e avllisë dhe rrinin si sorrat në trungun e lisit", "Hapat e para i hodhi me pasiguri, si fëmija që ngrihet për herë të parë në këmbë" etj., etj..

Ky roman ka vlera njohëse. Asnjë vepër historike nuk do ta jepte kaq qartë, pastër dhe në mënyrë emocionuese periudhën kohore për të cilën ka marrë përsipër të tregojë. Kjo ndodh se arti ka përgjithësim të madh, i asmilion dhe i filtron ngjarjet, t'i jep ato jo thjesht si të tilla, por edhe me domethëniet e tyre filozofike, historike, morale etj. Ky roman është si një muze i madh dhe shumë i pasur që nuk shikohet brenda një ore, as edhe disa ditëve. Gjërat e mëdha dhe të rëndësishme duhet kohë për t'i njohur dhe për t'i shijuar, ata duan edhe durim. Po të jeni pajisur me këto cilësi, në këtë roman do të gjeni vlera të mëdha.

**...HIJE**

Por edhe ky roman ka të meta dhe dobësi që do t\i vemë në dukje nga këndshikimi që i shikoj unë problemet, këndshikim që nuk përputhet gjithnjë me të autorit, për të cilin kam nderim dhe respekt të veçantë. Në romanin "Kur vdes Kanuni" përmbyset raporti midi klasave: paria, feudalët, bajraktarët, agallarët, bejlerët, ky autor i quan njerëz të mëdhenj, me shpirt të madh, me zemër flori, që kanë bërë shumë për popullin e thjeshtë, që i kanë qëndruar atij pranë, i kanë dhënë bukë, e kanë mbrojtur dhe janë, si të thuash, baballarët e tij. Ky shkrimtar thotë se edhe roli i tyre atdhetar është më i madh sesa ai i halisë, se janë bejlerët dhe agallarët ata që i kanë dhënë tonin patriotizmit dhe se masat popullore u kanë shkuar mbrapa. Populli në këtë roman paraqitet i nëpërkëmbur, i nënshtruar, servil, në shërbim të bajraktarëve, bejlerëve, shkurt, një shërbëtor, i cili, as nuk meriton të ndëshkohet. Populli paraqitet nëpërmjet personazhëve si: Fil Trapi, Gjenerali, Makja etj.. Lind pyetja: si janë paraqitur ato? Janë paraqitur me plot të meta, madje edhe ironizohen dhe tallen nga ana e personazheve të tjerë, çka do të thotë se tallen e përbuzen nga vetë autori. Kurse personazhe të tjerë nga populli, si: Sek Fasulja, Krep Pula, Vesel Verderi, Nezir Hralla, nuk janë njerëz, por dordolecë. Me pak fjalë, populli në këtë vepër, megjithëse zë shumë vend, është një lloj graniture që jo vetëm nuk e zbukuron pjatën, por as që hahet.

Në roman është edhe një çift pleqsh, Vesves Huta dhe Murat Muta, që rrinë nëpër mexhelise dhe bëjnë vetëm muhabet, duke u marrë më shumë me alegori. Këto pleq të kujtojnë disa figura reale historike, njerëz që kanë jetuar, kanë përthithur e shpërndarë mençurinë popullore, si: Selim Sula, Tafë Kola etj.. Por ndryshe nga këta të fundit, që vërtet kanë qenë të varfër dhe kanë jetuar në odat e parisë, por kanë qenë krenarë, me dinjitet, pleqtë e romant të Martinit janë pa personalitet, të nënshtruar, janë në shërbim të parisë, sidomos të Kucbashit të Madh, para të cilit rrinë si macja nën sofër. Pra, edhe këtu shkrimtari paraqitet denigrues.

Në roman është edhe linja e nënë Rashes, një grua që, siç e thonë personazhët, është minierë floriri, sepse që nga dita kur lindi fëmijën e parë dhe të fundit, deri në njëzet e shtatë vjet më vonë, ushqen me qumështin e saj fëmijët e tre copë katundeve. Qumështi i saj ka vlera kurative. Nuk vdes asnjë fëmijë gjatë gjithë kohës që ekziston Rashja. Kjo figurë është me shumë interes, por, në fund të fundit, edhe këtë figurë që përfaqëson popullin, shkrimtari e ka denigruar, e ka ulë, e ka paraqitur si budallaqe, sepse, edhe pse ka mundësi të jetojë si princeshë, jeton në varfëri. Kur duan me ia ble qumështin me flori, ajo kundërshton dhe thotë se do ta japë pa pare. Këtë mund ta bëjë vetëm një njeri që nuk ka mend. Pra, dhe në pasqyrimin e kësaj figure, shkrimtari dënon dhe tallet me popullin, natyrisht, mban një qëndrim të gabuar artistik. Nëpërmjet kësaj figure shkrimtari jep edhe një ide tjetër : populli, halia, njerëzit e thjeshtë, janë mosmirënjojës, ata nuk meritojnë as respekt e as përkushtim. Kur nënë Rashes i meni (ju ndal, i shteroi) qumështi, asnjë njeri, veç budallait Xhebro Llupaj, nuk do ta shikojë, madje e urrejnë. E ndajnë për mort dhe për dasmë,

# botime

dënim i cili nuk është praktikuar kurrë, për asnjë njeri, as për vrasësit dhe hajdutët.

Krejt ndryshe ndodh me pasqyrimin në roman të shtresës së bejlerëve dhe të agallarëve. Figura kryesore e romanit është Kucbashi i Madh, një bej i fuqishëm, i pasur, që bën ligjin në 26 fshatra, por që pyetet dhe ka ndikim në krejt krahinën e Ndërmale, që, ashtu si e jep autori, është shumë e gjerë. Tek Kucbashi i Madh, sipas autorit, mishërohen tërë tiparet e parisë së Ndërmale, si: besa, trimëria, bujaria, nderi kalorsiak, nderimi për të kaluarën historike, për kanunin, doket, traditën shekullore. Kucbashi shikohet sikur ai dhe bejlerët e tjerë janë rrënjët e kombit. Ngaqë autori është mjeshtër në dhënien e karaktereve, Kucbashin e Madh e ka ndriçuar nga të gjitha anët duke theksuar monumentalitetin e tij të jashtëzakonshëm. Ai i prin popullit në luftë edhe pse është në një moshë që mezi del në derë. Ai nuk është në gjendje të hipë as në kalë, madje as të qëndrojë në të, prandaj e lidhin me brez. Por, sipas autorit, i duhet popullit zulmi dhe e kaluara e tij atdhetare. Kucbashi idealizohet aq shumë sa bëhet një figurë legjendare. Legjendariteti dëmton realizmin. Të tillë, por në një shkallë më të ulët, janë edhe bejlerët e tjerë Kurt Lima, Has Ramdani, që luajnë rol me rëndësi në zhvillimin e ngjarjeve në Çernajë dhe në Ndërmale. Krerët e parisë kanë edhe kontradikta midis tyre, por, kur vjen puna për të mbajtur qëndrim ndaj popullit, bashkohen për ta sunduar atë. Kështu, si shembull, nuk janë të rralla rastet kur ata zihen dhe pajtohen, megjithatë njeri-tjetrin nuk e lëshojnë, bëhen bythëpërbythë si qetë që nuk donin t'i hante ujku, se e dinë pse vetëm të bashkuar mund të jetojnë dhe të sundojnë.

Por këtë qëndrim të tyre shkrimtari nuk e dënon, përkundrazi e simpatizon. Madje ai ndjen keqardhje se, me disa veprime që bëjnë, krerët e parisë bejlerët dhe agallaret, po ia shkurojnë jetën vetes së vetë.

Një tjetër e metë e këtij romani është glorifikimi i kanunint. Kanunin nëpërmjet personazhëve të ndryshëm, ai e shikon si një rregullator të rëndësishëm në jetën parashtetërore, si një semafor drite për të mos humbur kontrollin e jetës. Autori nuk tregon anën e përgjakshme të kanunit, ose, edhe kur e tregon, (ç'është e vërteta në këtë roman ka shumë ngjarje dramatike, rrëqethëse), mban anën e kanunit, justifikon qëndrimet shumë ekstremiste që bëhen në emër të kanunit.

Në romanin "Kur vdes kanuni" ka tallje me fenë, me përfaqësuesit e saj, siç është hoxhë Maxhuni. Në roman tregohet se feja është e flakur nga populli kësaj treve. Në kanun nuk ka asnjë lloj ndikimi feja, kështu thotë autori, por nuk ka asnjë lloj ndikimi sipas tij as në jetën e njerëzve. Është tipike një skenë ku tregohet se një njeri që i vjedh kaun një tjetri, pronari e gjend duke u falur. Vidh e falu, ky, sipas autorit, është morali fetar. Pra mund te themi se, me dashje apo pa dashje, luhet me dritën Hyjnore.

Do të kishim dashtë që ky autor të shmangte të meta të kësaj natyre, që nuk janë të vogla, po ashtu dhe, disa aspekte te marrëdhënieve ne çift, krejt te panevojëshme, mbasi kanë të bëjnë me koncepte kryesore për jetën dhe për shoqërinë.

** Universiteti Politeknik i Tiranes. Instituti i Gjeoshkencave, Energjise, Ujit dhe Mjedisit.*

## Libri i ri




Iljaz Kaca
**Dibra në faqet e një ditari arkeologjik**

Botimet "Albtipografia"
Tiranë, 2012.
384 faqe

800 lekë

ISBN:
978-99956-24-49-1

Ka ndodhur nje ngjarje? Keni ndonje shqetesim

per te ndare me komunitetin?

Keni ndonje propozim per zhvillimin e zones suaj?

Doni te informoni komunitetin rreth jush per dicka qe ju intereson atyre?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

***Të nderuar bashkëpunëtorë***

Prej muajsh, redaksia ruan në arkivin për botim disa materiale, të cilat po të botohen zënë një hapësirë prej 2 ose më shumë faqesh.

Për këtë arsye, redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" njofton gjithë bashkëpunëtorë e saj, se shkrimet që sillen për t'u botuar, duhet të jenë jo më shumë se **5 faqe të daktilografuara** (përafërsisht 10000 mijë karaktere, pa përfshirë hapësirat). Materialet që vijnë me email ose në çdo lloj forme elektronike, duhet të jenë në Word, me fontin **Times New Roman**, të **madhësisë 12pt dhe me hapësirë 1.5.** Gjithashtu, kujtojmë se materialet e pranuara në formë elektronike duhet të kenë patjetër germat "ë" dhe "ç".

Çdo material i gjatë do ti nënshkrohet redaktimit dhe shkurtimit për tu botuar në versionin e shtypur të gazetës. Versioni i pa shkurtuar do të botohet çdo muaj në internet në adresën: **www.rrugaearberit.com.** Autorët mund ti shkurtojnë vetë shkrimet dhe të na i përcjellin në redaksi me dy versione botimi: për gazetë dhe për internet.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira të redaksisë për bashkëpunimin e deritanishëm..

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <rrugaearberit@gmail.com>

Redaksia.

cyan magenta yellow black

Lufta ndaj sëmundjes
së gështenjës

© Foto: **Rexhep Ndreu**



# Pylli i fermerit ka zot fermerin

Nga: **HAKI KOLA**

*(Vijon nga numri i kaluar)*

**KRASITJA E RICUNGIMI: TRADITË E PRAPAMBETUR, APO TRAJTIM SHKENCOR PËR TË RRITUR PRODHIMIN???**

Ricungimi, prerjet apo krasitje te ndryshme jane ushtruar nga njerezimi ne 6000 vitet e fundit, duke drejtuar prodhimin bimor, ne interes të jeteses. Opinioni e pranon termin e trajtuar nga shkencat bujqesore, vecanerisht si trajtim te pemës per prodhim frutash, e adoptuar sipas kerkesave te cdo druri frutor, ndërsa duket si term jo familjar për druret pyjor. Të dyja me origjine vegjetative si parakusht për rritje të shpejte, e kunderta e pyllit natyror me origjine farore e me rritje të ngadalta ne vitet e para, për fermerin, duket se pema është një, dhe trajtimin e përshtat sipas destinacionit, pra për prodhim fruti, ose biomase. Pikërisht kjo ben dallim esencial ne zbatim, duke perdorur shpesh edhe terminologji te ndryshme nga rasti ne rast. Krasitja e drufrutoreve, synon te stimuloje formimin e sytheve frutore, duke prere, llastare, dege apo bisqe, duke u mundesuar atyre qe jane ne pozicion te favorshëm të përdorin me efektivitet dritën e diellit, e cilesuar si "korrje e diellit". Krasitja apo shkadhitja e drureve pyjore, ka per objektiv shtimin e asaj pjese vegjetative qe i duhet pronarit, dhe pergjithesisht ka si princip qe sythet vegjetative te kenë mundësi te barabarta per tu ekspozuar karshi drites se diellit. Ndersa ne rastin e pemeve frutore, objektivi i krasitjes eshte rregullimi maksimal i raporteve te sytheve frutore me driten e diellit, ne rastin e drureve qe prodhojne biomase, objektivi eshte rregullimi i sytheve vegjetative ne raport me driten e diellit. Te dyja keto mjeshteri jane zbatuar nga fermeri e kane evoluar qe nga lashtësia. Trajtimi bëhet për të shpejtuar dhe shtuar prodhimin, pra është punë që fermeri e vlerëson që ia shpërblen. Në kete kuptim druret qe i nenshtrohen ketij trajtimi, per te prodhuar biomase, gjethe, shkarpa, thupra, hunj, dru, apo lëndë ndërtimi, kanë qenë historikisht pjese e fermes bujqësore, dhe qëndrojnë larg termave dhe parimeve te menaxhimit qe aplikohen nga ekspertet e pylltarise moderne objekt i shkollave tona pyjore, të orinetuara kryesisht tek pylli i lartë, me origjinë farore e me cikel përgjithesisht shekullor. Në librin më autoritar të pylltarisë shqiptare ne vitin 1955, Ilia Mitrushi do shkruante që shparthi si pyll i ulët rekomandohet të trajtohet me qarkullime 18-25 vjecare, dhe në toka të trasha jep deri 30 mst dru për ngrohje ne vjet, dmth 540-750 mst dru për ngrohje në një hektar brenda një turni 18 deri 25 vjecar, ndërsa një hektar pyll i ulët qarri jep sipas kualitetit të tokës ku rritet prej 10 deri në 40 metër ster (m3 te stivosura) dru për ngrohje në vit, me rotacion 14 vjet, pohime për sasira rreth 10 deri 20 herë më të mëdha nga ato që arrihen të prodhohen aktualisht, e cuditërisht këto të dhëna të vërtetuara në shumë raste në pyjet e fermerëve, nuk u përfshinë në librat për nxënës apo studentë të pylltarisë që u hartuan pas viteve 1960.

Shumica e eksperteve te Pyjeve e vleresojne menaxhimin tradicional me drurë të ricunguar apo të krasitur si të dëmshëm, që con shpejt në degradim, shëmton pejsazhin e pakëson diversitetin. Autorë të ndryshëm që kane studjuar reagimet fiziologjike te drureve te ricunguar apo krasitur, i argumentojnë këto ndërhyrjes me ndikim pozitiv ne rritje te jetegjatesise se drurit apo shtim të biodiversitetit.

Fontanier dhe Jonkers (1976) theksonin që një krasitje e rëndë e degëve apo trungut kryesor, ka efekt pozitiv , pasi e vonon pleqërine e drurit. A jo shkurton tansportin e brendëshëm në dru dhe përmirëson furnizimin e periferisë së kurorës së drurit me ujë dhe lëndë ushqyese. Kjo mund të jetë pasoje e rilindjes fiziologjike. Krasitja gjithashtu nxit sythet e reja apo indet të formojnë llastarë normale apo adventive, ata që janë më të rinj se sa ata që hiqen. Kjo trajtohet si rilindje gjysëm ontogjenetike

Një dru reagon karshi krasitjes vegjetative, duke ndërtuar masë të dendur fibrash rreth pikave të prerjes, e i reziston tharjes dhe e ndan në mënyre efektive rritjen e re, nga pjesa e trungut te vjeter. (Harris et al 1999). Kështu integriteti mbrojtës dhe strukturor i drurit maksimizohet, përgjithësisht këto krasitje realizohen tek drure qe i nenshtrohen që në rini ketij procesi, duke krijuar ndjeshmëri te lartë biologjike, dhe reagim mjaft shpejt të qelizave te gjalla karshi plagëve që shkakton prerja, apo ndryshimeve mjedisore, duke ndërtuar reaksion të fortë mbrojtes (Coder 1996)

Druret e trajtuar përvec sa më sipër zhvillojne një rilindje të vazhdueshme si dhe një kurore të re energji krijuese, mbi kokën e një trungu të vjetër në rritje. Kjo ngadalëson proceset normale të mplakjes së drurit. Në cungishtet e menaxhuara mirë, nuk ka nevojë për herbicide apo plehra, nuk është nevoja të gërmohet toka apo mbillen drurë, nuk ka nevojë të lihen drurë për hije apo vaditje. Pas ricungimit apo krasitjes, akoma pa kaluar viti, një revolucion i vërtetë realizohet, e gjithë sipërfqja e pyllit behët një skenë e paimagjiniushme e jetës që shpërthen, ku llastaret që dalin nga sythet e drurëve, janë në garë me lule shumengjyreshe, insekte, flutura zogj e gjitare. Pra përvec prodhimit të drurit e kullotjes, ky vetërinovim apo rilindje, i jep fermerit prodhime me kosto mjaft të arsyeshme, të investuar thjeshtë koha për ngritjen e sistemit apo vjeljen e prodhimit. Flekibiliteti i tij dhe përshtatja sipas nevojave, i krijon mundësi te jashtëzakoneshme si pyllit ashtu edhe fermerit, per të dhëne prodhimin që kërkohet, në dimensioned e duhura, duke e mbajtur tokën të mbuluar e ekosistemin pyjor ne funksionim të plotë.

**PYLL APO PYLL FERMERI**

Ketu është rasti që të ndahet kuptimi i fjales pyll sipas perkufizimit modern, me termat popullore qe perdoren per keto drunishte bujqesore si zabel, prozhem, ograje, kojrije, purend, mexhde, kashnjet, hamalle. Pylli ka si karakteristike, shtrirjen massive te drureve ne siperfaqe te gjera, ne kushtet aktuale te Shqiperise, keto shtrihen mbi zonat pergjithesisht te banuara ku zhvillohet bujqesia, ne zone fitoklimatike ku rritet ahu, pishat, bredhat etj.

Pra pylli klasik modern, perbehet pergjithesisht nga drure, qe me pak perjashtime, nuk jane ndikuar nga njeriu per formen e kurores, apo per te dhene nje produkt te caktuar. Ata jane rritur pergjithesisht ne menyre natyrore. Njerezit kane marre prej tyre lenden e drurit per ndertime, apo punime druri, si dhe gjate stines se veres, kane marre drure te thare, për ti perdorur si kompensim per pjesen, qe nuk e siguronin nga drunishtja e tyre bujqesore, me emrat e adoptuar sipas zonave gjeografike e kushtet.

Perdorimi i nje emertimi te perbashket "pyll" si per shkurret, drunishtet bujqesore, që kanqë qenë historikisht "pylli i fermerit", duket se ka qene pika e fillimit te konfiktit te shteti me individin, dhe pika e fillimit te menaxhimit ilegal, jashte sistemit.Ne kushtet aktuale te Shqiperise, keto drunishte jane pjese e aktiviteteve bujqesore, qe sigurojne prodhime shume të rëndësishme, dhe që ne mungesen e gazit apo lendeve te tjera djegese apo edhe te infrastructures se saj mund te konsiderohen per momentin si burim punesimi, prodhim bionergjie dhe i vetmi "shpetimtar" i pyllit malor. Kjo pjese e drunishteve dhe e menaxhimit eshte krejt e panjohur, e future ne kategorine pyll, dhe orientimet teknike qe rekomandohen nga shteti, pergjithesisht ndikojne negativisht si ne prodhimtari ashtu edhe ne zhvillim.

**ZHDUKJA E PYLLIT TE FERMERIT**

Fillimet e kolektivizimit të tokës gjate gjithe 10 vjecarit 1957-1967, u shoqëruan me propogandë intensive për ndryshimin e mënyrës jetesës. Bashke me tempujt e fesë apo kanunin, që kishin kontribuar në vendosjen e kufinjve apo te rregullave në përdorimin e pyllit e të kullotës, dalëngadalë filloi të avanconte psikologjia, që traditat apo angazhimin e fermereve për të tilla praktika menaxhuese të si silvopastoralizimi, te konsideroheshin të tejkaluara e te dëmshme. Tufëzimi i plotë i blegtorisë së imët, ne fund vitet 1970, shënoi heqjen e komponentit themelor të sistemit per trajtimin per bazeushqimore e kullote, dhe për pasoje fillimin e shëmbjes së sistemit shumë shekullor silvopastoral. Shkatërrimi erdhi vetvetiu, fermerit i mungonte nevoja pastorale, ai nuk kishte me arsye për tu drejtuar drejt një së tretës se pyllit te tij, pasi nuk i duhej kullotë apo gjeth si bazë ushqimore për dimër. Shteti kish marrë përsipër të mbareshtonte edhe blegtorinë e tij. Nuk gjëndet ndonje dokument që të dëshmojë, në se i është bërë analizë, impaktit, të këtij vendimi. Është e lehtë të mendohet, që fermeret e ekspertet e pylltarisë nuk ishin autorë të këtij vendimi. Vetë fakulteti i pyjeve në ato vite ishte në hapat e para, pa i mbushur 20 vjet. Stacioni i Pyjeve sapo ishte krijuar, e po hidhte bazat e inventarizimit e mbareshtrimit të Pyjeve të lartë. Në anët tjeter ishin vite, ku pjesa më e madhe e shkencëtareve të Pyjeve, edhe ne Europë, besonin fort tek modifikimet gjenetike apo mrekullite e llojeve me rritje te shpejte si pisha radiate, eukaliptet, plepat e hibride e shume te tjera. Akoma zbulimet arkeologjike te bazuara mbi analizat e polenit e te tjera nuk kishin dhënë dëshmi për traditat e historite e paramenaxhimit te pyllit.

Shteti e ndjeu shpejt barrën e vështirë të mbajtjes së blegtorisë. Bëri të pamundurën të mos dorëzohej, duke u futur ne një rreth vicioz vendimesh te gabuara që pasonin njëri tjetrin, shkatërro livadhe e kullota për ti bërë toka bujqësore, apo shpyllëzo mijra hektarë pyje për të bërë kullota të kultivuara, ish pyje që për shekuj i kishin realizuar njëkohësisht e vazhdonin përësëri ti realizonin, si funksionin e pyllit (prodhimin e drurit) ashtu edhe atë të bazes ushqimore për dimër e kullotjes. Sistemi u shkatërrua në pjesën më të madhe të vendit. Furrat e centralizuara të bukës, hëngrën të parët pikërisht zabelet, prozhmat, kashnjetet, ograjat e mezhdat, fabrikat apo sistemet prodhuese komplekse të krijuara nga banoret për të prodhuar periodikisht e pandërprje gjeth e dru për ngrohje, e kullote poshte tyre. Të gjithe druret në anë të arave, livadheve, përrenjve, mbartës të bukurive te pejsazhit, biodiversitetit, por edhe nevojave të njerezve, u prenë për të furnizuar furrat e bukës, e për të mos i bërë hije tokës së bukës.

Kurrë fermeret nuk i kishin kërkuar kujt, që të tufëzonin blegtorinë, apo që dikush të gatuante bukën e tyre. Ata e kishin bërë vetë mbareshtimin e blegtorisë së familjes dhe gatimin e bukës që kur kishte lindur jeta. Këto tre elemente, krejt të ndërlidhur, ishin së bashku me bujqësine, baza e zinxhirit të punësimit, edukimit e mesimit te dukurive të pyllit duke punuar në të, furnizimit te tregut, apo qytetit, për të mundësuar me shitjen e tyre këmbimin me prodhime që vinin nga industrite e qyteteve.

Shkolla shqiptare akoma nuk e ka vezhguar,analizuar këtë përdorim të tokës. Opinioni publik të mirekupton që pema frutore duhet krasitur që të prodhojë fruta, sepse shkolla bujqesore e ka mesuar e praktikuar, por nuk të kupton kur thua pylli duhet krasitur apo ricunguar për të prodhuar biomase apo dru për ngrohje, pasi shkolla pyjore akoma hesht, nuk e ka vezhguar apo shpjeguar kete dukuri, si dhe nuk e ka bere prone te eksperteve qe ajo pergatiti. Shteti as pyeti as degjoi dhe kurre nuk e kuptoi se cfare i shkaktoi tokës dhe banorëve të vet. Pas prerjes "së drureve për mbare" ish krijuesi dhe kujdestari i fermes silvopastorale (të quajtur nga shteti pyll), nuk kish më arsye ti rrinte tek koka e të priste rritjen e llastarit. Fermerit nuk i duhej me as gjeth e as kullote. Furra e bukes e hengri cdo dru si ish element prodhues, te krijuar ne shekuj nga fermeri. i gjithe territori rreth fshati u cvesh nga bimesia pyjore e ngjyra kafe u be dominuese. Kafshete e egra pothuaj u zhduken. Shteti tepër i zënë me ndërtimin e bunkerëvë në atë kohë, nuk e kuptoi marrinë që bëri.

Disa nga ish ndërmarrjet e pyjeve,

Qeveria duhet të hartojë një strategji sa më të shpejtë, për ta rregjistruar pyllin e fermerit, të llogarisë kostot e ringritjes së sistemit prodhues sipas kërkesave të kohes, të financojë fermeret e ti ndihmojë që të ringrene atë që shaktërroi...

me funskion kujdesin për pyjet, u ngarkuan nga shteti të mbarështojnë blegtori të imët. Të detyruara për të prodhuar bazë ushqimore, pa e njohur sistemin silvopastoral, ekspertet tentuan te krijojnë një model të ri prodhimi, duke vjelë vetëm gjethet e dushkut pa degë, cfare krijonte problem, pasi gungat e drurëve të krasitur, ku mbaronte druri i vjeter dhe fillonte ai qe pritej periodikisht, ishin jashte funksioni, indet meristematike të paorientuara, ndricimi i tokës nuk realizohej si përhere, e aftësia kullosore smund te realizohej pa pranine e drites së diellit. Problem kishte edhe për tharje e magazinim. Ish hapësirat pyjore, për rreth stallave ku u përqëndruan ata krijesa fatkeqe, kane mbetur toka të shkreta e akoma nuk kane arritur të rilindin vegjetacionin. Mbulesa pyjore erdhi në pakësim të menjëhershëm. E gjithë nevoja për drurin për gatim e ngrohje, iu transferua menjeherë pyllit të lartë, përgjithësisht larg fshatit, cka fermerit, i harxhonte kohën, energjine. Tek pylli i lartë malor rrebeshi i nevojave i mbeti vetëm ahut, që kurrë nuk i ishte bërë trajtim për tu përshatur për nje funksion të tillë. i ardhru që nga lashtësia pothuajnatyror, ai u gjunjëzua shpejt pa e ditur kurre se ku po e conin…

**SI TA KTHEJME FERMERIN TEK PYLLI….**

Pylli shqiptar është në nje udhekryq. Shteti si shkak kryesor i shkatërrimit, në këtë kthesë positive e iniasiativën e nisur në kërkim të zotit, nuk duhet të humbasë më kohë. Kompanite private pyjore, apo të tjera krijesa që mund ti paraqiten si alternativa Kryeministrit nuk mund ta marrin pyllin shekullor te fermerit, nuk e kane të drejten historike, nuk e kanë dijen, e as ekspertizën. Vetë këto kompani e kanë orientimin drejt pyllit te larte malor. Ai duhet menjehere ti drejtohet fermerit, ashtu sic i rekomandojne partneret nderkomberate ne 15 vitet e fundit, ashtu sic i kerkojne 248 shoqata te ngritura ne 248 komuna te vendit, e te perfaqësuara ne shqoqata kombetare e pyjeve te fermereve. Pra Qeveria duhet ti drejtohet fermerit, së pari duhet ti kërkojë atij dhe kombit falje për dëmin që bëri shteti komunist. Të hartojë një strategji sa më të shpejtë, për ta rregjistruar pyllin e fermerit, të llogarisë kostot e ringritjes së sistemit prodhues sipas kërkesave të kohes, të financojë fermeret e ti ndihmojë që të ringrene atë që shaktërroi, të kërkoje ndihme ndërkombëtare, në kuadrin e projekteve për pagesa për shërbime mjedisore, të kërkoje që të shtohen expertet e pyjeve, duke angazhuar mundesisht nga nje ekspert pyjesh per cdo fshat te vendit, ti edukoje për të realizuar këtë shërbim të madh kombëtar….. Në paralel të filloje ngritjen e agropylltarise ne zonen fushore perendimore si dhe ne fushat e Korces e Devollit, per te permiresuar, token, per te ndihmuar bujqesine, shtuar biomasen e ndihmuar pyllin ne kete periudhe ringritje. Kjo do të ishte shenja e parë që qevreia spo bën shakanë e rradhës por po reflekton për një gabim historic, më pasojë shaktërrimin e tokës e varfërimin e banorëve…..

# Bajram Totraku, intelektuali i Katër Grykës

**I lindur për drejtim si i thonë, këmbëngulës, njohës i traditave e karareve të popullit. Ishte dhe mbeti burri dhe intelektuali, gjurmuesi dhe krijuesi, studiuesi dhe njohësi i mirë i historisë.**



Kur shteron pusi i dihet vlera ujit, thoshte ideologu i madh i rilindjes kombëtare Sami Frashëri. Përse e përmend këtë qysh në fillim?.Sigurisht që jeta është e bukur, me plot gjurmë, plot dhimbje e lumturi.Jeta vërtet vazhdon, njeriu sikur përtërihet, sa vjen e sikur të ndodhet pranë, sikur të troket me bëmat, me shpirtin, me ato çka ka lënë pas.Krahas shumë e shumë gjurmëve, shumë e shumë mirësive ajo që sikur na troket fort sot janë edhe provat e mençurisë, provat e jetës, të studimeve, të shembullit prej intelektuali të shquar, me këtë botë të madhe shpirtërore.Këto la pas Bajram Totraku i Lukanit, ai që fizikisht nuk jeton më por që sikur lartësohet çdo ditë, sikur është midis nesh, sikur i rrezaton kohës e breznive me provat e rralla të mençurisë intelektuale populllore. Unë që kam patur fatin ta njoh shumë thellë, nga afër, ti njoh shpirtin e vullnetin, maturinë e respektin, thellësinë e mendimit e filozofinë e lindur prej natyre që ia kishte dhuruar Zoti, ndjej një peshë a barrë të rëndë për të gdhendur qoftë edhe pak rrjeshta në këtë shkrim të thjeshtë.Bëmat dhe provat e mençurisë së Bajram Totrakut janë të shumta e të gdhendura në qarqet inteelektuale, në muzetë populllore, në odat e Dibrës e më gjërë.Ai qe i veçantë si intelektual, studiues i rrallë, bashkëpuntor i rregullt shtypi, njoohës i mirë i historisë dhe folklorit të Katër Grykasve dhe mbarë Dibrës, Matit e më gjërë, gurmues dhe krijues i alegorisë së odës, njeri me intelekt të mprehtë, drejtues me vyrtyte, pasion e aftësi të shquara drejtuese, komunikuese, i cili u jepte krah e i ndihmonte e vlerësonte ato që ai drejtonte.Dinte të komunikonte e peshonte fjalët që thoshte, godiste me mana(mesele e alegori), lartësonte vlerat e traditat populllore e intelektuale.Lindi në fshatin Lukan të Katër Grykasve më 1 maj 1927 në një familje bujare e fisnike në familjen e Ali e Zenel Totrakut, kullë e fis i shquar në Lukan, zonë e Dibër dhe vdiq më 24 prill 2006 ku tashmë u mbushën plot gjashtë vjet që nuk jeton më midis nesh por vepra që la pas do të jetojë vite me radhë.U edukua me kulturë të gjërë, u brumos me traditat e larta atdhetare e patriotike. Shkollën fillore e mbaroi në Qafë Murrë ku mësues kishte normalistin nga Elbasani Hysen Abdihoxha. Shkollën shtatëvjeçare në Peshkopi me rezultate të shkëlqyera.Bajram Totraku u aktivizua me lëvizjen nacional-çlirimtare pasi daja i tij Liman Muça ishte baza kryesore e daja tjetër Sulë Muça ndër partizanët e parë të njësitit të parë partisan në Dibër. Bajrami pasi mbaroi një shkollë pesë vjeçare për financa në Peshkopi, vite më vonë nuk mjaftoi me kaq por përfundoi dhe fakultetin ekonomik në Universitetin e Tiranës. Megjithëse i aksidentuar në njërën dorë dhe në njërin sy, ai luftoi dhe punoi aq shumë sa vërtet mund të quhet një promote i përkushtimit njerëzor, një drejtues dhe organizator vizionar, një misionar që la pas veprën, botimet, provat e drejtimit e të mençurisë.Shpesh kam dëgjuar në Kastriot,Çidhën, Qafë Murrë, Luzni, Lurë e gjetkë ku shumë pleq sot e kësaj dite thonë: Bajram Totraku i Lukanit si intelektual ishte i rrallë, ishte perfekt në çdo lloj pune.Bajrami shërbeu si kryetar lokaliteti të Selishtës, sekretar i Qarkut Dibër pas viteve pesëdhjet,drejtor i Ndërmarjes prodhimeve Dibër, drejtor në Komunale Dibër ku në këtë periudhë ishte pikërisht dora e tij që e bleroi dhe qytetin e Peshkopisë me blirin, drejtor i pyjeve Mat-Dibër, shef plani në ish kooperativën Dohoshisht, kryetar i këshillit të qytetit Peshkopi, shef plani në komitetin ekzekutiv Dibër. Bajram Totraku punoi e drejtoi me dinjitet, përballoi vështirësitë që haste në ato vite.Ai ishte dhe mbeti një zë original, një kuadër me përvojë të gjatë në drejtim dhge menaxhim.Edhe sot e kësaj dite populli i Katër Grykëve, Bulqiza, qytetarët e Peshkopisë, pleqtë e odave në zona të ndryshme të Dibrës qysh nga Reçi, Dardha, Kalaja e Dodës, Luznia, Gjorica e Shupenza e kujtojnë me respekt këtë burrë të urtësisë dibrane, këtë intelektual që shërbeua vite me radhë në shërbim të njerëzve.Bajram Totraku ishte kurdoherë i thjeshtë, Iimatur, human e dashamirës për kuadrot e rinj, ndihmues , i papërtuar, studiues e vullnet hekurt, i prerë në diskutime.Fliste aq sa bënte dhe bënte ato që thoshte.Nëse do të mbledhim mbresat që sot kanë të tjerë për Bajram Tortrakun ato janë shumë. Bashkim Ndregjoni tregon:"Ai ishte i lindur për mençuri populllore, për art drejtimi si dhe për studime historike dhe folklori. Njëherë kur më duhej të bëja pemën gjenaologjike të fisit Ndregjoni unë mbeta. Bajrami e mbaroi vetë qysh në zanafillë e deri sot tek nipërit e mbesat.Pra ai nuk ishte vetëm intelektual dhe kudro me përvojë por dhe një historian dhe studiues i mirëfilltë. Ai ka lënë një sërë kujtimesh në dorëshkrim për historinë dhe folklorin e krahinës së Katër grykëve por dhe gjithë Dibrës. Velo Cfarku në librin e tij "Të parën kemi Dibrën" do të shprehet për Bajram Totrakun:" Ekonomisti me përvojë e aftësi të spikatura Bajram Totraku , në rolin e shefit të seksionit të ekonomisë në komitetin ekzekutiv ishte shtylla bazë e komitetit.Studimet e tij qenë të bazuara e realiste.Por ai ishte dhe një veprimtar aktiv, shoqëror, i spikatur që të bënte për vete me argumentat që jepte.Ne e kishim një nga bashkëpuntorët më cilësor të gazetës ku shpaloste suseshëm dijet e tij në shkrime që botonim për zhvillimet ekonomike e rrugëdaljet, perspektiva të ecurisë së rrethit….". E Faik Bruçi në librin e tij "Fisi Bruçi i Lukanit" thotë:" Bajram Totraku, njeriu që ia ngriti emrin Lukanit dhe Katër Grykëve.Nuk janë të pakët ato njerëz nga Dibra e Mati që po t'u përmendësh Bajram Totrakun të thonë menjëherë:-E njohim, ia kemi dëgjuar zanin.Bajram Totraku ishte jo vetëm një ekonomist i mirë por dhe një historian i mirë…" I lindur për drejtim si i thonë, këmbëngulës, njohës i traditave e karareve të popullit. Ishte dhe mbeti burri dhe intelektuali, gjurmuesi dhe krijuesi, studiuesi dhe njohësi i mirë i historisë.

**MEVLUD BUCI**

## Shkruajnë lexuesit

### Duhet përdorur termi "Dibra e Epërme" në vend "Dibra e Madhe"

*Duke ndare sheqtesimin Tuaj dhe te gatshem per çdo kontribut dhe ndihme tonen qe do te nevoitej dhe do te ishte e mundur, do te donim te benim dhe nje sugjerim te vogel, gjithmone eshte ne doren Tuaj per t'u pranuar ose jo. Ky sugjerim i yni eshte miqesor, persakohe marredheniet tona me xhornalen "Rruga e Arberit" kane qene te tilla qe ne fillim. Ia kemi sugjeruar disa here kryeredaktorit Skarra, por ai asnjehere nuk ka dashur te degjoje nga ai vesh. Çeshtia eshte me kujdesin qe duhet treguar me termat, pasi tashme kjo media ka krijuar nje elite lexuesish, te cilet, tashme jane mjaftueshem te informuar mbi shume aspekte qe nuk i dinin me pare. Keshtu ne e kemi konsideruar jokorrekt perdorimin e termit "Dibra e Madhe" ne vend te termit te sakte qe do te duhej te perdorej ne kete rast "Dibra e Eperme". Kojtojme se toponime te kesaj kategorie gjinden dhe hasen shpesh ne perdorimin e shqipes. Keshtu kemi per shembull Brest i Eperm, Brest i Poshtem, Katund i Eperm, Katund i Poshtem, Lagjia e Eperme, Lagjia e Poshteme. Megjithese nuk e mohojme faktin dhe argumentin historik se zanafilla e denotacionit, pra emertimin Diber, ne formen Deura gjindet pikerisht ne ate rajon, madje mendohet se Orachu i lashte te jete permbytur nga liqeni, dhe termi Sheher eshte krejt tjeter gje, kjo nuk e kondicionon nje raport te tille siç perdoret rendom Dibra e Madhe dhe Dibra e Vogel. I kemi paraqitur kryeredaktorit ne fjale nje pershkrim te hollesishem gjeografik te Dibres dhe te ekzistences se orakullit te lashte nga i cili buron vete emertimi Diber, forma e se ciles ka dhene trajtat e tilla Deurah-Orahonik-Rahonik dhe me vone u shnderrua ne Sheher, dhe nga ku u trashegua edhe emertimi Rruga e Arberit, emertim te cilin e mban organi juaj i çmueshem. Pra, krejt miqesisht, si dshamires dhe lexues te rregullt do te donim qe te ishim me te kujdeshem ne perdorimin e termave, pasi vertete ato duken te the\jeshta dhe pa ndonje ndikim ne dukie, por ne fakt mbartin nje rendesi te veçante.*

***Me respekt. jareah_center@yahoo.com***

Rruga e Arbërit nr. 72

studim

Hilmi Sadiku iu kushtua shkollimit e mbledhjes së trashgimisë kulturore të Dibrës në të dy anët e kufirit të sotëm shtetëror për më shumë se gjashtëdhjetë vjet.

# Historiani kopshtar

Nga: **Dr Selman MEZIU**

Si i ndodhi një njeriu të tillë të zgjuar e të shkolluar deri në "palcë" të trurit të ushtroi profesionin e lulishtarit? Do të jetë shumë e vështirë të ndërtojmë gurë pas guri, kalanë e bindjes për një historian si Hilmi Sadiku i cili iu kushtua shkollimit e "mbledhjes së trashgimisë kulturore të Dibrës në të dy anët e kufirit të sotëm shtetëror" dhe duke ".... mbajtur kumtesa dhe publikuar shkrime" gjithashtu duke".... bërë një punë të saktë shkencore në arkiva...." për më shumë se gjashtëdhjetë vjet. Këto janë bimët me lule, fara e të cilave do të krijoji kopshtar të vyrtytshëm te fushës së dijenive në krijimtaritë historike, etnografike, gjeografike, etj për të krijuar kopshtije të tjera dijenish.

### UDHA E SHKOLLIMIT

Lindi në çerkun e pare të shekullit të njëzetë, më tetë Korrik, nga një familje e varfër e Trebishtit të Gollobordës. Mësimet e para i mori në fshatin e lindjes, ndërsa shkollën Normale të Elbasanit e kreu gjatë viteve të luftës së Dytë Botërore 1940- 1946, me shkëputje për arsye të kësaj lufte të përgjakshme, sëbashku me Botanistin e Shquar Mustafa Demiri.

Për disa vite shërbeu si mësues në krahinën e Gollobordës, duke ushqyer me dije e kulture shqipëtare fëmijët e fshatarëve të varfër të kësaj krahine malore, në këto kohë shumë të vështira të situatave politike, ekonomike e shoqërore.

Më pas ndjek studimet në Universitetin Shtetëror të Tiranës për Gjuhe Letërsi Shqipe dhe Histori të cilën e përfundoi në vitin 1963. Dhe përsëri si mesimëdhënes në shkolla të ndryshme të rrethit Dibër. Duke dhënë shembullin si mësues këkues, sistematikë dhe i ndërtonte mësimëdhenien mbi bazat e një pedagogjie bashkëkohore, duke i paraprirë kështu një shkollimi sa më profesional e të kulturshëm.

Ndërkohe studionte gjuhë të huaja, ku ai arriti të zotronte me punën e tije plotë vullnet e sedër këto gjuhe: Maqedonisht, Serbo-kroatisht, Italisht, Bullgarisht dhe Latinisht aq dobiprurëse në punën e tijë studimore shkencore.

### THURJA E IDEVE

Tashmë Hilmiut me pjekuri të plotë profesionale, dhe i dalluem në studime të veçanta, i ngarkohet detyra më fisnike, dhe më e përgjegjshmja, ngritja e Muzeut Historik të Rrethit Dibër e kjo ndodhi në vitin njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë. Ai e nisi punën me mbledhjen e dokumentave në arkivat e ndryshme të Peshkopisë, Tiranes dhe jashtë shtetit, si edhe shfletime librash e dokumentash në biblioteka të ndryshme të vendit tonë.

E rëndësishme ishte mbledhja e informacionit e marrja e matreialeve të ndryshme për tu ekspozuar në stendat e muzeut, nga arkeologë ose gjetje të rastësishme anembanë krahinës së Dibrës. Këto matreiale duhet të kishin karakter, historik, etnografik apo të traditave të vjetra të Dibranëve në zejtari të ndyshme etj.

Dhe rezultati u duk në horizontin e bulave të djersës të mundit të të gjithë grupit për ngritjen e muzeut, i cili përurohet me 23 Gusht 1969. Natyrisht nuk vonoi shumë dhe ai zgjidhet Drejtor i tijë, duke e kryer këtë detyrë për gjashtë vjetë, me korrektësi, pasion e ambicjen për ta pasuruar atë vazhdimisht me objekte muzeale e dokumentacione të ndryshme, të shkruara ne kohë të ndryshme.

Ai shikonte një boshllëk të madh në trajtimin nga ana historike e periudhave të ndryshme historike të trevës Dibrane, kështu Hilmiut i lindnin ide të reja, për te rrokur tema të ndryshme të etnokulturës se sajë, në kohë të ndryshme zhvillimi duke hedhur fashe drite mbi çështje të ndryshme të historigrafisë dibrane.

### PJEKURIA DHE PASIONI

Trajtesa të temave të ndryshme me karakter historik Hilmi Sadiku i kishte filluar që në Universitet. Duke analizuar punën e vështire të një historiani i cili e filloi gjithëçka nga a-ja, por ai e kishte të qartë se sa vështirë do të ishte ky udhëtim dhe ja si shprehet historiani gjerman Teodor Momsen: Që e shkruajtura të përmbajë besnikërisht realitetin historik, por jo vetëm nga litetratura por edhe nga jeta e gjallë, kështu duhet ti drejtohemi njohjes sonë mbi antikitetin në memorien tonë duke përfituar njëkohesisht nga njohja jone sikur të udhetonime me objektiv studimi në një vend ku kërkojmë të shkruajm historinë."

Vështirësia objektive që u ndeshën në pasqyrimin e personazheve historike apo periudhave të ndryshme ishte mos gjetja e matreialeve të shkruara në gjuhën Shqipe, Hilmiu e përballon me mbledhjen e materialeve nga më të moshuarit e pëzgjedhur sipas zgjuarsisë ose pjesmarrjes direkte të tyre në ngjarje, të marrë në vende të ndryshme psh:

"Fido Sadik Sadikaj. Lindur në vitin 1862,.... intervistë e vjelur prej autorit të punimit të këtijë materiali ne vitin 1950, ku tregimtari ishte 88 vjeç" Lexojmë një tjetër intervistues:

"Tregimtari Budin Budini, edhe ky rreth 100 vjeçar, nga fshati Klenjë, në intervistën që i mora në vitin 1972, na tha.." Këto materiale janë përdorur nga autori në vitin 1999 në librin: "Gollobordasit e Dibrës" Duke i vënë përballë studiuesve të ndryshëm, e kështu ai nxorri përfundime te veçanta sipas temave te trajtara. Po në këtë libër, historishkruesi shfrytezon nga arshiva e tijë "Intervistë e marre ne vitin 1956 nga Adem Ahmet Muça, vjeç 80 nga fshati Ostren i Madh. I prirur për të bërë një punim serioz, për të zbuluar në thengjijtë e fikur të viteve nga të mos shkruarit apo mosmbajtjes të dokumentacioneve të natyrave të ndryshme, ai shfrytëzon "Laboratorët biologjik" mundësisht deshmitar të ngjarjeve, ose shumë më pranë në kohë ndodhjen.

Në përpjekjet e tijë sistematike në mbledhjen e materialeve në terren, ai perveçse kontaktit drejtëpëdrejtë duke e shkruar vetë intervistuesin, ai jo vetëm që shprehet me sinçeritet për gjithëçka qe mbledh por prapë se prap ai ka besim më shume te matreiali i shkruar psh: " Të dhëna në formë kujtimesh nga bashkë biseduesi Zeqir Hasan Shahinaj, nga fshati Trebisht-Muçin, vjeç 90, intervistë e vitit 1972. Materialin e ruan intervistuesi." Apo një tjetër shembull: Vahid Kornaku , nga fshati Stebleve, hulmutues i etnografisë dhe historise së Gollobordës, vdekur në vitin 1946. Jemi sherbyer me disa skeda të tijë, që na kanë rënë në dorë shumë vite përpara."

Dhe më tej rastësia e dërgon atë në zbulime më shumë të besueshme tek shkencëtarët e kohës per origjinën e tyre dhe zgjidhje të natyrave të ndryshme, në kerkimet historike, Profeor Musatafa Demiraj më thotë:. Origjina e familjes time, Demiraj , më sa me ka thënë babai, paska qenë nga fshati Jabllanicë i Gollobordës." Dhe ja befasia tjetër dhe këmbëngulja e tijë për të zbuluar rrënjët e së vërtetës:

"Në përpjekjet tona, për një trajtim sa më



të thelluar, iu drejtuam gjuhëtarit tonë të mirënjohur z. Xhevat Lloshit, me origjinë stërgjyshore nga fshati Zabzun i Gollobordes..."

Kumtesat e mbajtura në dhjetra konferenca, artikujt e panumërt të shkruara, librat e krijuara e të përkthyera përbëjnë fondin më të pasur e më të domosdoshëm për historinë e kulturën dibrane dhe më gjërë dhe ato kanë në formë e permbajtje metodën në të cilën: "Rrethi mbyllet: nga dokumentat, materiali arkeologjik në historinë e shkruar, nga historia tek filiologjia gjithmonë me drejtësi e korrektesë, dhe udhëtim drejt jetës e cila duhet të kërkohet dhe gjëndet tek dokumentat, objektet e arkeologjike, e përsëri ne histori, filiologji për të bërë një gjykim kritikë për të depërtuar në thelbin e ngjarjeve, të cilat janë të nevojshme për të zbuluar ligjësitë e zhvillimit të veprimtarisë historiko shoqërore" Kështu shprehet historiani italian Hektor Lepore. E tillë është në substancë e gjithë vepra e historianit Sadikaj. Një shembuli vyer për brezat e rinj të historianëve, etnografëve, gjeografëve, e studiuesve të fushave të ndryshme të shkencave.

### THASËT E LIDHUN

Në një bisedë me ish regjizorin Skënder Cala në librarinë e tijë në Tiranë rruga "Gjergj Fishta" kur i thashë së kërkoja librin e fundit të historianit Hilmi Sadikaj, ai u mendua paksa dhe librashitësi i aposionuar me tha se do të bisedoi me djalin e tijë Avniun. Folëm mbi kumtesat e tijë në dorëshkrim dhe kërkesa ime për disa prej tyre. Nuk vonoi dy ose tre ditë dhe me telefonon, ku më shpejgoi se në shtëpine e tijë janë shumë libra të tijë dhe disa thasë me shkrimet e intervista të ndryshme. Dhe ai vazhdon se i propozova qe ti sistemoja unë dhe më pas ti dërgonim në ndonjë biblioteke ose muze. Sakaq më erdhi ndërmend një titull apo mendim i shkruar " Dijenitë e burgosura"

A nuk i ngjajnë këto thasë, mollës së ndalueme, apo nje kopshti prodhimet e të cilit kalben, bimë që vyshken, pra nuk i shërbejnë askujt e vetë kopshtari është robtuar duke i mbjellur rritur e shërbyer me merak e dashuri të madhe. Më se e vërtetë. Në librin e fundit historiani i shquar Sadikaj do të shkruante: "..kam vlerësuar edhe aspiratate studiuesve

## MATERIALE TË SHKRUARA NGA HILMI SADIKU


1. Kontribut për hartën arkeologjike të rrethit të Dibrës. Në: "Buletini Arkeologjik" Tirane 1971. f. 220-224.
2. Përpjekje për lokalizimin e disa kështjellave dhe qytezave Ilire të Penestëve. Në: "Ilirët dhe gjeneza e shqiptarev e " Tiranë 1969. f. 255-256.
3. Një stemë 700 vjeçare e një familje Arbërore. Në: "Ushtima e maleve" 24.08.1991. f.7
4. Një veshtrim mbi traditate zonës së fshatit të bashkuar Kastriot. "Kumtesë e mbajtur ne sesionin shkencor me rastin e 55 vjetorit të Internatit Dibra, 7 Mars 199. (Doreshkrim )
5. Skënderbeu në gojën e popullit të Dibrës. Në: "Konferenca e dytë e studimeve Albanologjike" Tiranë 1968. f. 511-516.
6. Mbi origjinën e Kastriotëve. Kumtesë e mbajtur në Konferencën e Kulturës Popullore të rrethit të Dibrës. Peshkopi 1976. (Doreshkrim)
7. Tradita dibrane ne gdhendjen e drurit. Në "Etnografia shqiptare" Nr.IX. 1978 f.363. (Me bashkëautor B. Mataj)
8. Një tjetër kala ne Diber që lidhet me Skënderbeun. Në Almanak. "Dibra". 1969 f. 205-207. (Me bashkëautor N.Plaku)
10. Dibra dhe vendi i sajë në arealin Arbër. Në: Simpozium i Dibrës së Madhe, në Nëntor 1993 vëll. I. f. 19-21.
11. Dibra si krahinë e provincës së Arbërisë. "Ushtima e Maleve" n. 45, Data 8.Nëndor. 1990
12. Rreth përkatësisë etnike të Vojsava Tribaldës "Kastriotit" Në: "Dibra dhe etnokultura" f. 127-134. Vol . I. Dibër 1995
13. Kalaja e Skënderbeut (e Qidhnës) në Dibër. Në: Almanak '' Dibra " 1969 f. 199-201. (me bashkëautor Myslim Koka)
14. Arësimi në gjuhën shqipe dhe çështjet e alfabtit në krahinën e Dibrës. Kumtese Almnak " Dibra" 1969 f. 161-168
15. Mbi lokalizimine disa betejave të Skëndrebeut" Në:"Dibra dhe Dibranët" Shkodër 1985 f.42-48 (Me bashkëautor Selim Alliu)
16. Disa mendime të mija rreth kapitullit të J.S Jasterbov te titulluar "Skanderbeg" Si dhë përkthim i pjesshëm: " Serbia e vjetër dhe Shqipëria, "Shënime udhëtimi" Beograd 194." Muzeu historik Peshkopi. Doreshkrim
17. Organizim shoqëror i Dibrës gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX. Në: Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizerenit 1878-1881 vëll. II 12-28 Qërrshor 1978. f.181.
18. Qendresa ndaj pushtimit bullgar në Dibër , gjatë luftës së Parë Botërore 1915-1918. Në:"Dibra dhe etnokultura e saje" vëll. II. f. 314. Dibër 1995
19. Vendosja e kufirit të vitit 1913. Kumtesa u lexua në sesioni shkencor organizuar nga Muzeu Historik Dibër. Doreshkrim.
20. Rruga Strugë Dibër, përpra çarjes së trasesë ne zonën e Manastirecit të Terbishtit, gjatë vitit 1908. Kumtesa u lexua në sesionin shkencor të organizuar nga Muzeu Historik Dibër. Doreshkrim.
21. Rektifikimi i kufirit shqiptaro-serb në Dibër në vitin 1922. Kumtesë. Doreshkrim
22. Dy gjuhësia në disa fshatra të Gollobordës, përftuar nga gjuhet në kontakt. Kumtesë në Sesionin Shkencorte mbajtur në Peshkopi më 7 Dhjetor 1983. Doreshkrim.
23. Disa faktorë që kanë ndikuar për gjuhësine në Gollobordë. Në: Gazeta "Bulqiza" Tetor- Dhjetor 1992.
24. Rreth tezës së origjinëstë Kastriotëve nga Hasi. Gazeta: "Ushtima e Maleve" 22 Nentor 1986
25. Gollobordasit e Dibrës. ( Vështrim etnokulturor) Shtypshkronja Marin Barleti. Dhjetor 1999.
26. Riza Doda ra për atdheun. "Ushtima e Maleve." 15. Mars 1969.
27. Rreth toponimisë së zonave Muhërr dhe Ujë-Mujë të Dibrës" Sesion shkencor në Fakultetin e Gjuhë –Letërsise. Janar 1981.

portret

gollobordas, pasardhës të mi, kontributet hulmutuese të të cilëve me ndihmuan mjaft dhe që në kohë të përshtatshme shpresoi edhe ti publikoj si kontribut të autorëve, të cilëve fatkeqësisht u mbetën në dorëshkrim apo skicime." Dëshira e tijë, shpirtëgjëresia, vlerësimi i punës së bashkëkrahinasve të tijë, rëndësia e madhe e botimit të këtyre materiale per te cilat Sadikaj shprehet u bënë shkrumb e hi me vdekjen e tijë në vitin e parë të shekullit të njëzetë e njëtë.

Çfarë ka në këto thasë të lidhur fort me gjalmë, e të vendosur në në një qoshe të apartamentit të djalit të tijë Avniut? E burgosur, puna dyzetë vjeçare, kërkimore shkencore në fushën e historrisë, etnografisë e veprimtarisë ekonomike e politike e popullit Dibranë, dorëshkrime që i ka punuar me dashuri e pasion të madh, me netë pagjumë e me lodhje të madhe të trurit, ky historian, kopjet e artikujve të tije botuar ne organet e shtypit si: "Ushtima e maleve"''Dibra" "Bulqiza" "Kultura popullore" "Dibra dhe dibranët" "Dibra dhe etnokultura e saj" Almanakët "Dibra" etj

Ndërsa nga ana tjetër e medaljes ndodh që me dhjetëra kërkues, studentë për të shkruar temat e diplomave, pedagogë etj për të mbrojtur disertacionet, studies, gazetar që kërkojnë të shkruajnë një artikull një libër apo mësues të historisë që duan të zgjerojnë leksionet per ti dhënë para nxënësve apo auditore universitare.

Shënime mbi gjetjet arkeologjike, bisedat e ndryshme të kryera në të gjithë fshatrat e rrethit Dibër, me tregimtarë të shumtë, psh vetëm në gjashtë faqe artikull shkencor, mbi ''Skënderbeu në gojën e popullit të Dibrës." janë përmendur shtatëmbëdhjetë njerëz nga vende të ndryshme duke perfshire gjithë gjeografine e Dibrës. Nuk është e veshtire të nxjerrim përfundimin se thasët ku jane "burgsur" bisedat e qindra tregimtarëve, kumtesat, artikujt, përkthimet e shënime të çfarëdolloji janë me vlera të pallogaritshme për historine e trevës sonë dhe ribërja e tyre është absolutisht e parealizueshme.

Prandaj kush ka kapitale të mundshme, qoftë gollobordas apo muhurrak, selishtas apo bulqizakë, shumbatas apo lurjanë, maqellaras apo kastriotas të investojnë për pregatitjen dhe botimin e tyre në forme librash të të gjithë kësaj pasurie me vlera të pallogaritshme për të njohur të kaluarën e dibranëve, mbushur me bëma historike të panumrueshme. Një mënyrë tjetër,mund të rekomandojmë që kumtasat në dorëshkrim mund të botohen dora dorës ne gazetat ''Rruga e Arberit " "Dibra" etj.

Lypset vullneti i mirë, organizimi i detajuar edhe mundësia për të botuar edhe materiale të njerëzve të penes e kulturës së trojeve dibrane, që edhe ato do të mbeten në altarin e historisë të sajë si pishtarë të pashuar që kanë ndezur lokomotivën e dijes për të ndriçuar kohërat që nga pellazgët, antikitetin, rilindjen e deri në luftrat e Pare dhe dytë Botërore.

Së fund a kemi arritur të përfundojmë kalanë e njohjes per një historian të shquar si Hilmi Sadiakaj ? Mendojmë që sa e kemi filluar, per me tej kërkojmë ndimën e bashkëpunëtorëve te tijë si Shkrimtarit Xhafer Martini e Naim Plaku, Historianëve Moisi Murrja e Iliaz Kaca, Bibliotekarit Ulvi Shehu, Profesorëve Adem Bunguri, Shaban Sinani, Hajri Shehu e qindra të tjerëve që kanë bashkepunuar me atë dhe sëbashku si një kor i vetëm t'i propozojmë Bashkisë të Qyteit Peshkopi: "Që Muzeut të rrethit të Dibrës ti vendosim emrin Hilmi Sadikaj.

Si mbyllje mblodhëm disa nga titujt e krijimeve të historianit Dibranë Hilmi Sadikaj, janë si lulet erë këndshme në kopshtin e dijeve. Natyrisht që ka nevojë për shtesa të tjera.

*Firence 26.11. 2011*

# Brahim Gjoçi, shqiponja e Lurës kreshnike

## *Mes bashkëluftëtarëve më me zë të Elez Isufit, Brahim Gjoçi është ndër kryesorët*

*Nga* **Rremzi NDREU**

Krah Elez Isufit, figura e Brahim Gjoçit, bëri emër që i kaloi kufijtë ë Lurës. Ai u bë i njohur në Dibër e Lurë, Mirditë e Tiranë, Shkodër e deri në Kosovë. Lufta dhe përpjekjet e tij për Shqipërinë e bënë të njohur me figura të shquara të kombit si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Mustafa Kruja, Ramiz Daci dhe dhjetëra të tjerë që u dha besën dhe mbeti besnik me idealet e tyre

Krejt Lura, një bastion malor, mes masivit të pyjeve të Lurës, një hap nga Mirdita e paprekur nga invazionet e huaja, e kishte ruajtur të pastër lirinë dhe të pa prekura zakonet e urta, besën e bujarinë e Bajrakut të Lurës. Në këtë kreshtë malesh "ku ditët janë të shkurtra dhe me re, lindën burra që nuk u dhimbset jeta".

Po kështu lindën burra që bën emër jo për vete po për Lurën, për Dibrën dhe për gjithë Shqipërinë.

Në këtë katund të vogël, por me emër të madh, rreth viteve 1849, lindi Brahim Gjoçi. Vinte nga një familje e nderuar dhe me traditë të fortë, që ishte shquar gjithmonë si liridhashëse dhe atdhetare. Brahimi u rrit me këtë frymë dhe u burrërua mes këtyre maleve.

Brahim Gjoçi, siç u thirr gjithë jetën, ishte lurasi tipik, me një fisnikëri të rrallë, me një shpirt të madh dhe buajr, me një mendje të kthjellët dhe me një guxim të pashoq. Shumë shpejt nisi të shquhej në kuvendet e burrave për këto cilësi të rralla që në vitet e mëvonshme formuan te Brahim Gjoçi prijësin e denjë dhe luftëtarin e guximshëm, në ngjarjet e mëdha për t'i dalë në krah Shqipërisë.

Lidhja e Brahim Gjoçit me Elez Isufin, veç marrëdhënieve të hershme gjaku, bazohej edhe me idealet për çështjen kombëtare. Ata mbetën në krah të njëri-tjetrit në ato vite të stuhishme të mbijetesës së Shqipërisë. Ndër bashkëluftëtarët më me zë të Elez Isufit, Brahim Gjoçi është ndër kryesorët. Disa vargje të poetit japin më qartë imazhin e këtij unioni: " Lurë, moj, hape derën/zemrën sot ta mbushi/ t'ka ardhë në konak/ trimi Elez Isufi" apo: "Brahim Gjoçi mor ku je/të shkrep syri dritë rrufe/ Dil, o Brahim Gjoçi/ lesho një vikamë/ Dhe shih sip o të vine/ të gjithë mallet pranë.(x2)"

Krah Elez Isufit, figura e Brahim Gjoçit, bëri emër që i kaloi kufijtë e Lurës. Ai u bë i njohur në Dibër e Lurë, Mirditë e Tiranë, Shkodër e deri në Kosovë. Lufta dhe përpjekjet e tij për Shqipërinë e bënë të njohur me figura të shquara të kombit si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Mustafa Kruja, Ramiz Daci dhe dhjetëra të tjerë që u dha besën dhe mbeti besnik me idealet e tyre.

Në vitet e stuhishme që erdhën për kombin, Brahim Gjoçi, në krye të lurasve ishte në qendër të ngjarjeve të mëdha për t'i dalë zot Shqipërise. Në kryengritjen e vitit 1992, ai u shqua si kapedan trim, ku mori pjesë dhe në pagëzimin e parë. Që nga kjo ai, inkuadrohet krah Elez Isufit dhe do të jetë i pranishëm e aktiv në kryengritjet kundra serbëve, të viteve 1913, 1918, 1920-1921 dhe pa u ndarë deri në fund. Veçanërisht Brahimi shquhet në luftën e Lurës.

Brahim Gjoçi, ka një jetë të pasur dhe të pastër. Duke e ndjekur në ngjarjet e rëndësishme historike, ku ai mori pjesë, figura e tij na shfaqet me përmasat e një atdhetari dhe politikani të guximshëm. Kronikat e atyre viteve, shkruajnë me respekt dhe admirim për të.

Ofensiva e egër serbe në vitet 1992, mbi Dibër e më gjërë, u shkallëzua dhe me kryengritjen e Mirditës. Rreziku që i kanosej shtetit shqiptar ishte tepër i madh dhe me pasoja për fatin e vendit. Elez Isufii kishte paraprirë këtij rreziku dhe i pati kërkuar qeverisë së Tiranës që në Lurë, si një pikë strategjike të dislokohej një qendër ushtarake. Kur ngjarjet e Mirditës dolën në rendin e ditës "...provoi se Elez Isufi me parashikimin që bëni për të përqendrue një fuqi në Lurë,..... kishte parashikue gjëndjen dhe kishte qenë i zoti të zbulojë të nesërmen"

Ngjarjet e Mirditës 1921, ishin një krijim i rrezikshëm i serbëve në përçarjen e shqiptarëve. Për të shuar këtë zjarr të rrezikshëm, Tirana ngarkon Elez Isufin të hyjë në marrëveshje me kapedanin e Mirditës për të filluar bisedimet. Elez Isufi ngarkoi Brahim Gjoçin si ndërmjetës, që të hynte në fjalë me krerët e Mirditës për kohën e takimit, vendin dhe kushtet e tyre. U ra dakort që takimi të bëhej në kullën e Mardhocit.

Rrugës për në Lurë, Elezit i erdhi fjala se një ushtri e madhe serbe e mercenare të prirë nga Halit Lleshi, kaloi Drinin dhe po i ngjitet Lurës, ta shtrojë atë dhe të kalojë në Mirditë për të shpëtuar republikën marionete, këtë vegël "serbe". Kapedani i Mirditës i inkurajuar nga kjo ushtri, e luan fjalën dhe nëpërmjet Braim Gjoçit, refuzon takimin e planifikuar me Elezin te kulla e Mardhocit.

Pjesëmarrës në atë ngjarje, Ismail Strazmiri, na jep një tablo reale të atyre episodeve luftarake. Më 30 korrik 1921, "qeveria serbe, kish përgatitur kryengritjen e Mirditës, me qëllim që t'u ndihmojë dhe t'u japi kurajë mirditasve, nisi për atje një fuqi prej 1000 vetësh nën komandën e Halil Lleshit, Tafë Kazis e Selim Nokës ....."

Në vendin e quajtur "Kroi i Gëlqeres" nji grusht dërnjanë me në krye Dik Xhelilin e Misin Ahmetin, u dha betejë forcave serbe. Lufta u ndez ashpër ..... U dha alarmi në Reç, Dardhë e Lurë. Nuk vonoi erdhi Sheh Halimi me reçianë, Brahim Gjoçi me luras dhe kapiten Jaku me repartin e tij.

Beteja te "Kroi i Gëlqeres" është një nga luftërat më të ashpëra dhe më të përgjakshmë", ku serbët dhe mecenarët e tyre u thyen dhe u mundën keq dhe në panik të plotë, u tërhoqën përtej Drinit. Malësorët e Reçit, Dardhës, Lurës dhe njësia ushtarake, në këto luftime, treguan një heroizëm të rrallë që influencoi në ndryshimin e raporteve të luftimeve të shoqëruara me sulme në gjithë vijën e mbrojtjes. Lana e Lurës, ku Elez Isufi kishte shtabin e përgjithshëm të operacioneve ushtarake mbeti një kala e paprekur e lirisë dhe qëndresës.

Mbas kësaj disfate, serbët vunë në lëvizje trupat e rregullta dhe sulmuan vijën mbrojtëse në shumë drejtime. Kjo bëri që të influencojë edhe të ashtuquajtur Republika e Mirditës, e cila kërkonte një shteg për t'u bashkuar me forcat serbe. Duke vlerësuar këtë rrezik "qeveria çon një fuqi të komandueme nga Sufë Xhelili, Murat Kaloshi, Osman Lita, Brahim Gjoçi dhe komandant Ali Riza Topallin. Kjo fuqi, mësyri dhe me trimërinë që tregoi u fut në Orosh nga ana e Selitës.

Në këtë mënyrë, kryengritja e Mirditës u shua dhe bashkë me të dhe Republika marionete e Mirditës, kjo pjellë e keqe e armiqve të Shqipërisë dhe kryesisht e serbëve, ra menjëherë dhe Mirdita u bashkua me qeverinë e Tiranës.

Lufta e Lurës, një nga faqet më të lavdishme të historisë shqiptare shënon dhe fundin e okupimit serb, ne Dibër, zë shumë pak vend në historinë e shkruar të Shqipërisë. Ajo qe një luftë e përgjakshme dhe e pabarabartë kundra egërsisë serbe. Heroizmi dibran dhe në veçanti Reçi, Dardha dhe Lura, që mbajtën peshën kryesore, u ballafaquan me këtë luftë jo vetëm me një ushtri të rregullt, të armatosur deri në dhëmbë dhe shumë herë më të madhe në numër, por u detyruan të përballojnë edhe urinë, të ftohtin dhe mungesën e armatimit dhe municionit.

Konkluzionet e kësaj lufte i jep me një sintezë të hallësishme Elez Isufi nga Lama e Kolecit në letrën e dërguar deputetit të Dibrës, Z. Kristo Dakës, që mban datën 13 nëntor 1921. Në vlerësimin që u bëhet prijësave popullorë që udhëhoqën këtë luftë, emri i Brahim Gjoçit mori gradën e kapitenit.

Kjo luftë frymëzoi mësuesin patriot Haki Sharofi të thurë atë këngë që në ato vite u bë kushtrimi i lirisë: "Drin o lum i gjanë, plaku i malësisë/ A ke me ja lanë Dibrën, Serbisë?/..... Lurë o



vend i nalt, vend i trimërisë/ Atje u lind fjala, besa e lirisë ....."

Po Dibra i mbeti Shqipërisë, në saj të heroizmit dhe vetmohimit të malësorëve dibranë. Në këtë epos, Brahim Gjoçi ka pjesën e vet si luras dhe kapedan kreshnik.

Kur Shqipëria i siguroi kufijtë e vitit 1913, e gjithë vëmendja u kthye drejt Tiranës, ku po bëheshin përpjekje për konsolidimin e shtetit shqiptar. Elez Isufi, Bajram Curri që kishin dhënë gjithçka për të bërë Shqipërinë, ndiqnin me shqetësim debatet në Parlamentin e parë shqiptar, ku rivaliteti politik i ndezi ashpër. Ishte thirrja e një grupi deputetësh, përparimtarë, progresist dhe patriot, drejtuar Elez Isufit, midis të tjerëve dhe Brahim Gjoçi, që plaku akoma pa u ftohur grykët e pushkëvë të nisej për Tiranë. Kështu lindi Lëvizja e Marsit 1922, si një nevojë e krijimit të një shteti demokratik dhe përparimtar.

Krahas Elez Isufit si gjithmonë ishte dhe Brahim Gjoçi që mbështeti këtë lëvizje. Edhe marshimi për Tiranë, nisi pikërisht nga Lura e Brahim Gjoçit, i cili dha një kontribut të mirë në atë marshim tepër të rrezikshëm.

Sulmi mbi Tiranën ishte i rrufeshëm. Brahim Gjoçi, krahas Sufë Xhelilit ishte në ballë të luftës. Një plumb e merr trimin në gjoks, por ai nuk bie. Këtij akti, rapsodi i këndon: "Brahim Gjoçi një djal' i ri/ i ra plumbi m'u në gji/M'u në gji e n'xhamadan/po u thot shokëve nuk kam gja".

No coment! Brahim Gjoçi, si një demokrat i natyrshëm që mori pjesë në Lëvizjen e Marsit, mbështeti dhe mbrojti Revolucionin e Qershorit 1924, si një atdhetar i flaktë dhe një politikan demokrat, që e deshi Shqipërinë të fortë e përparimtare.

Vitet që erdhën, ky luras i urtë dhe i mençur, mbeti në Lurën e tij një burrë i nderuar dhe i respektuar, gjithmonë syçelë dhe me pushkën të ngrehur apo me peshën e fjalës së tij, kurdo që do ta thërriste Shqipëria.

Kur ngjitesh në Lanë të Lurës dhe mahnitesh me ato bukuri të rralla që Zoti krijoi, sjell ndërmend që pikërisht kjo perlë e rrallë e natyrës shqiptare, ka qenë bastoni i lirisë dhe qëndresës heroike dhe ndjen se mungon diçka. Po, mungon përpjestimi i atij akti të madh të shkrirë në një përmendore si simboli më i bukur, i lirisë, qëndresës dhe atdhedashurisë. Emri i Brahim Gjoçit meriton të jetë në ballë të kësaj përmendoreje!

**EPILOGU:**

Krej Lurë 1946! Operacioni i egër i brigadës së ndjekjes, kishte lënë gjurmë makabre në familjen e madhe të Brahim Gjoçit. Kullat e djegura, familja e internuar në kalanë e Beratit dhe burrat e dergjur burgjeve, jo pak, por tamam një skuadër ..... Në vitet që erdhën, lufta e klasave, kjo shpifje e egër, solli shpërbërjen e kësaj familje të madhe në Lurë.

Shikimi i tij prej shqiponje ishte venitur. Verbëria i kishte marrë atë pamje të pastër dhe të kulluar si liqejt e Lurës, ku dikur pasqyrohej në to, shpirti i madh bujar i këtij malësori tipik, i kësaj shqiponje të maleve të Lurës. I vrarë në shpirt, por mbahej: qëndronte aty ball oxhakut si një copë shkëmbi që kishte nisur të ronitej.

Disa vite më vonë, kur lexova "Koloneli Shabër" m'u kujtua Brahim Gjoçi. Kishin një ngjasi të çuditshme, kishin njohur lavdinë e fituar me gjak dhe mjerim e imponuar me dhunë. E megjithatë, ky burrë që më kishte lënë mbresa të forta që më kujtonin gjithmonë shqiponjën e maleve të Lurës.

Vdiq në mjerim në vitin 1954.

Rruga e Arbërit nr. 72
botime

**“Tue punue të gjithë së bashku sot, nesër do të nxjerrim atë libër të shenjtë... që vendi ynë të njihet në lamin shkencor, kulturor e historik... Ndërkaq për këtë barrë, që po marr përsipër due t’i përshkruej gjeografikisht dhe t’i shënoj në hartën kombëtare vendet e panjoftun deri më sot... këtu e pesë shekuj më parë, në këtë vende, duel nga ngadhënjimtar (kryetrimi i Arbërisë Gjergj Kastrioti) përballë fuqisë më të madhe e ushtarake otomane.**

# Profesor Vahid Kormaku “Stebleva” dhe mesazhet e tij

Nga: **VELO CFARKU**

## PREZANTIMI

**Me datën 14 prill 2012 , ora 11 shoqata “Stebleva”, në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së shkencave bëri promovimin e librit me titull”Sheshet e betejat e Skënderbeut në dritë të realitetit”, me autor steblevasin e njohur Vahid Kormaku dhe botuar nga shtëpia botuese “M&B”. Kryetari i shoqatës “Stebleva” zoti Mersim Hoxha i cili ishte dhe vetë moderator i këtij aktiviteti pasi përshëndeti të pranishmit, në fillim ia dha fjalën redaktorit të librit, historianit Moisi Murra i cili në fjalën e tij, pasi bëri një analizë të librit foli shkurt dhe rreth jetës së autorit. Këtë libër autori si dorëshkrim e ka përfunduar në vitin 1946, një vit para se të vdiste, tha në fjalën e tij Moisi Murra.Nga 24 beteja të Skënderbeut, 19 janë zhvilluar në Dibër, dhe për këtë autori argumenton me fakte bindëse për vendndodhjen e tyre. Në fjalën e tij Petrit Basha nga Tunja e Gramshit ndër të tjera tha:-Ju sjell ju dhe familjes së Vahid Kormakut përshëndetje nga komuniteti i Tunjës dhe vetë komuna. Unë kam qenë drejtor në shkollën e Tunjës, pikërisht në atë shkollë të cilën e ka hapur për herë të parë Vahid Kormaku, në atë shkollë ku ka punuar si mësues dhe vetë Vahidi dhe ndaj populli i Tunjës i është mirënjohës atij burri të mirë, ati intelektuali, atij arsimdashësi, atij studiuesi. Më gjatë, më shumë me argumenta shkencore, vetëm për jetën dhe veprën e Vahid Kormakut foli kryetari i shoqatës së Gollobordës, studiuesi Ramazan Hoxha. Regjizorja Nadire Murra në fjalën e saj tha:”Vahid Kormaku nuk i përket vetëm Steblevës, vetëm Golobordës, vetëm Dibrës.Ai i përket Shqipërisë. E veçanta e tij është se i pëlqente kur e thërrisnin me mbiemrin Stebleva, në emër të vendlindjes, dhe ky mbiemër i mbeti e kështu dhe sot një shkollë në Elbasan mban emrin “Vahid Stebleva”.Në librin e tij , ai tregon se kryeqyteti i lashtë i shqiptarëve, ndodhej në Jabllanicë. Ai shtjellon me fakte dhe dokumenta historike, se Drimkollasit dhe gollobordasit janë albanët, pas ardhësit e ilirëve, që më vonë u quajtën Arbëni.Pra Albanopolisi duhet vendosur prej Dibrës deri në Drinin e Zi. Ai na tregon për tempullin e Dianës të vendosur Albanapolis, pra në Jabllanicë të Drinkollit të Dibrës. Diana, hyjnesha e pyllit dhe kafshëve të egra, e cila u quajt kështu me emrin latin Diana nga romakët. Për këto e të tjera si këto studime me vlera të mëdha, vazhdoi në fjalën e saj Nadire Murra, mendoi se studiuesi dhe historiani Vahid Kormaku duhet dekoruar nga Presidenti i Republikës. Ai ishte dhe mbeti njeri i madh. Velo Cfarku në fjalën e tij tregoi për jetën e Vahidit kur ishte mësues në fshatrat e Gollobordës, foli pastaj për rëndësinë e këtij libri të sapo botuar. Duhet vlerësuar kontributi i tij në lëmin e studimeve, vazhdoi më poshtë Veloja dhe kur këto shënime që sot ne i kemi të botuar në libër janë mbajtur pikërisht në vitin 1946. Në fund përshëndeti të pranishmit nipi i Vahid Kormaku, Vahidi i ri i cili përgëzoi të pranishmit për këtë pjesmarje.Në fund u shpërnda falas për të gjithë të pranishmit libri falas si dhe u dha një koktej i pasur.**




Vahid Kormaku “Stebleva” si mësues e studiues shumëplanesh është një figurë e shquar e arsimit dhe kulturës. Ai para së gjithash ka qenë një mësues i talentuar, studiues e historian me zë, biolog, etnograf, arkeolog dhe gjuhëtar poliglot.

Jeta e shkurtër 52-vjeçare e Prof. Vahid Kormakut (vdekur më 27 dhjetor 1946) është mbushur me një veprimtari të dendur shkencore. Ai la si trashëgimi veç mirënjohjes të ish-nxënësit e kolegët e tij dhe pasuri (në dorëshkrim) materialesh shumë të vlefshëm për historinë, gjuhësinë, etnokulturën, arkeologjinë, florën e trevës së Gollobordës.

Parë në retrospektivë erudicionin e mësues Vahid Kormakut të mahnit. Dhe shtrohet pyetja. Si është e mundur të arrijë në maja kaq të larta dijesh në studimet, përkthimet dhe precizitet e vendbetejave të Skënderbeut në religjionin e Gollobordës, Drinkollit të Dibrës, Strugës dhe Koxhaxhikut? Veç një mendjendritur, një shkencëtar brilant i kompletuar për kohën mund të ishte kaq i suksesshëm, këmbëngulës e kompetent për t’i dalë mbanë objektivit të vënë.

Profesori ynë Vahid Kormaku i pajisur me një bagazh të pasur në lëmë speciale shkencash, falë zotërimit të gjuhëve orientale (arabisht, persisht, osmanishte); gjuhëve sllave (bullgarisht, serbo-kroatisht, maqedonisht); gjuhëve neolatine (italisht, greqisht, gjermanisht) në këndvështrimin, e them me sinqeritet, sot të gjithëve “Na vë me shpatulla për muri”.

Për të kuptuar më qartazi figurën shumëplanëshe të studiuesit Vahid Kormaku. Këtij eruditi e poligloti të paarritshëm për kohën, çdokush do të bindet duke lexuar me vëmendje këtë libër “Monument” të sapo dalë në qarkullim. “Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritë të realitetit”, promovimin e të cilit që po bëhet sot në “mjediset e Akademisë së Shkencave, nën moderimin e Moisi Murrës, historian me zë i Dibrës, redaktor shkencor i librit të autorit Vahid Kormaku. Ky libër është shumë i nevojshëm e i rëndësishëm për historian e historianët, jo vetëm të Gollobordës e Dibrës, por edhe më gjerë, në shkallë kombëtare.

Libri në fjalë i shkruar në maj të vitit 1946 (në vendlindjen e autorit Steblevë-Klenjë) publikohet për herë të parë, pas rreth 70 vjetësh sipas dorëshkrimit origjinal të autorit lënë trashëgim familjes, nga nipi i autorit Vahid Gani Kormaku.

Madhështia e figurës së Vahid Kormakut si historian tepër serioz, i guximshëm e i saktë, duket dhe në faktin se ai guxoi të orvatej për t’u ballafaquar e studiuar një problem i hershëm, rreth 5 shekuj të shkuar për vendndodhjen e shesheve të betejave të Skënderbeut, precizimit të këtyre shesheve të betejave, të vendosjes së tyre në harta përkatëse është dhe një përgjegjësi shkencore historike pas Barletiane, Noliane e dhjetëra e qindra studiues pasardhës gjatë pesë shekujve shkruar një “mal” librash për heroin tonë legjendar Skënderbe, e rendit studiuesin tonë Vahid si një nga protagonistët stoik të viteve 20-30 të fillim shekullit të 20-të në fushë të shkencës historike, duke na dhuruar këtë libër “Monument” të historiografisë shqiptare në 100-vjetorin e Pavarësisë dhe 118 vjetorit të lindjes së autorit (1894) është mund të them, një përmendore e stolisur në zemrën e atij që e lexon. Dhe këtë shans na e jep i madhi Vahid këtu pas 70 vjetësh.

Vepra tërësore shumëdimensionale e Vahid Kormakut duhet parë në dy rrafshe.

E para, për “Sheshet e betejave të Skënderbeut në dritë të realitetit”. Rezistenca kundërosmane e shqiptarëve të periudhës skënderbeane për të cilën kemi librin të porsa botuar.

E dyta, rezistencën në kushtet neootomanizmit dh epadrejtësive të Fuqive të Mëdha në dëm të shqiptarëve. Thellësia e mendimit të këtij burri kreshnik që kish jetuar të dy kohët: Të “sëmurës” së Bosforit, të luftërave Ballkanike, të shpalljes së shtetit të parë shqiptar, të Luftës së I dhe II Botërore.

Në parantezë: Vahid Kormaku në kohë të çeljes së shkollës Normale të Elbasanit (1 dhjetor 1909) ishte 15 vjeçar, më 28 nëntor 1912 të shpalljes së Pavarësisë, 18 vjeçar. Trazirat historike të kohës para e pas shpalljes së Pavarësisë ushtruan një ndikim të fuqishëm tek adoleshentë Vahid Kormaku, që tashmë kishte fituar pjekurinë e perceptimit e të analizës së ngjarjeve tragjike të kohës, duke forcuar për herë e më shumë ndjenjën e atdhetarizmit.

Ngjarjet tragjike të kohës së Shpalljes së Pavarësisë dhe fillimit të Luftës së Parë Botërore, të kohës së dekompozimit të Perandorisë turke, të padrejtësive të paqëllimshme e të pazarllëqeve të Fuqive të Mëdha që u dhanë përparësi tre shteteve (mbretërive) bullgare, serbe dhe greke, krijuan precedentin më të rrezikshëm të copëtimit e aneksimit grabitqar të qarqeve agresive të shteteve fqinje ndaj trojeve shqiptare.

Kjo gjëmë e kohës rëndoi veçanërisht ndaj trojeve shqiptare e sidomos ndaj Gollobordës që u la si zonë neutral që prej 9 vjetësh (1913 e deri më 1922). Pazarllëqet e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, K.N.K-së, që funksiononte formalisht, u shndërrua në arenë luftërash diplomatike, duke mos dhënë asnjë zgjidhje për kufirin dhe duke e lënë zonën e Gollobordës pre e pushtuesve bullgarë e serbë që shkretuan Gollobordën nga reprezaljet e djegiet masive të fshatrave më 1913, 1915 e 1920, duke grabitur tërë pasurinë e vrarë banorë të pafajshëm të krahinës.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, jehona e saj, veprimtaritë luftarake të pandërprera në prag të shpalljes së Pavarësisë e në vijim sensibilizuan e ndihmuan fuqishëm e gjetën përkrahje të plotë të patriotëve dibranë e gollobordas. Renditja e tyre në krahë të rilindësve ishte në rrugën e duhur. Në kongresin e Dibrës të 22-28 korrik 1908, krahas 200 delegatëve të hapësirës Perëndimore Ballkanike morën pjesë Mehemt Alia e Arif Krusha nga Gora, Murat Selimi (Serpetova), Aziz Lila nga Golloborda (Stebleva) e të tjerë. Në krahë të tyre u rendit dhe Dom Nikollë Kaçorri.

Mbas debatesh disa ditëshe e polemikash të ashpra që çuan në mospajtim, më së paku u arrit që të zhvillohej arsimi në gjuhën shqipe. Pavarësisht politikës kundërshtuese të Xhonturqve e të serbëve kundër shqiptarëve fitoi në nënkomisionin lobi për hapjen e gjuhës shqipe. Në këtë situatë patriotët rilindës si Seit Najdeni, Haki Sharofi, Ramis Qatja, Elez Ibrahimi Pupuleku, Jashar Erebara, Josif Bageri, Hasan Moglica, Hazis Lila, Shaban Ostreni Karaibrahimi, Hamit Muça i Ostrenit të Madh, Vahid Kormaku (Stebleva), Mustafa Shahinaj, Islam Hoxha, Mehmet Çadri, Hilmi Sadikaj, Cvetan Zorba (Steblevë), Idris Biba, Selman Koçi i Okshtunit, Gafur Karaibrahimi e të tjerë, janë pasues të denjë të rilindësve, pishtarë të dijes e kulturës, janë mësuesit e parë të pas shpalljes së Pavarësisë dhe dy Luftërave Botërore.

Së fundi, duke studiuar librin e Profesor Vahid Kormakut na jep mjaft mesazhe me vlerë aktuale.

- Modestia. Në parathënien dorëshkrim faksimile thotë: “Nuk due të them se jam një shkrimtar ose historian i madh, por të punojmë për të nxjerrë nga errësira shekullore gjithë ato visare të epokave të ndritshme të racës sonë...”.
- Bashkëpunimin, një tjetër mesazh aq i nevojshëm. “Tue punue të gjithë së bashku sot, nesër do të nxjerrim atë libër të shenjtë... që vendi ynë të njihet në lamin shkencor, kulturor e historik... Ndërkaq për këtë barrë, që po marr përsipër due t’i përshkruej gjeografikisht dhe t’i shënoj në hartën kombëtare vendet e panjoftun deri më sot... këtu e pesë shekuj më parë, në këtë vende, duel nga ngadhënjimtar (kryetrimi i Arbërisë Gjergj Kastrioti) përballë fuqisë më të madhe e ushtarake otomane.
- Së treti, mësues Vahidi në këtë botim të tij na jep një leksion të përkryer. Të jemi të saktë, të shprehemi thjeshtë e kuptueshëm, argumentit t’i shkojmë deri në fund. Fraza e tij është e latuar e koncize që si heq qoftë një presje. Te profesor Vahidi shohim një gjuhëtar klasi me një kaligrafi që rrallë e gjen mes nesh. Ai është shembull imitimi nga çdo kush për ekzigjencën në saktësinë e emërtimeve, pra të toponimisë së vendeve, fushave, maleve, të raporteve ndërfetare etj., duke qenë kundërshtar i rreptë ndaj çdo deformimi apo intolerance.

Tek këto e shumë çështje të tjera, që i ka kaluar nën “zdrukthin” e tij, për ne sot na e ka vënë kufirin te thana, siç thotë populli, për të qenë të përgjegjshëm ndaj brezave të ardhshëm, të kujdesshëm ndaj raporteve mohimpohim etj.

Ky është intelektuali, dijetari, biologu, etnografi, arkeologu, historiani emblematik i Gollobordës që i ka vënë që në fillim të shekullit XX brezoren e artë, jo vetëm Gollobordës, por edhe Dibrës tashmë të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë. Ndaj duhet pohuar me plot gojën ndaj tij, shekulli XX është treguar skeptik e tepër i kursyer ku së paku ta kishte shpallur “Mësues i Popullit”, në mos dhe më shumë “Nderi i Qarkut Dibër” apo “Nderi i Kombit”.

E ç’mund të kërkohet më shumë ndaj një intelektuali të këtij rangu?!

**Poetja Nexhi Baushi vjen me një zë të saj në poezi, mjaft origjinale, me një krijimtari interesante e tematikë të gjerë. Poetja ka ditur që unin e saj në shumë poezi ta përgjithësojë në një un-poetik, në një kohështrirje për shumë lexues të çdo moshe.**

# Shënime rreth librit "Kur loton qielli" të poetes Nexhi Baushi

*Nga:* **ILMI DERVISHI**

Edhe poezia me autorë dibranë ka prurjet dhe arritjet e veta sidomos në këto vitet e fundit. Mes tyre mendoj se është një arritje dhe vëllim me poezi "Kur loton qielli" të autores Nexhi Baushi i botuar në fillim të vitit 2012.

Poetja Nexhi Baushi vjen me një zë të saj në poezi, mjaft origjinale, me një krijimtari interesante e tematikë të gjerë. Poetja ka ditur që unin e saj në shumë poezi ta përgjithësojë në një un-poetik, në një kohështrirje për shumë lexues të çdo moshe.

Tematika e poezive në këtë vëllim është e larmishme, me gjetje interesante por edhe me një këndvështrim poetik mjaft interesant origjinal. Këto poezi vijnë nëpërmjet vargut me finesë e me merakun e vendosjes të çdo fjalë në vendin e saj për të thënë diçka, për të dhënë një mesazh.

Në poezinë e saj vjen jehona e Steblevës, me njerëzit e saj të mirë e punëtore, në flladin e pyjeve "...mushkëritë t'i mbush me oksigjen", e poetja me poezinë "Më prit Steblevë". Ka mall, dashuri, krenari për t'i thënë tungjatjeta Raduç, malit kryelart por dhe burrave që bënë epokë në Steblevë që qëndrojnë të pavdekshëm, ashtu si Raduçi si shkëlqimtari Adem Bojaxhi, mendjemprehti Must Baushi, akademikët Islam Lama e Vahid Kormaku e patrioti Haziz Lila, por ka nevojë edhe për shumë gjëra deri sa dhe "... të shuaj ndër krojet e tua etjen".

Në poezinë "Privilegji i jetës", një poezi kushtuar Nënës ndonëse herë bie në vargëzim, në portretizim pozaik, autorja ja ka arritur qëllimit të shprehë dashurinë për nënat në vargjet:

Nëna
I vetmi privilegj në jetë
Më qumështoi dashuri
Që kërkush s'ta jep.

Me vendlindjen e lidh çdo kujtim e bisedë nga prindërit, çdo histori e toponim që poetja e ka hedhur në vargjet e saj te poezia "Atë ditë gjithçka ndrinë" duke kujtuar një festë pagane 6 majin, duke kujtuar ujëvarën në Orvenik, që veç Perëndia ja jep një vendi të bukur gjithë mirësitë por dhe pak nostalgji nga fëmijëria.

Me mjaft frymëzim shkruan për femrën, jo vetëm në vargjet për gjyshen "Dhjetë fjalë të ngrohta", për nënën "Të dish të jetosh jetën" për motrën Senkën te "Vajza dhe trëndafili" por edhe për "...e bukura syzezë e Raduçit", por dhe për "hyneshën e Kallkanit" dhe "drenusha e Dragonit", "Vashëz e Çajrave" deri te poezia e saj "gjerdan i paharruar në zgjimin pranveror".

Përjetimet dhe motivet e dashurisë zënë një vend të dukshëm në krijimtarinë e Nexhit që nga poezia "Dashuria e parë" që i thotë lamtumirë shokut të fëmijërisë, e deri te poezitë "Në tavernën që quhej Vjosë", "E ndjej" Besa dashurore", Jo si dikur".

"Do të dua...
Jo kurrë asnjëherë
Si dikur..."




Vetëm një femër e emancipuar, e kulturuar dhe me shpirt poetik, që e njeh deri në imtësi shpirtin, butësinë dhe kryeneçësinë brenda asaj krijese hyjnore që quhet grua, e pajisur me dhunti që zotëron aftësinë e di se ç'përfaqëson në vetvete dhe e di ç'kërkon nga bota mashkullore. Këtë e jep me pak detaje dhe në poezinë "Sa pak kërkon një grua", "Pak vëmendje dhe përkëdheli", "një petal trëndafili" që shushurimat t'i kthej në simfoni bethoviane, të zbres yllësitë "në gjoksin e saj – rritësi jete".

Por mund të të thotë dhe një "MOS" që me zë apo pa zë po doli nga shpirti del me një duf që ka dhe stuhinë brenda që rrëzon pemë ëndrrash pa fruta në kopshtin e jetës.

Mos e prek shpirtin
S'ishe i zoti ta qetësosh
Mos e prek trupin
S'ishe i zoti ta pushtosh"
"Mos" f. 41

Një risi në vëllim me poezi "Kur loton qielli" të Nexhi Baushit, që veçon nga vëllimet e botuar këto është se ajo lëvron dhe poemën.

Poema "Dardhë-Shekull" me gjithë uljet dhe ngritjet emocionale gjatë leximit, ka vlerat e saj një bashkëbisedim me Dardhën, një bashkëbisedim me veten me një çiltërsi shpirtërore, që në oborrin e vendlindjes ka mbushur shekulin, ajo është shtatlartë e çdo vit e lulëzuar që përcjell kronikane kujtesën, me një apel për atë çfarë është e domosdoshme sot në ditët tona.

"Është Dardha-Shekull-Sfidante – shkruan Kristaq F. Shabani, e cila apelon kthimin njerëzor pranë saj... Sa dardhë të tilla ka në këto troje të cilat apelojnë".

Libri i shkruar në shqip "Në shqipen time të bukur" – siç thotë poetja në poezinë e saj në f. 71, por disa nga poezitë janë përkthyer edhe në anglisht e italisht që janë dhe për një lexues edhe më të gjerë.

# Kur dashuria për njeriun bashkohet me dashurinë për njerëzimin

***Shënime për librin poetik "Ndizem në akull" të autorit Xhelal Luca***

Nga: **SAKIP CAMI**




Kur lexova vëllimin e parë poetik "Shpirti bredharak", ndonëse poetin Xhelal Luca nuk e njihja, pata një ndjesi të këndshme që ta shkakton poezia që buron nga zemra njerëzore. Tani që lexova edhe vëllimin e dytë poetik me titull "Ndizem në akull" po e kuptoj se tek ky poet dashuria ka përmasa të jashtëzakonshme. Tanimë ajo nuk është vetëm një dashuri për njeriun e zemrës, për të dashurën reale apo virtuale, por dashuri për njeriun e mirë në tërësi, për shqiptarin e mirë, për kosovarin, çamërinë, tetovarin apo shkupjanin, për shqiptarin kudo që ndodhet, që flet shqip dhe që është vëllai ynë.

Autori e quan vehten kalorës të vetëtimave që ka një amanet që nuk e tret dheu. Ky stërnip i Kastriotit dhe Elez Isufit e shpreh kredon e tij patriotike edhe në poezinë "Arbërisht dasmorë": Në strofën e fundit që është në një farë mase dhe kuptimi amaneti i autorit thuhet:

"Lulëkuqe këmishat t'u qep
Kuq e zi përmbi gjoks,
Vetëm atëhere bijtë e mi,
Kur arbërisht dasmorë t'ju shoh,
Lopata e dheut që më hidhet përmbi
Përjetësisht do më ngrohë."

Kjo kredo poetike kombëtare shprehet edhe në poezinë "Dasmorë në Kosovë":

"Ju luta një vashe në Kosovë,
Me shpirt në dorë,
Dua të jem dasmor !
Shqipe kam me ardhë
Me kësulë të bardhë
Krejt serbes
Me dy naganta në brez..."

Dhe më tej po në këtë poezi poeti vazhdon...

"Oooo, Kosovë,
Sa më dhëmbin plagët e tua !
I kam në shpirt,
I kam në kockë,
I kam në thua,
Sa herë me shkja
Je vra
E s'ke qa
Në palë të flamurit
Djemtë të kanë ra"."

Dhe më tej autori i shqetësuar për padrejtësitë shoqërore, për luftën e ashpër për pushtet që nuk kursen as të vrarët e pafajshëm në bulevard vikat ashtu si dikur Migjeni:

Migjeni vikat:
"Ah, sikur të kisha...
Edhe unë sikur të isha...
Po ku të pyesin këto bisha !..."

Autori rrëmon në histori tek të parët e tij heronj realë të luftrave kundër serbve, tek Halil Luca dhe Elez Isufi. Këtu poezia ngjason me këngën popullore epike, me vargun epik të këngëve burrërore dibrane, por prapë se prapë mbetet domethënëse dhe shprehëse në çdo varg:

" Suf Xhelili lyp habere,
Si shkon lufta në Qafë Gëlqere?
Qafë Gëlqerja gropa gropa,
Fort po e rref serbi me topa
Qafë Gëlqerja krisa krisa
Janë ba bashkë Luca e Hysa
Po qëndrojnë në kambë si lisa...."

Në dallim me vëllimin e parë ku në pjesën dërmuese të poezive ishte tema e dashurisë, në këtë vëllim përsëri është e pranishme dashuria, por një dashuri më e madhe, dashuria për atdheun, për kombin, për njeriun, për të dashurën, për njerëzoren në tërësi. Ai është i shqetësuar për akademikun kosovar Ukshin Hoti, fati i të cilit nuk dihet ende ndonëse kanë kaluar 14 vjet nga konflkti në Kosovë. Në poezinë "Vaji i shqiponjës ai shprehet:

" Drithëron bjeshkët një zanë,
Për një trim ajo po qan,
Gurë e dru rruga po i ban,
Blinin në lule po e than,
Ukshin Hoti ku ka mbet',
A është gjallë a ka vdek" ?..."

"Do të vij", është një tjetër poezi patriotike me temë nga Mitrovica e ndarë e gërshetuar me lirizmin dhe dashurinë për vajzën kosovare . Ja si shprehet autori:

"Sa herë
Nxihet qielli në Mitrovicë,
Me ther
Në të majtë njëra sisë
Sa herë
Në Mitrovicë prishet moti,
Më dridhet shpirti
Me ther koci."

Padyshim poezia lirike përbën pjesën kryesore të librit sepse autori nuk mund të shkruajë ndryshe veçse me dashuri, veçse me zemër. Po citoj nga poezia "Para fotografisë tënde" për të kuptuar thellësinë e lirizmit dhe të erotizmit të autorit:

"Në të zënça, moj çapkëne,
Do të rrëmbej porsi fajkua,
do të të çoj lart në stane
Që të shohësh vetëm mua..."

Ndjesia e mirë, freskia, bukuria të shoqërojnë gjatë gjithë leximit. Ndonëse autori përdor shumë gegërishten, një gegërishte të zbutur dhe të përshtatëshme, kjo nuk ja zbeh aspak bukurinë vëllimit poetik që është një arritje tjetër për autorin. Mbështetja në tabanin kombëtar popullor, në folklor dhe në histori ja shtojnë vlerat librit.

Rruga e Arbërit nr. 72

intervistë

**Intervistë me Jonuz Ndreun, veprimtar i njohur i komunitetit Shqiptaro-Amerikan, me rastin e 100 vjetorit të "Vatrës"**

# Jonuz Ndreu, jeta ime mes Amerikës dhe ëndrrës për një Shqipëri të lirë



**Kur dhe në çrethana erdhe në SHBA?**

Erdhëm, mbasi u arratisëm nga Shqipëria! Jetuam 5-6 vjet si emigrant në të ashtuquajturën Jugosllavi - e cila nuk eksiston më, mbas shpërbërjes së saj.. Nga viti 1954 na u dha e drejta me kërkue me dal jashtë Jugosllavis,për në Perendim. Na grumbulluan me një kap refugjatësh në malet e Kroacis, që quhej Gerovë. Ishte nji kamp në mes disa pyjeve shum të nalta. Në këtë kamp ishin mbledh shumë emigrantë, edhe ata të arratisur nëpërmjet kufijve të ish Jugosllavisë, nga vendet e kampit komunistë në Europën juglindore, si Rusia, Bullgaria, Rumania, Polonia, Hungaria e të shumë kombvësive të tjera.

Por, më kujtohet mirë se për çudi shumica ishin shqiptar me gra e fëmijë. Nuk di çfarë të them, sot, mbasi kushtet e jetesës ishin shumë të vështira, e sidomos për familjaret që kishin shumë fëmij.Kështu që një pjes e tyre nuk mundi me i përballuar vujtjet, dhe nuk ishin të sigur se nji ditë do tu plotësohet deshira, Të dëshpëruar dhe të demoralizuar kërkuan me u këthye prap në të jetonin në Jugosllavi dhe të liroheshin nga kampi sepse jeta ishte e pa durueshme. Ishte luftë për egzistencë, e thënë ma shqip. Pjesa tjetër vendosën me ndejtë në kamp, por, pa pas asnjë shpres, megjithse premtimin na i kishin dhënë se kush qendron do të largohet. Unë përvedi me niprit e mi, që kisha me vede vendosëm "edhe me vdek" nga kampi prapë në Jugosllavi nuk ktheheshim më, megjthë që s'kishim asnjë shpresë.Sepse e dinim që nuk u zihej besë sllavo - komunistëve.

Mbas disa kohësh erdhi një komision ndërkombëtar nga SHBA, për refugjatët, dhe na mori të gjithve në pytje. Kështu që nuk vonoj shumë, kohë dhe mbas 9 muaj vujtje, patëm fatin me një grup prej 63 vetave natyrisht, këta gra, burra e fëmijë dhe dolëm në Itali nëpërmjet Kroacisë - kufirit Dalmat. Autoritetet italiane me të na kapur na vendosen në një kamp në jugun e Italis që quhej Capua-Caserta. Në këtë kamp ishim të lirë dhe ajo çka ishte ma me randësi kishim një trajtim tjetër dhe nuk na ndiqte dhe provokonte askërkush.

Me të vërtet ishim të lirë, gati si çdo qytetar italian dhe mundeshim edhe me punue, po qese do të gjeje ndonjë lloj punë. Pra, nuk ishim të rrethuar me tela me gjemba dhe nuk jetonim në kapanone, nuk kishim apel nga policia. Gjeja me e keqe ishte se shpresat me emigrue në SHBA, aty ishin shumë të veshtira. Arsyeja ishte se Shqiptarët, në atë kohë kishin vetëm si quheshin atëhere "100 kota" pra vetë,m 100 familje në vjet. Dhe, autoritetet italiane që punonin me refugjatët të "korruptuar" atëhere, këto numëra i mbushin me shumë Grekë e Italinë që kërkonin të emigronin në Amerikë.

Unë u rregjstrova për me emigrue në Astrali, e cilla ishte ma kollajt në atë kohë. Më doli viza por,për arsye se në kamp ndodhi aksident i parashikuem në mes nesh dhe agjentve(të dëruarve) të Tiranës, mua me disa shok, na u ndalua emigrimi si mbas drejtësisë Italiane. Nuk më mbeti tjetër rrugë,me gjth që e kisha refuzue me shkue në Amerikë.

Më kujtohet si sot, më datën 8- shtator 1957, rash në kontakët me një komision Amerikan, dhe të nesrmen më morën me një makinë të tyre, dhe më çuan në bazën e tyre në Napoli. Tre ditë më pasë, sapo siguruan dokumentata me dërguan së bashku me disa të tjerë, drejt për në bazën e tyre në Frankfurt në Gjermani. Më veshën me unifromën ushtarake dhe më thirrën me bërë betimin në datën 15- 9 1957 si ushtarë Amerikan. Kështu, që mbas dy a tre ditësh në Gjermani, na nisën si grup me marrinësat e tjerë amerikan në SHBA, ku shërbeva si ushtarë me unifromë për pesë vjet, dhe gjatë karjerës mora gradën si nënoficer.

***Diçka rreth familjes dhe punës tuaj në Amerikë!***

Unë siç të thash ma nalt se kamë shërbye 5 vjet në ushtrinë Amerikane.Shërbimin ushtarak e kamë kryer fillimisht në disa baza ushtarake këtu në Amerikë, dhe mbasi jamë stërvitur këtu më dërguan jashtë Amerikës. Në fillim në një bazë në Islandë, dhe afer dy vjet në bazat amerikane në Gjermani.Kur isha në Island, mora pushimet vjetore dhe shkova, t'i kalojë tek disa njerëzit e mi në Belgjik. Aty përveç motrës që kisha, kisha dhe një "vëlla që kisha pi gjak" ose si i themi ne dibranët "birazel" timin, quhej Rexhep Beçen. Por, Beligjika më tërhoqi se shumë nga emigrantët që ishin atë kohë në Belgjik, i njifsha shumë mirë mbasi familjet ma të njoftuna në Dibër, Kukës, dhe e gjithë Shqipëria, ku unë kur isha i fëmijë kisha kaluar me prindërit e mi dhe të afërmit e mi me të gjithë shumë mirë.

Në Belgjikë me propozimin e "birazelit" timë Rexhepit, u fejova me vajzën e zotni Elmaz Pikut nga katundi Allajbegi të Dibrës. Mbarova shërbimin në Islandë dhe u trasferova në shtetin e Masechusesit (SHBA),me një kamp ushtarak afër Bostonit. Mbas një viti prap mora lejen zakonshme dhe shkova në Belgjikë, ku bëra martesën me zonjushën Igballe Piku. Me të cilën kam kaluar një jetë të bukur dhe krijuam një familje të mrekullueshme.

U mundova për t'a marrë si ushtarët e tjerë Amerikanë aty ku shërbjea, por "burokracia" nuk ma mundësoi. Kështu, që u detyrova të këthehem prap në Bazë ,mbasi më thanë që e vtëmja mënyrë që unë do ta tërhiqja edhe gruan time, ishte transferimi im për në Gjermani. Bëra lutjen e cilla mu pranue dhe u trasferova për në Gjermani me një bazë afër qytetetit të Frankfurtit mbi Main.

Në Gjermani mbarova kontratën 5 vjeçare që kisha bërë për të shërbyer në ushtrinë Amerikane, Marinasat forcat tokësore. Së bashku me gruan erdhëm në Amerik 5-6- ditë mbasi u lirova nga ushtria Amerikane.

U vendosa në New York, mbasi këtu gjeta mjaftë shqiptar, e sidomos nga ana e jonë, dibranë dhe Luma - Kukës. Fillova një punë natën me një ndërtesë familjare, ku punova 3 vjet së pari si roje për disa ditë, dhe më pasë një punë që si quhet këtu ingjinierë , pra punë të përgjithshme në pallat . Atëhere më kujtohet se New Yorku ishte bërë qendra e politikës shqiptare. Shqiptarët, edhe ata që kishin ardhur me heret dhe ishin vendosur në shtetet të tjera filluan e po organizoheshin në New York, nga këtu fillova dhe unë të merrem me politikë. Fillimet e mija të para me politikë, ishte anëtarësimi në partinë Katundare dhe u emnova përfaqësuesi i partisë në atë kohë.

***Mirëpo, kur dhe si u anëtarësove në Vatër? Kush ishte personi që ju rekomndoj që të shkoni në Vatër?***

Kur isha ushtar në një Bazë ushtarake në rrethinat e Bostonit, rashë në kontakete e para atje me shqiptarët e Botonit. Aty gjeta një mik të familjes dhe shok emigrimi, Sul Spatën dhe aty fati ma solli që në klubet shqiptare, nga kolointë e shqiptarve të herëshëm të njifesha me shum vatran të vjetër që kishin dyqanet dhe klubet shqiptare. Por, gjithësesi lidhjet ma të shumta më mbeten me New Yorkun. Çdo fundjave e kaloja në New York, se nuk e kisha larg me autobus. Në New York kisha lidhje të mira, me Ymer Dodën, Neshat Bilalin të cilët më afruan me Vatrën. Mbaj mend që kontaketet e para i vura, atëhere pra 50 vjetë më parë, kur dy miqt e mi Vatranë të flakët, më ftuan dy - tre, her për të marrë pjesë mledhjet të Vatres në New York, bashkë me Ymer Doden e Neshat Bilalin, mbasi ata shin antar të kryesisë së Vatres. Me thënë të drjetën, në atë kohë në Vatër, kishin hyrë shumë nga ata, që anojshin nga rregjimi i Enver Hoxhës. I vetëmi nga ata që ishte kundërshtar i pakompromisë i tyre, ishte zoti. Vahit Çika një biznismen dhe shqiptar i dalluem. Kur isha ushtar Ymer Doda, më tha "tash për tash, nuk të besdisi, por dije veçse atë ditë që të lirohesh prej ushtrie "të nesërmen" ke me u ba antar i Vatrës dhe ke me pague detzrimet (anëtarësinë)." Pra, në shqip kësaj ne i themi "Me dashje a pa dashje" Ymer Doda më shtiu si antar i Vatres në Shtatorin e vitit 1962. 50 vjetë më parë, dhe jamë në grupin e atyre Vatranëve, që jemi gjallë, nga më të vjetrit, duke u përkulur me respekt dhe nderuara ata që nuk jetojnë më

***Çfar ju tërhoqi atëher drejt Vatrës?***

Nuk kishte gjë ma të bukur se të ishe Vatran - Të dukej vetja sikur ishe në Shqipëri, Kosovë, apo viset shqiptare, çdo shqip dhe vetemë për Shqipërinë . 28 Nëntori Dita e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë Dita e Flamurit Kuqezi, ishte një "Dasmë e Madhe" e shqiptarëve të Amerikës. Kongreset e Vatrës , ishin madhështore, takimet e mbledhjet ishin gjithë patriotizëm dhe atdhetarizëm . Vatranët mendonin vetëm për fatin e shqiptarëve nën sundimin komunist serbo sllavë. Mendonin për Shqipërinë që po vuante sundimin e regjimit diktatorial të Enver Hoxhës, ndaj popullit të tij.Atëhere egzistonte sllogani"Çdo Shqiptar që e quen vedin Shqiptar - duhet të jetë një Vatran".Sepse, jo vetëm në ato kohë kur u krijua, por edhe më vonë në momente kyçe kur nuk ishte shteti Shqiptarë, ishte Vatra ajo që luajti rolin e shetiti në Amerikë. Mbasi ashtu si ka qenë, është dhe do të jetë në botën shqiptare, e vetmja Organizat që mbron të drejtat e Kombit Shqiptar, kudo në Botë dhe vendlindje, pa iteresa politike e karrike.

**Çfar atmosfere gjetet në Vatër?**

Unë tek Vatra gjeta veten, gjeta familjen time, farefisin dhe atë që kisha ëndërruar . Si nipi i atij që i këndohet kanga "Elez Isufi - Arusha e Malit" për veten time, dhe familjen time, kamë qenë dhe jam shumë i lumtur që kam qenë dhe jam sot e kësaj dite, edhe në këtë 100 Vjetor fatlumë, që ia kanë zilin shumë shoqata dhe organizata, edhe të kombeve të tjera, pjesë e një Organizate të till shqiptare siç ashtë Vatra , që bëri gjithçka sa ishte mund vetëm për me mbrojt interesat e Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Ska ma bukur dhe ma krenar - kurr nuk e kam ndier veten ma krenar si shqiptarë.

***Ju jeni keni bashkëpunuar dhe keni kontribuar pothujse në çdo shoqat e organizat të kumunitetit,fushata fondmblethëse për president të SHBA,kongresmen dhe senator miq të deshmuar të shqiptarve a mund të na flisni në detaje?***

Me të than të drejtën unë si një anëtarë i një familje shqiptare, historikisht patriotike, dhe me zë në Shqipëri, dhe trojet shqiptare, fisi Ndreu, i Elez Isufit, Suf Xhellilit, jamë Republikan Amerikan, qysh at ditë që kamë marr nënshtetësin Amerikane dhe kontributet e mija kanë shkue në fushatat e kësaj partie(GOP) që jamë i rregjistruem. Kam dhanë dhe kam ndihmuar, brenda mundësive, kuptohet "jo për të rrahuar gjoksin" dhe të them se ja unë kam "bërë këtë apo atë" shum her kontribute tek disa, shoqata organizata, që e kan tregue veten se kan punuar për interesa kombëtare, e jo interesa meskine. Kam dhënë dhe kontribuar për Vatrën, dhe ndihma për Shqipërinë, Çamërinë dhe Kosovën dhe shqiptarët në tokat tona etnike, sa herë që jemi mbledhur për këto dhe më kan kërkua që edhe unë të jap kontributin tim.

**Cilat kanë qenë aktivitet më të randësishme?**

Për mue aktiviteti më i rëndësishm ka qen dhe do mbetët, gjithçka që bëhet për atë që Atëdheu i ynë i dashtun, të jetë i fortë dhe i lumtur, dhe një ditë t'a gëzojmë së bashku bashkimin e Kombit Shqiptarë që nga Kosova, Çamëria, Maqedonia, Presheva, Bujanovci, Medvegja, dhe Malin e Zi. Gjithçka që bëhet edhe në këtë kurbet të mallkuar, çdo shqiptarë të punojë e luftojë me fëmijët e tij - familjen dhe të tjerët vetëm e vetëm : "Me e ruajtë gjuhën e ëmbël dhe të bukur Shqipe,Traditat, Zakonet e bukura dhe të vyera Shqiptare, Pra vetëm që të kemi se kujt me i a lënë dhe çfarë t'u lëmë pas fëmijve tanë me i rrit zakone e tradita Shqiptari. Së fundi kisha dëshir që t'i uroja jetë të gjatë kësaj shoqate , vite më të bukura dhe më të sukseshme edhe 100 vjet të tjera, dhe me një Shqipëri të bashkuar - Shqipëri Etnike.

*Në një intervistë me të fundit dhënë një gazetë në Tiranë, Jonuz Ndreu Njeriu që flet dhe dëshmon për herë të parë për gazetën në Tiranë, është 76-vjeçari Jonuz Ndreu, (djali i parafundit i nacionalistit Cen Elezi nga Sllova e Dibrës) me banim në Nju Jork në SHBA. Nipi Elez Isufit- Arshuës së Malit, si i thotë populli në këngë. Ai rrëfen të gjithë historinë se si i vëllai, Isa Ndreu, së bashku me publicistin e njohur të mërgatës antikomuniste shqiptare, Lec Shllaku, me ndihmën e ish-kryetarit të Bashkisë së Parisit, bënë të mundur vendosjen e emrit të Skënderbeut, në një prej shesheve në qendër të Parisit.* ***Gazeta e ka pyetur atë Kush është Isa Ndreu e Lec Shllaku, cila është e kaluara e tyre dhe si arritën ata të përjetësonin emrin e Skënderbeut në qendër të kryeqytetit francez?***

Mbas disa përpjekjeve disavjeçare që bëri vëllai im, Isa Ndreu, me mikun e tij, publicistin e njohur të mërgatës antikomuniste shqiptare, Lec Shllaku, ata arritën që t'i merrnin mikut të tyre, Zhak Shirak, që asokohe ishte në funksionin e kryetarit të Bashkisë së Parisit, miratimin për t'i dhënë një sheshi në qendër të kryeqytetit francez, emrin e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu. Shllaku me Isain e kishin mik të ngushtë politikanin e famshëm francez, Zhak Shirak dhe ata e kishin ndihmuar atë në fushatat e ndryshme elektorale kur ai kandidonte për postin e Kryeministrit apo të Kryebashkiakut të Parisit.

Pas shumë bisedimeve që Isai me Lec Shllakun zhvilluan me mikun e tyre të ngushtë Zhak Shirak, ai mblodhi Këshillin Bashkiak të Parisit, i cili më datën 10 korrik të vitit 1978, me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, mori vendimin zyrtar dhe i akordoi emrin e Skënderbeut, njërit prej shesheve në qendër të Parisit, i cili më parë quhej 'Villa Lumier'. Pas marrjes së atij vendimi, ceremonia zyrtare për dhënien e emrit 'Skënderbej' atij sheshi, u zhvillue më datën 6 dhe 7 maj të vitit 1980, ku morën pjesë me dhjetra e dhjetra personalitete të mërgatës antikomuniste shqiptare nga shumë vende të botës.

Në atë ceremoni madhështore mungoi vetëm ambasadori i Shqipërisë, i cili nuk mund të vinte dot aty për shkaqe që tashmë dihen. Pas kësaj në shenjë mirënjohjeje dhe respekti, Lec Shllaku me Isa Ndreun, i akorduan një medalje ari zotit Shirak, e cila iu dhurue me një ceremoni madhështore në Paris, ku morën pjesë personalitete nga e gjithë mërgata antikomuniste shqiptare".

**Intervistoi: BEQIR SINA**

***Përfundimisht, duke u mbështetur në argumentet që parashtruam më lart, shprehim mendimin se beteja e parë e ushtrisë shqiptare të komanduar nga Skënderbeu kundër ushtrisë osmanë të komanduar nga Ali pasha, më 29 qershor 1444, e cila njihet në histori me emrin "Beteja e Torviollit", është zhvilluar në Fushë-Çidhnën e Dibrës së Poshtme të sotme.***

# Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torviollit

*(Vijon nga faqja 11)*

me 8 shtëpi; 18) Shimharpole (Fusha e Shëmbarit) 3 shtëpi; 19) Darda (Dardha – A.H.) 16 shtëpi; 20) Suhodoll (Sohodoll – A.H.) me 7 shtëpi; 21) Maklishtë (Makishtë – sot lagje e fshatit Sohodoll – A.H.) 3 shtëpi; 22)Ivrainov (Vrain – A.H.) 13 shtëpi; 23) Timiravec 6 shtëpi; 24) Skrapinec 1 shtëpi; 25)Ariza (mund të lexohet Arëza) 5 shtëpi; 26) Tarek me 3 shtëpi; 27) Kërash (Krrash – sot lagje e fshatit Merskan në Dardhë – A.H.) me 2 shtëpi; 28) Lurë me 9 shtëpi; 29) Radibodishta (Rabdisht – A.H.) me 9 shtëpi; 30) Kërupi me 3 shtëpi; 31) Këtrovë me 2 shtëpi; 32) Dolna Brasta (Bresti i Poshtëm – A.H.) me 5 shtëpi; 33) Kidhna (Çidhna – A.H.) e Sipërme me 16 shtëpi; 34) Kidhna (Çidhna – A.H.) e Poshtme me 8 shtëpi; 35) Sitena e Sipërme (Sina e Sipërme – A.H.) me 3 shtëpi; 36)Setina e Poshtme (Sina e Poshtme – A.H.) me 3 shtëpi; 37) Shashar – sot lagje e fshatit Kodër – Leshej – A.H) me 2 shtëpi; 38) Gur (gur-Lurë – A.H.) me 4 shtëpi; 39) Reçi Madh me 20 shtëpi; 40) Reç i vogël me 10 shtëpi; 41) Priga (Pregja – A.H.) me 10 shtëpi; 42) Kolozhanci (ndofta Pollozhani i sotëm – A.H.) me 9 shtëpi; 43) Truallishta Rashtopol (Rashnopojë – A.H.) nuk ka shtëpi; 44) Luzina (Luznia – A.H.) me 46 shtëpi; 45) Veleishtë (Vleshë – A.H.) me 15 shtëpi; 46) Torojak (Torjaku i sotëm – A.H.) me 5 shtëpi; 47) Izdolani (Zdojani – A.H.) me 4 shtëpi; 48) Bullaç (Bulaç – A.H.) me 5 shtëpi; 49) Klishavec (Kishavec – A.H.) me 8 shtëpi; 50) Sllatina me 7 shtëpi; 51) Lugan (Lugjaj ose Lugan – A.H.) me 8 shtëpi; 52) Cvatosh (Cetush – A.H.) me 6 shtëpi; 53) Melan me 2 shtëpi; 54) Dijushtita (Dohoshisht – A.H.) me 11 shtëpi; 55) Pallamishta (Palaman – A.H.) 56) Kudhon me 19 shtëpi; 57) Shipçan (Shimçan – A.H.) i bashkuar me fshatin Zimurena (Zimur – A.H.) me 10 shtëpi; 58) Shilubod, (Shilbatra e sotme – V.B), (Salbatra – A.H.) me 6 shtëpi; 59) Drimjani me 3 shtëpi; 60) Dupjakë (Dipjakë – A.H.) me 9 shtëpi; 61) Vitishta (Venisht – A.H.) me 6 shtëpi; 62) Slavjani (Sllova – A.H.) me 4 shtëpi; 63) Kurna Borovjani (Borovjani i Sipërm) i braktisur; 64) Kushtilanez (Ushtelenzë – A.H.) me 10 shtëpi; 65) Staniçani me 5 shtëpi; 66) gardi Poshti (Gardhi i Poshtëm) me 9 shtëpi; 67) Gërcani me 4 shtëpi; 68) Muhurr me 19 shtëpi; 69) Shivasil (Shorokan – A.H.) me 5 shtëpi; 70) Limjan me 5 shtëpi; 71) Kal (Kallë – A.H.).

Siç shihet, Dibra e Poshtme përbëhej nga 71 fshatra me 591 shtëpi shtëpi, një manastir (ai i Peshkopisë) dhe një truallishtë.

Duke krahasuar emrat e fshatrave që figurojnë në Defterin emëror të vilajetit të Dibrës të vitit 1467 me emrat e fshatrave të të dy Dibrave, sot mund të vërejmë se shumica e tyre përkojnë plotësisht me njëri-tjetrin. Kështu mund të përfundojmë se ndarja e Dibrës në të poshtme e në të sipërme sot ka një përputhje të plotë me ndarjen e vitit 1467. Në të dy rastet si kufi i përafërt janë kodrat e Qenokut në anën lindore të Drinit dhe Gurra e Mërzhicës në anën Perëndimore të Drinit. Të dy Dibrat mesjetare shtriheshin në të dyja anët e Drinit të Zi dhe nuk ishte ky lumë kufiri që ndante të dy Dibrat.

Ky dokument zyrtar historik mbi Dibrën hedh poshtë kategorikisht çdo hipotezë e përpjekje për një ndarje tjetër të Dibrës mesjetare në dy pjesë, ndryshe nga ndarja e sotme e Dibrës.

Po të vështrojmë nga afër terrenin, Fushë-Çidhna së bashku me fshatrat e Laçes e Blliçe, ku mendojmë se është zhvilluar beteja e parë e Skënderbeut kundër ushtrisë osmane, më 1444 j vetëm që i plotëson të gjitha kushtet për zhvillimin e një beteje mesjetare me kalorës dhe këmbësorë prej disa dhjetëra mijëra vetash për secilën palë, por ka edhe ngjashmëri të plotë me terrenin që përshkruajnë Barleti e Tivarasi. Fushë-Çidhna shtrihet në bregun lindor të Drinit të Zi. Është një fushë e gjerë në formë rombi, po të kemi parasysh edhe fshatin Arras, që është vazhdim i kësaj fushe. Ajo, rreth e qark, është e mbrojtur nga kodrina dhe male të veshura me dushqe. Bimësia e tipit të shkurreve dhe dushqeve ka qenë në këtë vend ...kufizohet me kodra të veshura edhe sot me dushk dhe me boka, midis të cilave edhe me Salbatret, mbi të cilat fillojnë e shtrihen rrafshet e Shumbatit, vetëm 608- m më lart mbi nivelin e Fushë-Çidhnës, një fushë e tërë e gjerë edhe kjo, deri në fshatin Torjak, sot bllok pemëtoreje; nga juglindja Fushë-Çidhna kufizohet me Ostushin, një rrip i gjatë kodrash prej disa kilometrash nga fshati Blliçe deri në lumin Drin, jo më e lartë se 40-60 m mbi nivelin e Fushës së Çidhnës, kodrinë që deri në ditët tona ka qenë e veshur me dushk, sot bllok i tërë pemëtoreje, e cila e ndan atë me fushën shumë të gjerë të Kastriotit, ku mund të zhvillohej një betejë prej qindra mijëra ushtarësh (Fusha e Kastriotit është vazhdim i drejtpërdrejtë i Fushës së Çidhnës, pavarësisht se ndahet nga kjo me kodrinën e Ostushit; bile, fusha e Kastriotit është territor i krahinës së Çidhnës). Mes për mes Fushë-Çidhnës në drejtim të lindjes, nga perëndimi Fushë-Çidhna kufizohet me Drinin e Zi, në vendin ku derdhet Seta. Nga jugperëndimi, në anën perëndimore të Drinit, vjen një kodër strategjike, në anën perëndimore të Drinit, vjen një kodër strategjike, Suka e Arrasit, bashkë me një varg të tjerë kodrash të tjera deri në fshatin Sinë e Poshtme, në të cilën kanë qenë trojet e Skënderbeut, kurse nga perëndimi e veriperëndimi rrethohet me Kodrën e Leshe, një varg i gjatë kodrinash këto, të cilat e ndajnë Fushë-Çidhnën nga fshati Çidhën, ku ka qenë qyteza e Çidhnës me kalanë e saj. Ndërsa më larg, Fusha e Çidhnës nga lindja kufizohet me bjeshkët e Gramës dhe me malin e Korabit, nga perëndimi kufizohet me bjeshkën e Pllajut, me të cilën e ndan Maja e Vagut, rrëzë së cilës shtrihet Sina e Epërme dhe pak më në veri të saj Çidhna, në veriperëndim të së cilës ngrihet mali i Xharxhishtit me bjeshkën e tij, duke pasur kështu një ngjashmëri të plotë me Torviollin e vitit 144, që përshkruan Barleti dhe e përsërit Biemi.

Në të gjitha kodrat që përmendëm më lart, veçanërisht në Salbatre, Ostush, Kodër të Laçesës, Sukë të Arrase dhe Kodër-Leshej etj., që gjenden rreth e qark Fushë-Çidhnës dhe ngjitur me të, edhe sot e kësaj dite gjenden pozicione luftarake shumë të vjetra. Nëpër Fushë-Çidhën kalojnë e kryqëzohen të gjitha rrugët për Peshkopi e Dibër të Madhe nga Lura, Zall-Dardha, Sllova e Luma. Fushë-Çidhna kufizohet dhe është e lidhur drejtpërsëdrejti edhe me Muhurrin, nga ku kalon rruga nëpër Qafmurrë për në Stelush e Mat dhe, prej këtej, në Krujë. Nga Fushë-Çidhna kalohet drejtpërdrejt në Mat dhe, prej këtej, në Krujë. Nga Fushë-Çidhna kalohet drejtpërdrejt në Mat e prej këtej në Krujë edhe nëpërmjet rrugës që kalon nëpërmes Sinjës, në Majë të Vagut, në Bjeshkën e Pllajut, e cila lidhet me Stelushin e pastaj kalon në luginën e Matit, nga ku del në Krujë.

Fusha e Çidhnës ka qenë kryqëzim rrugësh edhe në lashtësi, nëpërmjet të cilave lidhej Dibra me Mirditën, Lumën, Kukësin dhe Kosovën. Pranë Fushë-Çidhnës, pothuaj ngjitur me të, në anën lindore të saj, kalon një rrugë shumë e lashtë, e njohur me emrin "Rruga e madhe", e cila lidhte Dibrën e Poshtme me krahinën e Lumës dhe të Kosovës 8). Sipas traditës popullore dhe atyre pak gjurmëve të konstatuara "Rruga e madhe" kalonte nëpër këto fshatra të Dibrës së Poshtme: Kala e Dodës-Vleshë Sllatinë-Dipjakë-Limjan – nëpër lagjen Makisht të fshatit Sohodoll, nëpër fshatin Sohodoll-Borovjan-Pilafej-Rashnapojë-Pollozhan-Dohoshisht – në Fushë të grevës – pastaj del në Fushë të Shehrit (të Dibrës së Madhe), ku arrin në qytetin e Dibrës së madhe. Pjesa e kësaj rruge nga Kalaja e Dodës e deri në Dohoshisht vërtetohet me fragmente kalldrëmi. Gjurmë kalldrëmi si vazhdim i kësaj rruge, sipas dëshmisë së mësueist Refik Shehu nga Bicaj i Kukësit, ka edhe në fshatrat e rrethit të Kukësit: Domej-Bushat-Bardhoc etj. Kjo rrugë lidhte Dibrën e Poshtme me Lumën e Kosovën. Fakti që kjo rrugë është e shtruar me kalldrëme edhe jashtë fshatrave, tregon se ajo ka pas shërbyer, ndër të tjera edhe për qëllime ushtarake.

Një ndër degëzimet e "Rrugës së Madhe", që ia vlen ta përmendim, kalon nëpër këto fshatra të Dibrës së Poshtme: Ndërshen, Lashkizë, Çidhën, Maja e Qytezës në Hurdhë-Muhurr, Qafë-Murrë (Stelush) etj.

Mësuesi pensionist Hivzi Shehu ruan një gojëdhënë që thotë se një tjetër rrugë karvanësh me kalorës, qerre etj., që lidhte Dibrën e Poshtme me KOsovën, kalonte mes për mes Fushë-Çidhnës. Duke filluar nga fshati Sinjë, ajo vazhdonte në Sinë – Gardh – Fushë-Alie (sot Fushë-Çidhën) – Shumbat – Torjak – Palaman – Sllovë. Vleshë-Ceren-Sorokol, Prroi i Lushit, Laku i Cane-Ksula e Priftit, Vracë (është bjeshkë) Radomirë-Qafa e Resnajkut-Gostivar, Tetovë-Prizren. Duke filluar nga Gostivari kemi edhe një degëzim tjetër të kësaj rruge që lidhet, nëpërmjet Gostivarit, me Manastirin, prej nga kanë ardhur shpeshherë ushtritë osmane e kanë rënë në Dibër të Poshtme. Nëpërmjet këtyre rrugëve shkohej nga Dibra e Poshtme në Prizren. Këto rrugë qysh në lashtësi lidhnin Dibrën e Poshtme me Kosovën.

Të gjitha këto na lejojnë të arrijmë në përfundimin se ushtria osmane e komanduar nga Ali Pasha, në qershor të vitit 1444, ka hyrë në Dibrën e Poshtme nga ana e Kosovës dhe e Lumës dhe ka rënë fshehurazi nëpërmjet "Rrugës së Madhe", në luginën e Drinit të Zi, në fushën e Torviollit, më saktë në Fushë-Çidhën e sotme, në Dibër të Poshtme. Shtojmë se në trevën e Fushë-Çidhnës duhet të kërkohet edhe vendlindja e vendbanimi i Skënderbeut dhe i paraardhësve të tij. Një dëshmi për këtë janë edhe toponimet Kastriot dhe brenda territorit të fshatit Kastriot, Fusha e Kastriotit, ose Fusha e Thatë, Kalaja e Gjonit ose Kulla e Gjonit, Kroi i Kastriotit, Pusi i Gjonit, Zabeli i Gjonit, Kalueri (vend në të cilin thuhet se stërviteshin kalorësit), Kodra e pareve, Çeliasi (thuhet se këtu ka qenë burgu), Gjuri (Guri – A. H.) i luftës, Kodra e Shamatës etj. Gjardhi i Poshtëm, dikur fshat më vete, sot lagje e fshatit Sinë e Poshtme; Gjardhi i Epër në Sinë të Epër. Brenda territorit "Gjardhi i Poshtëm", ose shkurt Shgjerth, janë edhe toponimet: Troja, (ku thuhet se këtu kanë pasur trojet Kastriotët). Këtu ka gjurmë themelesh prej guri, Kodra e Trojës, Hambarët. Po në Sinë të Poshtme kemi edhe toponimet "Pajella e Skënderbeut" dhe "Hurdha e kalit të Skënderbeut". Në Sinë të Epërme ruhet toponimi: "Thana e Skënderbeut", etj. Në Çidhën: Kepi i Chitelit, Kepi i Matjes (i cili sipas gojëdhënës shërbente për të matur ushtarët e Skënderbeut) Pusi i Skënderbeut, Gjuri i Kalit të Skënderbeut (thuhet që Skënderbeu ka pas lidhur kalin e tij), Kalaja e Skënderbeut Rrafshja e Topit (vend i sheshtë në lartësinë e bjeshkës së Pllajut, në jug të kalasë së Skënderbeut në Çidhën) etj.

Të gjitha këto toponime si dhe shumë të tjera, që nuk i kemi përmendur këtu dhe që janë të lidhura drejtpërdrejtë me emrin e Skënderbeut dhe të prindërve të tij, na vërtetojnë se Skënderbeu, jo vetëm që ka zhvilluar beteja të herëpashershme kundër pushtuesve turq në këtë trevë, por kjo është edhe vendlindja e tij. Lidhur me këtë çështje, me origjinën dibrane të Skënderbeut, edhe sot nëpër oda të Çidhnës, në gojën e pleqve bashkëkohës, qarkullon gojëdhëna se fisi që mban emrin "Gjini", në fshatin Kastriot të krahinës së Çidhnës në Dibër të Poshtme, është i një fisi, i një gjaku e origjine me Skënderbeun 9).

Gjithashtu nuk ishte i rastit as kthimi i sulltan Mehmetit .... gjatë tërheqjes për në Stamboll në gusht të vitit 1466, një kthim nga Elbasani në Dibër, madje në skajin veriperëndimor të Dibrës së Poshtme. Sulltan Mehmeti II masakrën e bëri pikërisht në Çidhën, me qëllim që të hakmerrej ndaj Skënderbeut, të zhdukte nga faqja e dheut trojet e gjaku i Skënderbeut, gjë të cilën na e vërteton edhe Dimitër Kastrioti, i përmendur në Defterin e Vilajetit të Dibrës të vitit 1467.

Lidhur me hipotezën e Hazis Ndreut, që botohet në këtë numër të revistës "Studime historike" që kjo betejë u zhvillua në Fushë të Kastriotit, ne nuk jemi dakord:

1. Fushë-Çidhna është në veri të Fushës së Kastriotit dhe kur përshkruam sa më lart, se nga kishte ardhur ushtria osmane e komanduar nga Ali pasha, në qershor 1444, për të dalë në Fushë të Kastriotit, rruga kalon patjetër nëpër Fushë-Çidhnën e sotme. Është e pabesueshme që Skënderbeu ta linte të qetë Ali pashën, pa e sulmuar ushtrinë osmane, derisa të dilte në një fushë të hapur si ajo e Kastriotit. Taktika luftarake e Skënderbeut nuk e lejon një konkluzion të tillë, por Skënderbeu ia ndërroi drejtimin dhe e tërhoqi ushtrinë osmane në një terren më të ngushtë, të tillë, siç është Fushë-Çidhna e sotme.

2. Përshkrimet e historianëve dhe kronistëve të lartpërmendur lidhur me terrenin ku u zhvillua ajo betejë nuk përputhen me Fushën e Kastriotit, pasi kjo është një fushë shumë më e gjerë se ç'thuhet në ato kronika. Ai përshkrim përputhet plotësisht vetëm me terrenin e Fushë-Çidhnës.

Përfundimisht, duke u mbështetur në argumentet që parashtruam më lart, shprehim mendimin se beteja e parë e ushtrisë shqiptare të komanduar nga Skënderbeu kundër ushtrisë osmanë të komanduar nga Ali pasha, më 29 qershor 1444, e cila njihet në histori me emrin "Beteja e Torviollit", është zhvilluar në Fushë-Çidhnën e Dibrës së Poshtme të sotme.

---

Referenca

*) (Nxjerrë nga "Studime Historike" nr. 3. 1979, f. 229-236)
1) (M. Barleti, Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut (përkthyer shqip nga St. Prifti), Tiranë 1967, f. 107.
2) G. Biemi, Storia di Giorgio Castriota detto, Scander-Begh, Brescia 1742.
3. F. S. Noli, Historia e Skënderbeut, Boston Mass 1921, f. 120.
4. A. Buda, Fytyra e Skënderbeut nën dritën e studimeve të reja, "Buletini i Institutit të Shkencave", seria shkencat shoqërore, Tiranë nr. 3-4 (1951).
5) K. Frashëri, Ku gjendet Torviolli?, në rev. "Shkenca dhe jeta", Tiranë 3 (1975) f. 61).
6) Defteri emëror i vilajetit të Dibrës... i vitit 1467
7) Defteri emëror i vilajetit të Dibrës... i vitit 1467
8) Këto njoftime i kam marrë nga Iljaz Kaca (në dorëshkrim)
9) Lidhur me këtë çështje, mbi origjinën e Skënderbeut, shih më gjerësisht studimin e K. Frashërit: Nga ishin Kastriotët? Ku lindi Skënderbeu?, botuar në gazetën "Mësuesi" më 4 dhe 11 shtator 1974 dhe studimin e Haziz Ndreut: Toponimia në ndihmë të historisë së Kastriotëve, botuar gjithashtu në "Mësuesi"më 14 janar 1976, në të cilët vihet në dukje se materiali toponimik i trevës së Dibrës së Poshtme, veçanërisht i krahinës së Çidhnës jo vetëm pajtohet me burimet dokumentare mbi Skënderbeun, por ka edhe veshjen folklorike kastriotase, gjë që i mungon materialit toponimik të vendeve të tjera.

**Said Najdeni punonte me të gjitha forcat. Ai kishte program pune. Njihte mirë psikologjinë dhe vetitë e popullit të tij. Ideja e tij për hartimin e veprës "Fe –Rrefenjës Myslimane" ishte që ai t'u jepte në dorë shqiptareve një material te plotë, të bukur në gjuhën shqipe**

# Said Najdeni (Hoxhë Voka)

## Atdhetar dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare



*Nga:* **XHELAL ROÇI**

Said Najdeni ishte njëri nga atdhetarët dhe veprimtarët e dalluar të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, i njohur me pseudonimin Hoxhë Voka, i cili dha kontribut te çmuar për çështjen kombëtare në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Rreth vitlindjes së tij ka mendime të ndryshme, por duke u mbështetur në kujtimet e vëllait të tij, Hysni Najdenit, Saidi duhet të ketë lindur në muajin dhjetor 1864.

Prindërit e Saidit, nëna Esmaja dhe babai i tij Islami, ishin njerëz të nderuar. Familja e tij shquhej për urtësi dhe ndershmëri. Ata merreshin me tregti, me mjeshtri dhe me të ardhurat që nxirrnin nga çifligu i tyre që zotëronin në Perlepe. Vëllezërit e tij, Sefedini, Qazimi dhe Hysniu punonin në qytetin e Dibrës së Madhe dhe familjarisht jetonin në këtë qytet. Saidi në vitin 1882, në moshën 18 vjeçare, kreu shkollën fillore dhe përfundoi studimet plotore në shkollën Rruzhdije të qytetit të Dibrës së Madhe. Në shkollë Saidi ishte nxënës i zellshëm, tip i zgjuar, kishte etje të veçantë për të fituar dituri; ishte njeri me figurë të pastër morale, urrente veset e këqija, gënjeshtrën, vjedhjen dhe padrejtësitë. Ai sillej shumë mirë me shokët, i respektonte ata dhe në mënyrë të veçantë tregonte interes për të mësuar ngjarjet historike të krahinës dhe të mbarë kombit shqiptar si dhe kulturën popullore. Gjatë kësaj kohe ai hodhi shtat, vinte trup hollë dhe i gjatë, ishte i zbehtë në fytyrë, mbante mjekër dhe mustaqe të zeza. Kishte shikim të qetë dhe depërtues. Në vitin 1880, situata politike në Dibër të Madhe ishte shumë e trazuar. Në vitin 1881 Prefekti i Dibrës së Madhe, Kadri Pasha, arrestoi dhe internoi në Manastir shumë patriotë dibranë si: Ago Jegenin, Xhelo Ahmetin, Alit Zenelin,Halit Toton, e vrau tradhtisht Halil Bajkushën. Po këtë vit administrata osmane e qytetit rekrutoi me forcë 300-400 dibranë dhe i dërgoi ushtarë (nizamë) për të luftuar në viset e largëta të Perandorisë, për të shtypur kryengritjet e kombeve të tjera. Të gjitha këto shtuan pakënaqësitë e popullit dibran, i cili shpërtheu në një lëvizje të re kundër autoriteteve të qeverisë osmane. Në krye të lëvizjes u vunë njerëz të thjeshtë të krahinës së Dibrës si Tush Lleshi, Mane Dema e të tjerë nga qyteti e malësia e Dibrës. Si rezultat i përpjekjeve, revoltës dhe veprimeve luftarake të popullsisë, prefekti i qeverisë së atëhershme Tuirke u detyrua të largohet nga Dibra për të shpëtuar kokën ë tij. Pikërisht në këto rrethana historike, politike e shoqërore, në qytetin e tij të lindjes në Dibër të Madhe, Said Najdeni kaloi vitet ë rinisë së tij të parë. Në edukimin patriotik e atdhetar të tij ndikuan në mënyrë të veçantë rrethi i tij familjar dhe pjesëmarrja e tij në kuvende burrash nëpër dhoma. Familjet dibrane, si të gjitha familjet shqiptare, jetonin së bashku në familje të mëdha, të përbërë nga disa kurorë e shumë pjesëtar dhe shumë prej këtyre familjeve kishin dhoma pritje që i quanin odat e miqve. Në këto dhoma fëmijët merrnin elementet e parë të edukimit familjar, patriotik e atdhetar, të gërshetuara me zakonet, traditat, normat kanunore të mira të popullit shqiptar. Fëmijët edukoheshin me respekt ndaj më të moshuarve. Ata mësonin të zbatojnë normat e pjesëmarrjes në biseda. Brenda në dhomë i riu duhet të dëgjonte të moshuarin, të priste radhën për të folur dhe të fliste gjithmonë kur e pyesnin për ndonjë problem ose kur atij do t'i përmendej emri. Ata mësonin të përballonin të folurit e mprehtë e me humor, të mësonin e të përdornin kur të ishte nevoja alegorinë dibrane, por gjithmonë për të mos ofenduar ose rënduar tjetrin në biseda.

Të mos qëllonte me "pushkë në Pazar", se nuk dihet se nga shkon plumbi. Pra, të mos i lëshonte fjalët pa menduar dhe pa i peshuar se mund të rëndonte ndonjërin që ishte pjesëmarrës në kuvend. Ata duhet të dallonin kush ishte miku e armiku. Ç'është besa? Kujt i duhet dhënë besa? Ç'është nderi e Atdheu? Ç'është arma dhe kur duhet të përdoret ajo?

Kaq shumë vlerësohej kjo lloj edukate, saqë vizitorët ë huaj e konsideronin atë si një shkollë të lartë. Universitet në vetvete, ku djali ose burri vlerësohej për marrjen e këtyre dijenive, ai quhej i aftë për të hyrë në valle burrash. Sigurisht, ai duhet të dinte për të marrë, pranuar e kthyer përshëndetjet (për të dhënë e marrë selamin), ai duhet të kishte figurë të pastër, të ishte trim, i mençur dhe bujar. Gjithashtu, duhej të karakterizohej nga sensi i durimit, duke zbatuar fjalën ë urtë dibrane: "Gjella me kripë e kripa më karar".

I ati i Saidit, duke vënë re te i biri këto cilësi, sidomos dëshirën dhe vullnetin e madh për të fituar dije, talentin dhe karakterin e fortë të tij, në vitin 1883 vendosi ta dërgojë për të ndjekur studimet e larta teologjike ne Edrene, një nga qytetet më të dëgjuara të Turqisë. Këtë vit Saidi shkoi në Edrene dhe filloi shkollën ë lartë. Kjo nuk shkoi gjatë dhe Saidi nga Edrenja i dërgoi letër të atit se atje nuk kishte shkollë të përshtatshme për atë dhe i kërkoi lejë të largohej nga Edrenja e të shkonte në Stamboll. Pasi i ati dha miratimin, Saidi shkoi në Stamboll dhe u regjistrua në shkollën e lartë "Hajdar Fatiu" të Stambollit. Gjatë kësaj kohe Said Najdeni, megjithëse ishte në moshë të re, ai ra në kontakt me elementë patriotë e përparimtar shqiptar që banonin atje dhe punonin për çështjen kombëtare shqiptare. Atje u njoh me shokët e tij të idealeve si me: Sami e Naim Frashërin, Ismail Qemalin, Rexhep Pashë Matin e disa të tjerë që punonin për çështjen kombëtare shqiptare. Jemi në vitet pas formimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe idetë e saj ishin përhapur tek të gjithë shqiptarët që punonin me pushkë e me penë, brenda dhe jashtë Atdheut, për çështjen kombëtare. Saidit këto ide e pikëpamje të rilindësve i shkonin për shtat. Gjatë kohës që ai studionte në shkollën ë lartë, gjeti edhe një shok të idealeve të tij Hafiz Ibrahim Mitrovicën. Ky ishte shqiptar nga Kosova. Edhe në Kosovë kazani valonte. Shqiptarët ishin ngritur në këmbë, atje dhe kudo në viset tjera shqiptare për çështjen shqiptare.

Shkolla e lartë "Hajdar Fatiu" ishte në Lagjen "Çeçen" të Stambollit në një vend të përshtatshëm. Këtu shqiptarët mblidheshin shpesh e bisedonin për problemet që preokuponin kombin dhe më të drejtë shumë shqiptarë e quanin "Klubi i shqiptarëve". Said Najdeni, për vetë karakterin e tij dhe aftësitë e tij që kishte për të fituar zemrat e të gjithë njerëzve, dinte të bisedonte me njerëz të moshave e profesioneve të ndryshme. Saidi ishte njeri guximtar, kishte kurajë të fliste hapur për problem që i diktonte koha për çështjen kombëtare.

Kjo bëri që ai të binte në sy të organeve qeveritare të ndjekjes, që e cilësonin atë kundërshtar të sistemit qeveritar turk dhe filluan ta ndjekin hap pas hapi, duke marrë masa kontrolli ndaj tij. Saidi, në përfundim të çdo viti mësimor i nënshtrohej provimeve sipas programit dhe gjithnjë ishte ndër të dalluarit në mësime. Gjatë kohës së qëndrimit në shkollë Said Najdeni u njoh me Talat Beun (Pashën). Me këtë kishte zhvilluar disa herë biseda me karakter politik për padrejtësitë e sistemit politik, për padrejtësitë e sistemit shtetëror të kohës. Tajar Pasha kishte shkuar e kishte takuar Said Najdenin edhe në burgun e Edrenës ku e kishte burgosur qeveria turke. Këtë Saidi e konsideronte shok besnik e dashamirës. Talati disa herë i kishte shprehur: "Unë me të vërtetë nuk jam shqiptar, por i dua shumë shqiptarët dhe përpiqem për të mirën e Shqipërisë. Juve Said, ju përgëzoj që përpiqeni dhe punoni për çështjen tuaj kombëtare, për të ardhmen e kombit tuaj dhe u uroj suksese e mbarësi për të mirën e Shqipërisë..." Talat Beu ishte me pikëpamje xhonturke, i vendosur si pjesëtar i kësaj organizate përparimtare, siç e quante veten ajo. Kjo organizatë kishte në program që të bënin revolucionin për përmbysjen e kabinetit qeveritar të Sulltan Hamitit në Turqi. Ata kishin në program të hartonin dhe të shpallnin kushtetutën e re turke me përmbajtje përparimtare, sipas modeleve të Europës Perëndimore në atë kohë. Talat Beu, pasi erdhën në pushtet xhonturqit, mori titullin "Pashë" dhe u bë Kryeministër i Turqisë. Xhonturqit, pasi morën pushtetin, nuk i përmbajtën premtimet që u kishin dhënë shqiptarëve. Megjithatë, çështja kombëtare në këtë kohë kishte marrë përpjesëtime të mëdha dhe shqiptarët luftonin me të gjitha mënyrat derisa arritën me 28 nëntor 1912 të fitojnë pavarësinë. Talat Pasha vazhdonte të drejtonte shtetin turk. Në vitin 1914 plasi Lufta e Parë Botërorë dhe në vitin 1918 Talat Pashën ë vranë në Berlin, në kryeqytetin e Gjermanisë. Vrasjen e kreu e një person me kombësi armene.

Said Najdeni njihej si dijetar i formuar e me kulturë të mjaftueshme teologjike, filozofike, shkencore, politike dhe fetare. Shkollën e vazhdoi rregullisht dhe e kreu me rezultate shumë të mira në Stamboll dhe u kthye në vendlindjen e tij, në qytetin e Dibrës së Madhe. Atje iu vu punës për përhapjen e gjuhës shqipe dhe të diturisë kombëtare. Ai bënte pjesë në plejadën e mësuesve shqiptarë të shkolluar e të njohur për aktivitetin e tyre patriotik, për të hapur shkollat shqipe, për të mësuar gjuhën shqipe dhe lëndët e tjera sipas programit që i duhet të zbatojë një shkollë e formuar. Saidi, që kur ishte student në shkollën "Hajdar Fatiu" kishte punuar për hartimin e veprës së tij "Fe-Refenja e Myslimanëve" . Kjo ishte jo vetëm një vepër fetare, por edhe një thesar i çmuar i fjalorit të gjuhës shqipe dhe i shërbente shumë çështjes kombëtare. Vepra e tij, siç do ta përmendim edhe më vonë, u botua me vështirësi në vitin 1900 në shtypshkronjën shqiptare "Mbrothësia" në qytetin e Sofjes në Bullgari, me alfabetin latin të shoqërisë së Stambollit, në gjuhën shqipe, në të folmen e Dibrës me pseudonimin "Hoxhë Voka".

Said Najdeni punonte me të gjitha forcat. Ai kishte program pune. Njihte mirë psikologjinë dhe vetitë e popullit të tij. Ideja e tij për hartimin e veprës "Fe –Rrefenjës Myslimane" ishte që ai t'u jepte në dorë shqiptareve një material te plotë, të bukur në gjuhën shqipe. Ai me këtë material në dorë gjatë muajit të Ramazanit çdo vit udhëtonte nëpër krahina të ndryshme të Shqipërisë. Merrte takim me shumë njerëz, propagandonte idetë kombëtare në gjuhën shqipe. U fliste për përpjekjet që duhet të bëjnë shqiptarët për tu arsimuar në gjuhën shqipe, për të fituar të drejtat e tyre që të hapin shkolla shqipe. Gjuha shqipe duhet të përdorët në administratat shtetërore. Në shtet dhe në qendrat administrative të ketë nëpunës shqiptarë. Ushtarët shqiptarë të kryejnë shërbimin ushtarak në vendin e tyre dhe kombi shqiptar të fitojë pavarësinë ashtu si kombet e tjera. Krahas zbërthimeve të programit për çështje kombëtare, ai kryente edhe detyra fetare. Said Najdeni , çdo takim me njerëzit ai e organizonte me qëllim të caktuar. Bisedat e tij ishin të përgatitura, të studiuara dhe i shërbenin çështjes kombëtare. Përveç këtyre, për biseda Saidi, shfrytëzonte edhe takimet nëpër dhoma, në ditë festash, në dasma e në muajin e madhërueshëm të Ramazanit. Këto veprime Said Najdeni i kishte bërë që kur ishte student, por edhe pasi kreu shkollën, ai zhvillonte polemikë me kundërshtarët e tij, sidomos me ata fetarë, hoxhallarë turkoshak që propagandonin se gjuha shqipe nuk është e përshtatshme për tu shkruar. Feja myslimane, sipas tyre, ka gjuhën ë saj, gjuhën turke dhe arabe. Këta propagandonin kundër Said Najdenit, duke e quajtur atë të pafe, kaur, se gjoja ai kryente veprime antifetare. Me këto veprime e mënyra jo vetëm që kryenin shërbime në favor të qeverisë osmane, por përpiqeshin të ulin autoritetin e Saidit, të shtresave të ulëta të popullit, të cilët ishin fanatikë dhe besimtarin mysliman e quanin dhe e barazonin me shtetasit turq. Këto elemente pengonin në këtë drejtim, sepse Said Najdeni te këto shtresa kërkonin mbështetje për punën që bënte për çështje kombëtare. Por ai punonte me durim të madh, nuk lodhej dhe nuk mërzitej nga thashethemet dhe intrigat që kurdisnin ndaj tij. Ai u përgjigjej se ata po të ishin mysliman të vërtetë duhet të dinë se feja islame e detyron çdo besimtar mysliman me e dashur në radhë të parë Atdheun. Pa Atdhe nuk ka fe, theksonte Saidi. Ai ishte burrë i mençur, arsyetonte e analizonte me vetveten çdo fjalë e çdo veprim që kryente. Fjalët që thoshte në kuvend i mendonte mirë. Kundërshtarët ë tij në prezencë e kishin të vështirë ta kundërshtonin e ta kritikonin dhe as nuk mund të zhvillonin biseda e të debatonin me të për çështje të ndryshme fetare e kombëtar apo të politikës ndërkombëtare.

Said Najdeni pas veprës së tij "Fe-Rrefenja Myslimane" arriti të botojë edhe një abetare në gjuhën shqipe, pa vënë emrin e tij (anonim), pasi klerikët myslimanë që i shërbenin politikës turke, ashtu si pushtuesit osmanë, siç e theksuam, i quanin turq shqiptarët myslimanë dhe ata jo vetëm e mohonin krejtësisht gjuhën shqipe, por edhe propagandonin kundër saj. Këta klerikë predikonin së të kënduarit shqip është mëkat. Se ata që shkruajnë shqip në shtypin e kohës ose hartojnë vepra tjera me karakter shkollor e letrar nuk mund të jenë mysliman por kaurë, prandaj edhe shkrimet e tyre nuk duhet të lexoheshin nga shqiptarët myslimanë. Klerikët myslimanë pro shtetit turk dhe ata të krishterë që u shërbenin kombësive sllave e greke, që kishin qëllime të caktuara për copëtimin e Shqipërisë, u vërsuleshin me mallkime e të shara gjithë atyre shqiptarëve që i dërgonin fëmijët në shkollë për të mësuar gjuhën shqipe dhe informonin në organet qeveritare të shtetit turk. Ata informonin edhe për ata që lexonin e përhapnin libra e literaturë në gjuhën shqipe. Këto veprime e qëndrime të këtyre klerikëve dhe të qeveritarëve turq, Saidi, kur i zbulonte, i demaskonte si të padrejta, ndërsa personat konkretë i demaskonte si antikombëtarë e antishqiptarë, të shitur tek të huajt. Sa herë Saidi kthehej në Dibër të Madhe nuk reshte së punuari për interesat e për të përhapur shkëndijat e ideve kombëtare duke shpjeguar me tërë forcat e tij domosdoshmërinë e të mësuarit të gjuhës shqipe. Ai shprehej se "po të bëhesha bari me bagëti, në vend të fyellit do të merrja dhe do të këndoja libra të gjuhës shqipe. Do të merrja vesh për fenë e besën' e shqiptarit. (Libri "Fe-rrëfenja e myslimaneve" shtypur në vitin 1900, Sofje faqe 45).

*(Vijon numrin e ardhshëm)*

propozim

**Në popull njihet më shumë me emrin Ibrahimi i Haxhi Zeqirit, ishte biri i Zeqir Gjorgjit që thirrej me titullin fetar nga i ati "Haxhi". Lindi në fshatin Stërdok, një ndër pesë fshatrat e Radomirës. Rridhte nga një familje me trashëgimi të mira jo vetëm për çështjen kombëtare, por dhe e respektuar në gjithë Radomirën.**

# A duhet të shpallet Hero Ibrahim Zeqir Gjorgji?

**Nga: JAHE DELIA (SELMANI)**

Në popull njihet më shumë me emrin **Ibrahimi i Haxhi Zeqirit**, ishte biri i Zeqir Gjorgjit që thirrej me titullin fetar nga i ati "Haxhi". Lindi në fshatin Stërdok, një ndër pesë fshatrat e Radomirës. Rridhte nga një familje me trashëgimi të mira jo vetëm për çështjen kombëtare, por dhe e respektuar në gjithë Radomirën. Burrat e familjes së tij e të afërmit janë marrë me kurbetin të cilin e bënin në Stamboll e Selanik, por pa e harruar asnjëherë familjen e fshatin ku kalonin verën me bujqësi e, sidomos, me blektori.

Në Stamboll kishte bërë dhe shkollë jo vetëm fetare, por dhe të përgjithshme. E tregojnë si një burrë të matur, të drejtë, besimtar dhe shumë trim. Këto cilësi e bënë shumë të respektuar në Radomirë. Nuk është qëllimi i këtij shkrimi që të përshkruajë gjithë jetën e aktivitetin e kësaj figure, mund të flitet më vonë për të e të tjerë të kësaj zone e të këtij fshati, por dua të shfaq pa pasione të veçanta e, pa ngarkesë emocionale e nxitje krahinore mendimet e mia në përgjigje të pyetjes në fillim të shkrimit.

Heronjtë nuk lindin të tillë, ata i bën puna e aktiviteti i tyre në sherbim të çështjes kombëtare. Ka heronj të rënë në luftë që kanë dhe nderin e të qenit dëshmor, por ka dhe heronj të gjallë, që e kanë merituar pa qenë dëshmorë për meritat e padiskutueshme. Si dëshmori, si heroi i rënë në luftë kanë meritën e madhe që kanë derdhur gjakun për një çështje të madhe, por aktiviteti i një heroi ka disa të veçanta që e bëjnë të tillë. Janë gjëra që i dinë të gjithë. Por dikush, me të drejtë, do të pyesë se si duhet argumentuar shpallja Hero e dëshmorit Ibrahim Zeqir Gjorgji ndërkohë që në Lufën e Qafës së Kolesjanit kanë rënë dhe dëshmorë të tjerë? Pse kaq vonë u kujtuat për të trajtuar këtë problem? Po i jap përgjigje pyetjes së dytë: e para, nuk është vonë, se edhe dëshmor, Ibrahim Gjorgji u shpall, me sa di unë, në kuadrin e 100-Vjetorit të Lidhjes së Prizrenit d. m. th. afro **70 vet** pas rënies; së dyti:kurrë nuk është vonë për të vënë në vendin e vet të drejtën, se veprat në sherbim të Atdheut nuk harrohen e gjaku nuk humbet; e treta: nuk ka rast më të mirë për të vlerësuar veprat e dashmorëve e, sidomos, atij burri që nuk i kishte as 30 vjet, se sa në vitin e shekullit të parë të Pavarësisë.

Të hidhemi te pyetja e parë. Shpesh në histori ka momente të veçanta që bëhen shkas për kthesa historike të mëdha e që i vënë personalitete të ndryshme në piedestale të paarritshme nga të tjerët. Ato momente i japin drejtim tjetër rrjedhës së luftës ose vetë zhvillimit historik. **Xhon Kenedi** kishte meritat e padiskutueshme në drejtimin e shtetit më të fuqishëm në botë, por askush nuk ta mohojë që në çastin më kritik për botën Ai arriti, ndofta, si individ, të parandalojë një luftë të përgjithshme botërore me një fund të paparashikuar (Kuba). **Zhanë D'Arkë**, kjo krijesë e lindur në momentet më të vështira për Francën e saj e që u bë shpresa e vetme për të, e habiti botën me heroizmin e mençurinë e vet, por, ndofta, strategjia që përdori në luftën për Orleanin dhe kurorëzimi i mbretit u bënë shkas për fitoret e mëtejshme kundër anglzëve gjë që krijoi atë besim të patundur te populli e saj për këtë shenjtore të paqës.

**Qemal Ataturku**, ky shqiptar i madh, u bë shpresa e popullit turk për ta nxjerrë nga një epokë e errët e mesjetare në atë të përparimit. Janë të shumta veprimet sa diplomatike, sa luftarake për të arritur aty ku arriti, por, mendoj se mençuria e strategjia që përdori në Lufën e Anafartës ishte momenti që do t'i jepte drejtim tjetër luftës së ardhme, se besimi ndaj Tij u bë i padiskutueshëm. Dhe shembuj të tjerë në botë apo në vendin tonë ka mjaft. I tillë qe **Skënderbeu** në marrjen e Krujës.

I tillë qe **Mehmet Ali Pasha**, themeluesi i Egjiptit modern, që e zu fill aktivitetin kur mblodhi taksat që disa fshatra në Kavallë nuk i jepnin. Ky veprim i thjeshtë e krijoi besimin e parë te ai e që do të bëhej shkas për kthesën e madhe jo vetëm në jetën e tij, por dhe në jetën e **Egjiptit**. Përmenda vetëm disa raste që sjellin kthesa në histori e që mbeten në memorjen e saj, se shembuj ku spikat heroizmi individual e shoqëror e që shoqëria i vlerëson me të drejtë ka mjaft.

Një pyetje logjike që do ta bëja dhe vetë po ta shkruante dikush tjetër këtë shkrim do të ishte se pse duhen sjellë këta shembuj për të marrë përgjigjen e asaj pyetjeje që u bë në fillim. Aq më e drejtë bëhet kjo pyetje kur dihet kur po bëjmë fjalë për një dëshmor që ishte një njeri i zakonshëm e me një aktivitet të shkurtër që filloi në Radomirë e mbaroi në Qafën e Kolesjanit ku u vra pasditën e 15 nëntorit 1912. Do të mundohem ta jap përgjigjën larg çdo pasioni krahinor dhe do të vlerësoj çdo mendim që mund të jetë i ndryshëm e dyshues.

**Radomira** ishte një bajrak që përbëhej nga pesë lagjet që quhen sot dhe fshatra për vetë madhësinë që kanë, por që quhen një katund. Gjithmonë është trajtuar e organizuar si një njësi, me një kryeplak, me një komision intifaki, me një xhami etj. Si bajrak në vetë ka qenë i përfshirë në të gjitha luftrat që ka bërë krahina e Kalasë së Dodës dhe Luma dhe e ka thënë fjalën e vet në të gjitha takimet e asaj kohe. Zëri i saj në luftë apo në takime të tjera në kohë paqje ka qenë dinjitoz e i respektuar.

Burrat që drejtonin bajrakun ishin nga shtëpia e Xhelil Ahmatit, por në në prag të Luftës së Kolesjanit drejtimi i Bajrakut i kaloi Ibrahim Gjorgjit, se Hysni Ahmati që mbeti drejtuesi i fundit ishte i moshuar dhe nuk kishte djalë. Radomira vuri Ibrahimin pa asnjë paragjykim e në mënyrën më demokratike. Si një burrë i vendosur e i respektuar Ibrahim Gjorgji ishte personi i duhur që në situatat më kritike për krahinën e vendin do të dinte ta drejtontë me heroizëm Bajrakun. Ndër 7 bajraqet e Lumës emërtimi "**Bajrak i parë**" ka lëvizur nga një bajrak në tjetrin në varësi të situatave luftarake të krijuara. Ky emër më shumë merrej kur bajraktari vritej gjë që në këta bajraqe ka qenë krejt e zakonshme, se bajraktarët në çdo luftë ishin në krye, e kishin për nder të ishin shehitët (dëshmorët) e parë. Kështu ndodhi dhe me Bajrakun e Radomirës që e meritoi këtë emër në luftën e Kolesjanit. Kjo nuk qe një betejë e zakonshme, por një Luftë e përmasave të mëdha. Ajo është quajtur me emra të ndryshëm deri dhe me **"Termopilet shqiptare**" etj. Për të kanë shkruar atëherë e më vonë vendas e të huaj, ushtarakë e historianë, se ishte organizimi më i përsosur që mund të bënte një ushtri që përbëhej krejt nga vullnetarë të organizuar bazë bajraqesh a krahinash e që kishin në krye R. Zaskocin, I. Spahinë etj.

Për organizimin e kësaj lufte, rolin e saj në fatet e kombit kanë shkruar me koompetencë dhe historianë si prof. Shefqet Hoxha etj. Se ishte lufta më e madhe që bënte kombi shqiptar në prag të Shpalljes së Pavarësisë. Ishin momentet më kritike për kombin, Turqia kishte marrë të tatëpjetën, ajo jo vetëm nuk i mbroi tokat shqiptare që qenë pjesë e Perandorisë, por i bëri kurban në dobi të fqinjëve tanë që përherë kanë pasur qëllime pushtuese. Dhe Serbia e shfrytëzoi këtë moment, armatat e saj të mëdha dhe plot me armatime moderne do të kalonin kufirin me synimin për ta vënë kufirin tani për Drini e më tej. Dhe dihet se ç'ndodhi ato ditë kur Luma dhe Dibra u bënë barrikada e pakapëcyeshme duke shkruar faqen më të lavdishme kombëtare në pragun e 28 Nëntorit 1912.

A do të kishte **28 Nëntor** nëse Serbia do të kishte shkelur Lumën në ato ditë të stuhishme nëntori? Mendoj se do të kishte, se patriotët shqiparë nga Kosova në Çamëri e nga Stambolli në Adriatik i kishin marrë masat, por nuk do të ishte ajo që u arrit. Lakmitë e Serbisë do ta cungonin dhe më tej Shqipërinë edhe kështu të cunguar. Lufta e Qafës së Kolesjanit ishte vendimtare në fatet e vendit në kuptimin e ruajtjes së këtyre kufinjve që sot kemi.

Pas dhënies së kushtrimit për t'u bashkuar në këtë luftë të madhe në Qafën historike të Kolesjanit erdhën të gjithë meshkujt e aftë për luftë me parullën"Besa-besë për vatan" të organizuar në bajraqe dhe forma të tjera. Erdhën dhe luftëtarët nga **Dibra**, Reç e Dardha me Baftjar Dodën si dhe legjendari Elez Isufi që u kthye nga rruga bashkë me luftëtarët e tij që ishin nisur për Shkodër kundër Malit të Zi.

Deri para 20 vjetësh kanë jetuar e kanë dhënë kujtimet e atyre ditëve heroike shumë pjesëmarrës në këtë luftë. Secili flet për atë heroizëm masiv dhe organizim të përkryer që pat, megjithëse nuk udhëhiqej nga gjeneralë, por nga prijës që i kishte bërë të tillë vetë historia e gjatë me fqinj të pabesë e pushtues të tjerë. Shtabi i Luftës, i vendosur në Qafë, që e udhëhiqnin Ramadan Zaskoci, Islam Spahia e të tjerë, i kishin marrë masat e duhura dhe kishin organizuar çdo gjë në pritje të luftës së pashmangshme. Të gjithë ishin të vetëdishëm për përgjegjësinë që kishin mbi vete për rndësinë e kësaj lufte. Bëhej fjalë për liri a robëri të re. Çdo bajrak a formacoin tjetër e kishte marrë urdhrin dhe vendin e luftimit.

Por Bajraku i Radomirës do të vinte më vonë, se ishte më larg. Siç tregojnë pjesëmarrësit, bajraku erdhi shumë i organizuar, mbi 300 pushkë, të veshur me rroba të reja, të gjithë mbi kuaj e me flamurin në krye të mbajtur nga bajraktari.

Me të zbritur nga kuajt, Ibrahimi shkon në shtabin e Luftës për të marrë detyrën. Siç duket në shtab i bëjnë të ditur se luftën nuk do ta fillonin atë pasdite, për ato arsye që ata kishin paraqitur. Zërin me tone të larta e mosaprovues të Ibrahimit e kanë dëgjuar dhe ata që ishin jashtë. Argumentat e Ibrahim Gjorgjit pak a shumë ishin këto:"Armata serbe e ka marrë vesh organizimin tonë, deri ditën tjetër ai fiton kohë e organizohet më mirë, do të shtojë forcat e do të studiojë më mirë terrenin. Ne duhet të shfryrëzojmë këtë mundësi, të mos i lëmë aspak kohë të bëhet më i fortë. Nuk kemi ato forca e ato armatime që ka ai. "

Shumë bashkëkohës tregojnë për momentet e tensionuara që u krijuan në shtab dhe irritimin e Ibrahimit kur doli prej andej. Në një intervistë të vitit 1983 Fejzë Tota nga Gjegjet e Bushtricës që e kishte parë Ibrahim Gjorgjin kur doli nga shtabi kujton:"Isha i madh në këtë luftë, ne prisnim se ç'do të bënim. E kam pa vetë Ibrahimin kur hyni me shpejtësi në shtab. Dukej i inatosur, se e kishte marrë vesh se lufta do të niste nesër. I kam dëgjuar unë me gjithë shokë fjalët që foli në shtab. Dëgjuam kur tha:Do t'i bie sot, ju si të doni! Kur doli jashtë akoma këto fjalë thonte. Nuk u ndal fare, shkoi drejt e te shokët. E kuptuam të gjithë se puna ndryshoi. " Dhe këto momente i thonin të gjthë ata që morën pjesë në luftë.

Flitet që dëshmitar shumë afër R. Zaskocit ka thënë se dhe ky kishte qenë më mendimin për ta filluar luftën atë ditë, por nuk i kishte bindur shokët. Ardhja e Radomirës i ndryshoi planet. Ibrahimi shkon para shokëve, i njeh me vendimin e shtabit dhe mendimin e tij. Të gjithë janë dakord dhe bën organizimin. U thotë:"Kemi ardhë me vdekë për vatan, Ja shehit (dëshmor), ja gaza (të lirë)!" Aq u desh, të gjithë rreshtohen për të marrë abdes te vija e ujit, pra përgatiten për me vdekë, se prandaj kishin ardhur. Vendimi i tij qe i padiskutueshëm, Radomira shkoi të zërë frontin e vet të luftës nën sytë e mijëra luftëtarëve që prisnin. Tani nuk kishte kohë për të pritur e për të marrë vendime të tjera, edhe shtabi tani merr masat e duhura, lufta do të fillonte. Bajraku i Radomirës nuk pret të sulmohet nga sërbët që nuk e prisnin këtë situatë, por sulmon dhe lufta ndizet. Ajo që pritej me ankth tani u bë realitet, gjithë Luma, Reç e Dardha nga Dibra e të tjerë do të hidhen me thirrjen "**Besa-besë për vatan**", Qafa e Kolesjanit do të ndizet, lugina e Drinit e deri në Gjallicë do të gjëmojë si kurrë ndonjëherë. Dëshmitarët e historia flasin për një luftë të pazakontë për nga organizimi e përkushtimi, se ishte luftë për ekzistencën e vetë kombit.

Ibrahim Gjorgji i Haxh Zeqirit do të printe Bajrakun me bajrak në dorë, por menjëherë pas tij do të ishin dhe mijëra të tjerët që u hodhën pa hezitim në këtë luftë që bëri epokë. Kundërpërgjigjja e Armatës sërbe qe e shpejtë, nën breshërinë e plumbave Ibrahimi do të plagoset, flamuri do t'i kalojë, sipas radhës, shokut në krah dhe lufta do të vazhdojë. Pas plagëve të marra Ibrahimi vdes shpejt. U bë i pari dëshmor i kësaj Lufte siç qe dhe i pari që e nisi. Lajmi u përhap në të gjithë frontin dhe lufta do të ndizej edhe më e ashpër e do të pasohej me dëshmorë të tjerë që do të nderohen përjetësisht nga brezat. Dhe lufta e nisur atë pasdite nëntori 1912 do të vazhdonte, furia popullore nuk do të ndalej, ushtria sërbe do të fillonte rënien, nata, që në fillim për serbët do të ishte një mundësi për t'u përforcuar, tani u kthye në të kundërtën dhe po përpinte me mijëra prej tyre, se dhe shiu i asaj nate do të bëhej aleat. Nejse, përshkrimin e kësaj epopeje e kanë bërë e do ta bëjnë historianët, heroizmin masiv që shpërtheu do ta gdhendnin e do të vijojnë ta gdhendin artistët në art, rëndësia e kësaj Lufte per fatet e kombitit është vlerësuar e do të vler- ësohet dhe më shumë në këtë vit të 100-Vjetorit të Pavarësisë, se lidhet pazgjidhshmërisht me të.

Pse duhet shpallur Hero Ibrahimi? Luftën në fjalë duhet ta vendosim qartë në kontekstin e ngarjeve të vitit 1912. Pritej Shpallja e Pavarësisë, por Serbia pikërisht tani donte t'i bënte fakt pretendimet e veta e ta vendoste kufirin për Drini. Nuk kishte moment më të mirë për të e më kritik jo vetëm për Lumën, por dhe për kombin. Lufta e Qafës së Kolesjanit do të shkëmoqte plotësisht synimet e Sebisë, do të ishte një garanci për ditën e 28 Nëntorit në Vlorë. Po t'kishte përfundim tjetër kjo luftë, dihen pasojat, tani Turqia nuk ishte dhe Shqipërinë donin ta bënin mall të tjerët. Pavarësia do të shpallej edhe më e cunguar se sot, se Luma, Dibra e më gjërë do të mbeteshin jashtë kufinjve dhe një shteti të sapoformuar shqiptar nuk mund t'i ecte mbarë në këto kushte.

Po të mos fillonte kjo luftë atë natë, por të nesërmen, Serbia do të përforcohej, terrenin do ta mësonte më mirë, por dhe nata që u bë aleatja më e mirë me shiun që mbushi Shejën e Drinin nuk do të ishte. Por këtyre hamendjeve u dha fund mosbindja e "rebelimi" i një personi, i një bajaktari që me intuitën e tij futi në luftë menjëherë Bajrakun, ndezi shkëndinë e parë për t'u ndezur një zjarr që do të digjte jo vetëm 12 mijë ushtarë serbë, por do të shuante çdo shpresë për ta bërë të vetën këtë zonë. Serbia do të hakmerrej edhe më shumë se dhjetë vjet të tjera me Lumën, Dibrën e më gjërë, por tani dihej se po luftonte brenda kufinjve të një shteti të pavarur, edhe pse hynin e dilnin shumë qeveri e pushtues.

Në prag të Pavarësisë u bë dhe u fitua Lufta më e madhe që mund të bëhej, u shmang një copëtim edhe më i madh se ai që u ishte bërë trojeve shqiptare duke filluar me Shën Stefanin dhe a mund të lihet në heshtje vepra e një individi që u bë shkas për të ndryshuar një vendim që çoi pastaj në përfundime të tjera? Argumentet mund të vijojnë, por nuk besoj të ketë kundërshtime që akti i Ibrahim Haxhi Zeqirit të mbetet vetëm me emrin dëshmor, ai duhet të shpallet **Hero**, bile është i vonuar për të mos vazhduar më tej. Nuk ka rast më të mirë se 100-Vjetori i Pavarësisë për ndrequr disa gjëra, sidomos rastin në fjalë, se Ibrahimi qe, në mos i pari, ndër të parët dëshmorë të aktit madhor të Pavarësisë. Nuk ka kohë për të pritur nga organet vendore të Kalasë së Dodës e të Dibrës për ta bërë realitet sa më shpejt shpalljen.

Do të ishte jo vetëm në nderin e familjes, Radomirës, Kalasë e Lumës, por dhe më gjërë. Nuk është favor, por një meritë që nuk e dimë pse nuk është dhënë apo mund ta dimë, por nuk ka nevojë ta themi.

Radomira e pret këtë akt dhe ka besim te objektiviteti i organizmave përgjegjëse. Por nuk përfundon me kaq. Vlerësimet për dëshmorët e luftrave kundër serbëve në Kala të Dodës kanë qenë të njëanshme. A ka akt më të madh se ai që bëri **Naxhie Murraku** nga Cereni që shkoi në Korab e u vra bashkë me vëllanë **Shaban Alia**, apo ai i **Halim Leskës** nga Ploshtani që në krye të trimave ra si trim po në Korab? Akte të tilla duhen vlerësuar në këtë 100-Vjetor, edhe këta e meritojnë titullin e lartë **Hero**.

**** Kryetar i Shoqatës Korabi-Radomirë***






Botime & Studio Grafike

libra-revista
gazeta -fletëpalosje
postera-broshura
kartolina-ftesa
kartvizita
shërbim fotografik

*Kape kohën...*
*për çmime të lira, shpejtësi dhe cilësi*

**00355 4 22 33 283**
**069 20 68 603**
**mbbotime@gmail.com**
**www.mbbotime.com**

*na ndiqni në Facebook:*
MB Botime & Studio Grafike